

STUDIM KOMBËTAR

ZBATIMI I TË DREJTAVE PROCEDURALE PËR FËMIJËT NË KONFLIKT ME LIGJIN



STUDIM KOMBËTAR

ZBATIMI I TË DREJTAVE PROCEDURALE PËR FËMIJËT NË KONFLIKT ME LIGJIN

Tiranë, tetor 2025

Autorë të studimit:

Arben RAKIPI – Drejtor i Shkollës së Magjistraturës

Dr. Amarildo LAÇI – Pedagog i brendshëm, Shkolla e Magjistraturës

Ky studim është realizuar në kuadër të projektit “Të Rinjtë, Të Drejtat dhe Drejtësia”, i zbatuar nga Terre des hommes Shqipëri (Tdh) dhe i financuar nga Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA). Përmbajtja e këtij publikimi, përfshirë analizat, gjetjet dhe rekomandimet, pasqyron ekskluzivisht pikëpamjet e autorëve dhe nuk përfaqëson domosdoshmërisht qëndrimet zyrtare të Terre des hommes apo të donatorit. Studimi ka karakter analitik dhe informues dhe synon të kontribuojë në përmirësimin e praktikave institucionale dhe të politikëbërjes në fushën e drejtësisë për fëmijët në konflikt me ligjin, pa paragjykuar vendimmarrjen e organeve të drejtësisë apo përgjegjësitë individuale dhe institucionale.

Faqosja: Gent Grafik
Imazhi në kopertinë: Image by freepik

Tabela e Lëndës

Lista e Akronimeve	6
1. HYRJE	7
2. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	8
3. METODOLOGJIA	9
4. PARIMET E DREJTËSISË PENALE PËR TË MITURIT NË KONFLIKT ME LIGJIN.....	10
5. TË DREJTAT DHE GARANCITË PROCEDURALE TË TË MITURIT NË KONFLIKT ME LIGJIN GJATË PROCESIT PENAL ...	22
6. GJETJET E STUDIMIT DHE ANALIZA E TYRE	38
7. REKOMANDIMET E STUDIMIT	64
BIBLIOGRAFIA E STUDIMIT.....	67
ANEKS	70

Lista e Akronimeve

Akronimi | Përkufizimi

KDPM | Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur

KPP | Kodi i Procedurës Penale

KP | Kodi Penal

KDF | Konventa për të Drejtat e Fëmijës

PGJ / OPGJ | Policia Gjyqësore / Oficeri i Policisë Gjyqësore

GjEDNj | Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut

BE | Bashkimi Evropian

RVI | Raporti i Vlerësimit Individual

ADA | Agjencia Austriake për Zhvillim

Tdh | Terre des hommes

IMKL | I mitur në konflikt me ligjin

OKB | Organizata e Kombeve të Bashkuara

ECOSOC | Këshilli Ekonomik dhe Social i OKB-së

KE / CoE | Këshilli i Evropës

AIRE Center | Advice on Individual Rights in Europe Center

CRD | Civil Rights Defenders

KEDNJ / ECHR | Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

DUDNJ / UDHR | Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut

CAT | Konventa kundër Torturës

BR | Rregullat Minimale të Pekinit (Beijing Rules)

HR | Rregullat e Havanës (Havana Rules)

CM/Rec | Rekomandimet e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës

OJ | Gazeta Zyrtare e Bashkimit Evropian (Official Journal)

ECtHR | European Court of Human Rights (Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut)

RSC | Revue de Science Criminelle

UN Doc. | Dokument i Kombeve të Bashkuara

DhM | Dhoma e Madhe (Grand Chamber) e GjEDNj-së

1. HYRJE

Ky studim kërkimor është zhvilluar në kuadër të projektit **“Të Rinjtë, Të Drejtat dhe Drejtësia”**, i zbatuar nga Terre des hommes Shqipëri (Tdh) dhe financuar nga Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA). Projekti synon forcimin e drejtësisë për fëmijët në konflikt me ligjin, duke u bazuar në parimet e drejtësisë miqësore ndaj fëmijëve dhe në përdorimin e masave alternative të shmangies nga ndjekja penale. Për më shumë se tri dekada, Terre des hommes ka qenë një nga aktorët kryesorë në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në Shqipëri dhe në promovimin e standardeve të një sistemi të drejtësisë miqësore ndaj fëmijëve.

Qëllimi i këtij studimi është **të vlerësojë nivelin e zbatimit të procedurave dhe garancive proceduriale për fëmijët në konflikt me ligjin nga Prokuroritë dhe Gjykatat në Shqipëri**, duke identifikuar praktikën e mira, boshllëqet ligjore dhe institucionale, si dhe sfidat që pengojnë zbatimin e drejtësisë efektive dhe të ndjeshme për fëmijët. Analiza fokusohet në shkallën e integritetit të parimeve të drejtësisë miqësore ndaj fëmijëve në praktikën e hetimit dhe gjykimin, marrëdhënien ndërmjet fëmijës dhe aktorëve të drejtësisë, përdorimin e masave të shmangies nga ndjekja penale, si dhe efektivitetin e mekanizmave mbrojtës gjatë procedurave.

Studimi bazohet në analizën e fashikujve të hetimit paraprak të Prokurorive pranë Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm në Tiranë, Durrës, Elbasan, Fier, Vlorë dhe Shkodër. Analiza tregon për një zbatim të kënaqshëm të normave ligjore nga Policia Gjyqësore dhe Prokuroria dhe arritjen e një standardi të pranueshëm në drejtim të respektimit të të drejtave procedurale të të miturve në konflikt me ligjin gjatë hetimeve paraprake. Megjithatë, studimi i realizuar vërejtje edhe raste të moszbatimit apo të zbatimit të gabuar të ligjit procedural penal.

Gjetjet e studimit evidentojnë problematikat e përsëritura, si vonesa në regjistrimin e procedimeve, mangësi në informimin dhe dokumentimin e të drejtave, mospërfshirje të mbrojtësit, prindit apo psikologut në veprime procedurale dhe shkelje të normave të Kodit të Procedurës Penale gjatë marrjes në pyetje dhe hetimit të të miturve, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në mirëqenien psikologjike, sociale dhe zhvillimore të fëmijëve. Këto mangësi krijojnë ndjenja frike, pasigurie dhe mosbesimi ndaj institucioneve, rrisin stresin dhe rrezikun e traumave afatgjata, cenojnë aftësinë e fëmijëve për të kuptuar dhe ushtruar të drejtat e tyre dhe pengojnë riintegrimin e tyre në shkollë, familje dhe komunitet. Për rrjedhojë, studimi nënvizon nevojën e menjëhershme për forcimin e standardeve procedurale, rritjen e specializimit profesional të aktorëve të drejtësisë dhe zbatimin e një qasjeje të koordinuar, mbrojtëse dhe rehabilituese, të bazuar në udhëzime të qarta, formim të detyrueshëm profesional, vlerësim individual dhe mekanizma efektivë mbrojtës, për të garantuar respektimin e plotë të të drejtave dhe interesit më të lartë të fëmijës.

Rekomandimet e studimit synojnë të mbështesin përmirësimin e praktikave institucionale dhe orientimin e politikëbërjes drejt një drejtësie më mbrojtëse, gjithëpërfshirëse dhe miqësore ndaj fëmijëve. Propozimet fokusohet në: forcimin e rolit të mbrojtësit dhe psikologut, përmirësimin e dokumentimit procedural, rritjen e përgjegjshmërisë së Policisë Gjyqësore dhe Prokurorisë, rritjen e përdorimit të masave alternative, si dhe ngritjen e mekanizmave të vlerësimit dhe monitorimit të zbatimit të të drejtave procedurale të fëmijëve.

2. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ky studim ka si qëllim vlerësimin e efektivitetit të zbatimit të garancive procedurale për të miturit në sistemin e drejtësisë penale në Shqipëri, duke krahasuar legjislacionin kombëtar me standardet ndërkombëtare dhe praktikën reale të organeve proceduese. Studimi synon të identifikojë boshllëqet sistemike, shkeljet e përsëritura dhe mospërputhjet në respektimin e të drejtave procedurale, duke përfshirë ndihmën juridike, trajtimin miqësor ndaj fëmijëve dhe përfshirjen e profesionistëve mbështetës.

Gjetjet Kryesore:

- Ekziston një hendek i dukshëm midis legjislacionit dhe praktikës reale.
- Shkeljet më të shpeshta përfshijnë kufizimin e paligjshëm të lirisë, mungesën e mbrojtjes ligjore efektive, marrjen në pyetje të të miturve në kundërshtim me ligjin, dhe mosdokumentimin e veprimeve procedurale.
- Përfshirja e detyrueshme e prindërve, mbrojtësve dhe psikologëve shpesh mungon ose është e pamjaftueshme.
- Procedurat vonohen, duke cenuar natyrën mbrojtëse dhe rehabilituese të drejtësisë për të miturit.

Përfundimet:

Shqipëria ka një kuadër ligjor të harmonizuar me standardet ndërkombëtare, por zbatimi mbetet i pjesshëm dhe shpesh formal. Mangësitë kryesore lidhen me koordinimin ndërinstytucional, dokumentimin, vlerësimin psiko-social dhe zbatimin e drejtpërdrejtë të dispozitave ligjore. Sfida kryesore është hendeku midis normës dhe praktikës, që kërkon masa konkrete për të forcuar kapacitetet institucionale dhe për të garantuar një drejtësi realisht miqësore ndaj fëmijëve.

Rekomandimet Kryesore:

Për Policinë Gjyqësore:

1. Marrja në pyetje e të miturve të arrestuar ose ndaluar të kryhet vetëm nga prokurori.
2. Ndërprerja e menjëhershme e deklarimeve vetëfajësuese të marra në kundërshtim me ligjin.
3. Sigurimi dhe dokumentimi i pranisë së detyrueshme të mbrojtësit dhe psikologut.
4. Informimi dhe dokumentimi i qartë i të drejtave procedurale, duke garantuar kuptimin e tyre.
5. Përfshirja e prindërve/personave të besuar sipas vullnetit të të miturit dhe dokumentimi i saj.

Për Prokurorinë:

1. Regjistrimi i menjëhershëm dhe korrekt i veprave penale dhe autorëve të dyshuar.
2. Sigurimi i kontrollit gjyqësor mbi ligjshmërinë e arrestimit/ndalimit të të miturve.
3. Respektimi strikt i kompetencës ekskluzive të prokurorit për marrjen në pyetje të të miturve të privuar nga liria.
4. Shpallja e papërdorshme e çdo deklarimi vetëfajësues të marrë në kundërshtim me ligjin.
5. Organizimi efikas i hetimeve për përfundimin e procedimeve brenda afateve ligjore.
6. Hartimi i detyrueshëm i raporteve të vlerësimit individual të të miturit për një drejtësi të personalizuar dhe në përputhje me interesin më të lartë të fëmijës.

Këto masa synojnë rritjen e ligjshmërisë, transparencës dhe mbrojtjes reale të të drejtave të të miturve në praktikën procedurale, duke adresuar mangësitë sistemike dhe procedurale të evidentuara nga studimi.

3. METODOLOGJIA

Metodologjia e këtij studimi është ndërtuar mbi një qasje të integruar kërkimore, e cila kombinon analizën dogmatike dhe normative të kuadrit ligjor me shqyrtimin empirik të praktikës procedurale që zbatohet ndaj të miturve në sistemin e drejtësisë penale. Në fazën fillestare u realizua një rishikim i zgjeruar dokumentar, ku u analizuan dispozitat kushtetuese, ligjore dhe nënligjore përkatëse, përfshirë Kodin e Procedurës Penale, Kodin Penal, Kodin e Drejtësisë Penale për të mitur, Ligjin nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, si dhe aktet udhëzuese të organeve të drejtësisë. Ky rishikim u plotësua me shqyrtimin e jurisprudencës së Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe vendimeve të gjykatave vendase, si dhe me analizën e literaturës shkencore dhe raporteve të monitorimit lidhur me drejtësinë për të miturit. Ky korpus normativ dhe doktrinor përcaktoi bazën standarde për verifikimin e përputhshmërisë së praktikës me detyrimet procedurale dhe garancive të parashikuara në legjislacionin kombëtar dhe atë ndërkombëtar.

Komponenti kryesor empirik i studimit konsistoi në analizimin cilësor të 49 fashikujve të hetimit paraprak të administruar nga prokuroritë pranë gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm në Tiranë, Durrës, Elbasan, Fier, Vlorë dhe Shkodër. Analiza u orientua nga një protokoll standard vlerësimi, i cili mundësoi shqyrtimin e elementeve kyçe të procedurës penale, si respektimi i të drejtës së njoftimit të menjëhershëm të akuzës dhe të drejtave procedurale, garantimi i ndihmës juridike efektive, prania dhe roli i avokatit dhe i psikologut gjatë veprimeve hetimore, mënyra e marrjes në pyetje të të miturit, respektimi i afateve ligjore, dokumentimi i vlerësimit individual dhe aplikimi i masave alternative ndaj ndalimit dhe paraburgimit. Ky shqyrtim synoi të identifikojë në mënyrë të strukturuar shkallën e përputhshmërisë ndërmjet kërkesave të ligjit procedural dhe praktikave hetimore të ndjekura nga organet proceduese.

Në kuadër të integritetit të perspektivës së të miturve në procesin analitik, u zhvillua një fokus-grup me të mitur të dënuar në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale të Kavajës. Ky fokus-grup synoi të mbledhë dëshmi të drejtpërdrejta mbi mënyrën e ushtrimit të të drejtave procedurale gjatë kontaktit të parë me policinë gjyqësore dhe organin procedues, perceptimin e të miturve lidhur me garantimin e mbrojtjes së tyre juridike, përjetimet gjatë marrjes në pyetje dhe vlerësimin subjektiv të trajtimit institucional. Aktiviteti u zhvillua në përputhje të plotë me standardet etike të kërkimit me të mitur, duke respektuar parimet e konfidencialitetit, pëlqimit të informuar dhe mbrojtjes së integritetit të pjesëmarrësve.

Përpunimi i të dhënave u realizua përmes metodave cilësore të analizës tematike dhe triangulimit të burimeve, me synimin për të identifikuar tiparet strukturore të procedimit penal ndaj të miturve, pavarësisht dallimeve ndër-institucionale. Kjo analizë mundësoi vlerësimin e shkallës së harmonizimit ndërmjet standardeve ligjore dhe praktikës aktuale, duke nxjerrë në pah boshllëqet procedurale, mosrespektimet e përsëritura dhe praktikat devijuese nga parimet e drejtësisë miqësore ndaj fëmijëve. Qasja krahasuese midis normës dhe praktikës krijoi një bazë solide për interpretimin kritik të gjetjeve.

Pavarësisht vlerës së lartë të evidencave të mbledhura, studimi njeh kufizimet e tij metodologjike. Përfshirja e kufizuar e të miturve përmes një fokus-grupi të vetëm kufizon mundësinë e përgjithësimin të përvojave mbi nivelin kombëtar. Gjithashtu, analiza varet nga cilësia e dokumentimit në fashikujt e hetimit, i cili në shumë raste paraqet mungesa ose pasaktësi, duke ndikuar drejtpërdrejt në vlerësimin e procedurave të zbatuara. Mungesa e konsultimit të drejtpërdrejtë me profesionistët e sistemit të drejtësisë, si gjyqtarë, prokurorë, avokatë dhe psikologë, përbën një tjetër kufizim. Megjithatë, duke qenë se të dhënat janë mbledhur nga disa prej prokurorive me ngarkesën më të lartë të çështjeve në vend, gjetjet e studimit ofrojnë një panoramë treguese dhe të besueshme për problematikat sistemike që karakterizojnë zbatimin e garancive procedurale për të miturit në Shqipëri.

4. PARIMET E DREJTËSISË PENALE PËR TË MITURIT NË KONFLIKT ME LIGJIN

Kuptimi i të drejtave procedurale të të miturve në konflikt me ligjin nuk do të ishte i plotë nëse nuk do të trajtonim fillimisht parimet e drejtësisë penale ndaj tyre. Këto parime, të parashikuara në nenet 8-18 të Kodit të Drejtësisë Penale për të Miturit (KDPM) e vendosin të miturin në qendër, duke i kushtuar vëmendjen e duhur nivelit të pjekurisë së tij, si dhe duke i përshtatur procedurat bazuar në nevojat dhe të drejtat e tij¹. Parimet e drejtësisë miqësore ndaj fëmijëve janë premisa të domosdoshme për mundësimin e gëzimit të të drejtave procedurale nga ata.

Parimet e drejtësisë penale duhet të mbahen në konsideratë nga të gjitha institucionet e përfshira në rastet penale ndaj të miturve. Ky përfundim del nga përmbajtja e nenit 8 § 1 të KDPM-së që sanksionon se, këto parime **“kanë efekt në të gjithë përmbajtjen e tij dhe zbatohen nga çdo person dhe organ kompetent në të gjitha veprimet dhe vendimet e tyre lidhur me të miturin në konflikt me ligjin, të miturin viktimë ose/dhe dëshmitar i veprës penale.”**

Natyrisht që, për qëllime të këtij studimi do të trajtojmë vetëm parimet kryesore që lidhen me mbrojtjen e të drejtave procedurale të të miturve në konflikt me ligjin dhe, konkretisht: (i) parimin e prezumimit të pafajësisë, (ii) parimin e interesit më të lartë të fëmijës, (iii) parimin e përparësisë së masave alternative të shmangies, (iv) parimin e pjesëmarrjes së të miturit në proces, (v) parimin e shqyrtimit të çështjes pa vonesë dhe me përparësi dhe (vi) parimin e pjesëmarrjes së detyrueshme të psikologut.

a. Parimi i prezumimit të pafajësisë

Parimi i prezumimit të pafajësisë nënkupton se, një person që organi i akuzës i ka atribuar kryerjen e një veprë penale, konsiderohet sikur nuk e ka kryer atë, deri në momentin që një gjykatë kompetente do të krijojë bindjen dhe do të vendosë, nëpërmjet një vendimi gjyqësor të formës së prerë, që ai është i fajshëm penalisht për kryerjen e faktit penal. **Prezumimi i pafajësisë është shprehje e besimit që, gjer në provën e kundërt, njerëzit janë të ndershëm dhe të respektueshëm ndaj ligjit.**² Parimi i prezumimit të pafajësisë nënkupton se, gjatë procesit gjyqësor barra e provës për të provuar autorësinë e të akuzuarit në kryerjen e veprës penale që i atribuohet, i takon ekskluzivisht organit të prokurorisë. I akuzuari e zgjedh vetë strategjinë e mbrojtjes: duke paraqitur prova që do t'i çmonte të nevojshme për të provuar alibinë e tij; duke u mjaftuar me kundërshtimin e vërtetësisë dhe fuqisë provuese të provave të paraqitura nga organi i akuzës; duke qëndruar tërësisht pasiv gjatë gjithë gjykimit apo, madje, duke mos marrë pjesë fare në seancë gjyqësore.

Në vendin tonë parimi i prezumimit të pafajësisë ka vlerë **kushtetuese**, pasi parashikohet nga **neni 30** i saj, sipas të cilit: *“Kushdo quhet i pafajshëm përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë”,* por edhe ligjore, sepse sanksionohet në nenin **4 të Kodit të Procedurës Penale** (KPP) me këtë përmbajtje: *“I pandehuri prezumohet i pafajshëm gjersa nuk vërtetohet fajësia e tij me vendim gjyqësor të formës së prerë. Çdo dyshim për akuzën çmohet në favor të të pandehurit”.*

Ky parim është parashikuar në nivel global, në nenin **11 § 1 të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut**, miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, me rezolutën e saj 217 A (III), në datë 10 dhjetor 1948, në të cilin përcaktohet se: *“Çdo njeri i akuzuar për një veprë penale prezumohet i pafajshëm derisa fajësia e tij të jetë provuar ligjërisht gjatë një procesi publik, ku të jenë siguruar garancitë e nevojshme për mbrojtjen e tij”*

1 Mandro, Arta dhe Semini, Marjana, *Manual “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur dhe programet e drejtësisë restauruese”,* Tiranë (2020), f. 22.

2 Béliveau, Pierre dhe Pradel, Jean, *La justice pénale dans les droits canadien et français*, Cujas (1986), Paris-Francë, f. 55 e 56.

Po kështu, edhe Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (KEDNj), miratuar në Romë, më 4 shtator 1950, në paragrafin e dytë, të nenit 6 të tij të titulluar "E drejta për një proces të rregullt", e përkufizon kështu parimin e prezumimit të pafajësisë: "Çdo person i akuzuar për kryerjen e një veprë penale prezumohet i pafajshëm derisa fajësia e tij nuk është vendosur ligjërisht".

Kjo e drejtë themelore e individit për t'u konsideruar i pafajshëm nuk ka gjetur vetëm njohje, por edhe zbatim në nivel evropian, nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (këtu e më poshtë "GjEDNj"), që e ka shndërruar prezumimin e pafajësisë në një element përcaktues të të drejtës për në një proces të rregullt ligjor, duke krijuar një jurisprudencë të bollshme. GjEDNj është shprehur se prezumimi i pafajësisë kërkon, ndër të tjera, që kryerja e detyrave nga anëtarët e një gjykate, nuk duhet të fillojë me idenë e paracaktuar se i akuzuari e ka kryer veprën për të cilën akuzohet³; se barra e provës i takon prokurorit dhe çdo dyshim duhet të jetë në favor të të akuzuarit.

Gjykata jonë Kushtetuese ka theksuar se, prezumimi i pafajësisë është një nga elementët përbërës të procesit të rregullt ligjor. Gjykata e ka interpretuar prezumimin e pafajësisë në kuptimin që gjykatat e zakonshme nuk duhet ta fillojnë procesin me bindjen se i pandehuri ka kryer krimin për të cilin akuzohet, se barra e provës i takon palës akuzuese, se çdo dyshim duhet të shkojë në favor të të pandehurit, se gjykata duhet ta mbështesë vendimin në prova direkte dhe indirekte që duhet të provohen nga akuza.⁴

Në lidhje me të miturit, ky parim themelor – e drejta për t'u prezumuar i pafajshëm – është sanksionuar në nenin 40, paragrafi 2, germa (b), nënparagrafi (i) të Konventës për të Drejtat e Fëmijëve (KDF), në rregullin 14.2 të Rregullave Minimale të Pekinit për Administrimin e Drejtësisë Penale për të Mitur, të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara nëpërmjet Rezolutës Nr. 40/33, datë 29 nëntor 1985 (Rregullat e Pekinit), si dhe në nenin 9 të KDPM-së, që përcakton se: "1. Çdo i mitur në konflikt me ligjin prezumohet i pafajshëm, derisa nuk vërtetohet fajësia e tij me vendim gjyqësor të formës së prerë. 2. Çdo dyshim për akuzën ndaj të miturit çmohet në favor të tij."

Në këto nene parashikohet se, çdo i mitur i dyshuar, i akuzuar ose i njohur fajtor për një veprë penale ka të drejtë të konsiderohet i pafajshëm derisa të provohet faji i tij sipas ligjit. E thënë ndryshe, i mituri nuk mund të trajtohet si fajtor, të ndëshkohet apo të stigmatizohet derisa një gjykatë kompetente, përmes një procesi të drejtë dhe të rregullt ligjor, të vërtetojë fajësinë e tij. Ky parim, në rastin e të miturve, merr një dimension mbrojtës më të fortë, pasi qëllimi nuk është vetëm ruajtja e barazisë para ligjit, por parandalimi i çdo paragjykimi që mund të ndikojë në zhvillimin e tyre emocional dhe social. Organi procedues duhet të silltet me të miturin në mënyrë të kujdesshme, pa e trajtuar si fajtor përpara se të ketë prova përfundimtare, dhe të shmangë çdo formë presioni apo trajtimi që mund të krijojë ndjenjën e fajësisë.

b. Parimi i interesit më të lartë të fëmijës

Ky është parimi udhëheqës i gjithë sistemit të drejtësisë për të miturit. Ai kërkon që çdo vendim apo veprim që lidhet me një fëmijë në konflikt me ligjin të udhëhiqet nga interesi më i lartë i tij, i cili ka përparësi ndaj çdo konsiderate tjetër. Organet e drejtësisë duhet të sigurojnë që procedurat, masat dhe dënimet të synojnë zhvillimin fizik, psikologjik dhe social të të miturit dhe jo dënimin e tij. Ky parim kërkon një vlerësim të individualizuar për çdo rast, në mënyrë që të garantohet mirëqenia dhe perspektiva e fëmijës për rehabilitim dhe riintegrim.

3 Barberà, Messegué dhe Jabardo kundër Spanjës, kërkesa nr. 10590/83, GjEDNj, datë 6 dhjetor 1988, § 77.

4 Vendimi nr. 23, datë 23.07.2009, i Gjykatës Kushtetuese, § 37, i aksesueshëm në faqen e internetit: https://www.gjk.gokundëral/include_php/previewdoc.php?id_kerkesa_vendimë706&nr_vendimë1

Neni 6 § 2 i ligjit nr. 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës"⁵ (në vijim: "LDMF") e përkufizon interesin më të lartë të fëmijës si "të drejtën e fëmijës për të pasur një zhvillim të shëndetshëm fizik, mendor, moral, shpirtëror e social, si dhe për të gëzuar një jetë familjare e sociale të përshtatshme për fëmijën." Për të përcaktuar sa më saktë këtë parim, dispozita e mësipërme kërkon që të merren në konsideratë:

- a) nevojat e fëmijës për zhvillim fizik e psikologjik, edukim e shëndet, siguri dhe qëndrueshmëri si dhe rritjen/përkatësinë në një familje;
- b) mendimi i fëmijës, në varësi të moshës dhe aftësisë së tij për të kuptuar;
- c) historia e fëmijës, duke mbajtur parasysh situatat e veçanta të abuzimit, neglizhimit, shfrytëzimit ose forma të tjera të dhunës ndaj fëmijës, si dhe rrezikun e mundshëm që situata të ngjashme të ndodhin në të ardhmen;
- ç) aftësia e prindërve ose personave që kujdesen për mirërritjen e fëmijës për t'iu përgjigjur nevojave të fëmijës;
- d) vazhdimësia e marrëdhënieve personale ndërmjet fëmijës dhe personave, me të cilët ai ka lidhje gjinore, shoqërore dhe/ose shpirtërore.

Po si duhet ta kuptojmë këtë përparësi të interesave të të miturve? Doktrina shqiptare na tregon se me të duhet të kuptojmë që **interesi i fëmijës tejkalon çdo vlerësim tjetër ose ndonjë grupim faktorësh të tjerë të vendosur në favor të ndonjë pale tjetër.**⁶ Prokuroria/Gjykata në zgjidhjen e çështjes duhet të zbatojë zgjidhjen më pak të dëmshme për të miturin dhe alternativën sa më pranë ideale, në vlerësim të gjithë faktorëve, duke pasur parasysh interesat dhe mirëqenien afatgjatë të fëmijës.⁷

Sipas KDPM-së **ky parim ka për detyrë të sigurojë që çdo masë të synojë edukimin dhe rehabilitimin e të miturit, të shmangë stigmatizimin publik dhe të jetë proporcionale me nivelin e zhvillimit të tij personal.** Në thelb, ky parim e trajton të miturin jo si "autor të një krimi", por si person në zhvillim që ka nevojë për mbrojtje, përkujdesje dhe mundësi për ndryshim.

Parimi i interesit më të lartë të të miturit buron nga **neni 3 i KDF-së**, sipas të cilit: "*Në të gjitha vendimet që kanë të bëjnë me fëmijët, qoftë nga institucionet publike apo private të mirëqenies shoqërore, gjykatat, autoritetet administrative apo organet legjislative, interesi më i lartë i fëmijës duhet të jetë një konsideratë parësore.*" Në të drejtën shqiptare, **ky parim gjen mbështetje kushtetuese në nenin 54 të Kushtetutës**, që parashikon **mbrojtje të veçantë për fëmijët** kundër dhunës, shfrytëzimit dhe keqtrajtimit, si dhe mbrojtje për zhvillimin e tyre të shëndetshëm fizik e moral.

Në kontekstin penal, interesi më i lartë i fëmijës përkufizohet si nevoja për të siguruar zhvillimin e plotë të personalitetit të fëmijës, ruajtjen e dinjitetit të tij dhe rikthimin e tij në shoqëri, nëpërmjet masave që kanë karakter edukativ, rehabilitues dhe jo ndëshkues. Ky parim udhëzon jo vetëm vendimmarrjen e gjykatave, por edhe veprimet e çdo institucioni që ndërhyr në procesin penal ndaj të miturit – policisë gjyqësore, prokurorisë, shërbimit të provës dhe institucioneve arsimore apo sociale. Në praktikë, ai kërkon që çdo vendim të bazohet në një vlerësim individual të situatës së të miturit: moshës, nivelit të pjekurisë, gjendjes familjare, arsimore, emocionale dhe sociale. Ndërhyrja penale duhet të synojë riformimin e fëmijës dhe parandalimin e përsëritjes së sjelljeve delikvente, dhe jo thjesht sanksionimin penal të veprës.

Këtë parim e gjejmë të sanksionuar edhe në **nenin 6 të LDMF-së**, me përmbajtjen vijuese: "*Interesi më i lartë i fëmijës nënkupton të drejtën e fëmijës për të pasur një zhvillim të shëndetshëm fizik, mendor, moral, shpirtëror e social, si dhe për të gëzuar një jetë familjare e sociale të përshtatshme për fëmijën.*"

5 Ligji nr. 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës", i aksesueshëm në faqen e internetit: <https://www.qbz.gokundëral/eli/ligj/2017/02/23/18-2017/a7b5c582-78fa-4109-beca-a0c7b48a2c8c> konsultimi i fundit 5.10.2025.

6 Mandro, Arta, *E drejta familjare*, familja, fëmijët, martesë, bashkëshortët, Tiranë (2009), f. 55.

7 Po aty, f.56.

Sipas nenit 10⁸ të KDPM-së, organi procedues duhet detyrimisht të vlerësojnë ne procesin penal:

- a) nevojat e fëmijës për zhvillim fizik e psikologjik, edukim e shëndet, siguri dhe qëndrueshmëri si dhe rritjen/ përkatësinë në një familje;
- b) mendimin e fëmijës, në varësi të moshës dhe aftësisë së tij për të kuptuar;
- c) historinë e fëmijës, duke mbajtur parasysh situatat e veçanta të abuzimit, neglizhimit, shfrytëzimit ose forma të tjera të dhunës ndaj fëmijës, si dhe rrezikun e mundshëm që situata të ngjashme të ndodhin në të ardhmen;
- ç) aftësinë e prindërve ose personave që kujdesen për mirërritjen e fëmijës për t'iu përgjigjur nevojave të fëmijës;
- d) vazhdimësinë e marrëdhënieve personale ndërmjet fëmijës dhe personave, me të cilët ai ka lidhje gjinore, shoqërore dhe/ose shpirtërore.

Ndërkaq, paragrafi i tretë i nenit 10 vendos një detyrim të rëndësishëm edhe për organet proceduese që trajtojnë çështje me të mitur në konflikt me ligjin, duke kërkuar prej tyre që: **“Vendimet dhe aktet e organeve kompetente duhet të përmbajnë një argumentim të posaçëm lidhur me mënyrën se si është analizuar dhe si do të sigurohet respektimi i interesit më të lartë të të miturit.”**

Janë pikërisht interesat themelore të të miturit: vlerësimi i nevojave të tij për mirëqenie fizike, mendore, shpirtërore, morale dhe sociale, si dhe trajtimi/zgjidhja shpejt e me prioritet e çdo veprimi apo vendimi ku i mituri përfshihet, kriteret kryesore matëse të garantimit të një procesi të rregullt ligjor ndaj/me një subjekt të mitur jo vetëm në aspektin procedural por edhe në atë final të efektivitetit të këtij procedimi penal ndaj të miturit.⁹

Në të drejtën ndërkombëtare, ky parim është zhvilluar në mënyrë të thelluar nga Komiteti për të Drejtat e Fëmijës i OKB-së, në **Komentin e Përgjithshëm nr. 14 (2013)**, ku thuhet se:

- Fëmija ka të drejtën ligjore që interesi i tij të merret parasysh në çdo vendim;
- Parimi shërben si udhëzues interpretimi për të gjitha ligjet që prekin fëmijët;
- Organet shtetërore kanë detyrimin të dokumentojnë dhe arsyetojnë se si e kanë vlerësuar interesin më të lartë në vendimin konkret.

Parimi i interesit më të lartë të fëmijës përbën një nga shtyllat themelore të së drejtës ndërkombëtare për mbrojtjen e fëmijëve dhe ka gjetur pasqyrim të plotë në **jurisprudencën e GjEDNj-së**. Dokumenti i ROL Platform *“Fëmijët dhe Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut” – Një vështrim mbi jurisprudencën*¹⁰ thekson se ky parim, i sanksionuar fillimisht në nenin 3 të KDF-së, është shndërruar në standard interpretimi detyruar për të gjitha shtetet anëtare të Këshillit të Evropës. **Ai kërkon që në çdo vendim apo veprim që prek një fëmijë** - qoftë në proces penal, civil apo administrativ - **interesi më i lartë i tij të jetë konsiderata parësore**. Sipas dokumentit, ky parim ka një natyrë të trefishtë, siç e ka përcaktuar Komiteti i OKB-së për të Drejtat e Fëmijës në Komentin e Përgjithshëm nr. 14 (2013). Së pari, ai është e *drejtë themelore e çdo fëmije* për t'iu trajtuar në mënyrë që të sigurohet zhvillimi i tij i plotë. Së dyti, është *parim interpretimi* që udhëzon organet publike të zgjedhin gjithmonë zgjidhjen ligjore më të favorshme për mirëqenien e fëmijës. Së treti, përbën *rregull procedural*, që u imponon autoriteteve detyrimin për të arsyetuar qartë se si interesi i fëmijës është vlerësuar dhe respektuar në vendimin e marrë.

Në jurisprudencën e GjEDNj-së, ky parim është konkretizuar në disa vendime të rëndësishme. Kështu, në rastet penale (**T. kundër Mbretërisë së Bashkuar**¹¹ dhe **V. kundër Mbretërisë së Bashkuar**¹²; **Blokhin kundër Rusisë**¹³), është kërkuar që proceset kundër të miturve të zhvillohen me shpejtësi, me respekt për dinjitetin e tyre dhe me qëllim rehabilitues, duke shmangur çdo formë stigmatizimi.

8 Ligji nr. 37/2017 “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”, f. 4 & 5, i aksesueshëm në faqen e internetit: <https://www.qbz.gokundwral/preview/f83e2041-7f9d-4b5e-aa53-c967bf87810c>, konsultimi i fundit 21.10.2025.

9 Shih: Merkaj, Tereza, *Komentari i Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur i interpretuar me praktikë gjyqësore*, i sipërcituar, Shtëpia botuese “Morava”, Tiranë, dhjetor 2020, f. 58.

10 ROL Platform (2020), *Fëmijët dhe Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut - Vështrim mbi jurisprudencën*, projekt i mbështetur nga AIRE Center dhe Civil Rights Defenders, Tiranë 2019, f. 12–25, i aksesueshëm në internet në faqen: <https://www.rolplatform.org/wp-content/uploads/2020/11/rol-children-alb.pdf> konsultimi i fundit më 18.10.2025.

11 *T. kundër Mbretërisë së Bashkuar*, kërkesa nr. 24724/94, GjEDNj [DhM], 16 Dhjetor 1999.

12 *V. kundër Mbretërisë së Bashkuar*, kërkesa nr. 24888/94, GjEDNj [DhM], 16 Dhjetor 1999.

13 *Blokhin kundër Rusisë* [DhM], kërkesa nr. 47152/06, GjEDNj, 23 Mars 2016.

c. Parimi i përparësisë së masave alternative të shmangies

Në drejtësinë penale për të miturit, qëllimi i ligjvënësimit nuk është ndëshkimi, por edukimi dhe riintegrimi i të miturit në shoqëri. Në këtë aspekt, një ndër parimet themelore të KDPM-së është parimi i përparësisë së masave alternative të shmangies. Në bazë të këtij parimi organet e drejtësisë **udhëzohen të shmangin, sa herë që është e mundur, ndjekjen dhe dënimin penal, duke i zëvendësuar ato me masa rehabilituese dhe riinteguese.**

KDPM-ja vendos një hierarki të qartë të ndërhyrjeve ndaj të miturit, ku **masat alternative** ndaj ndjekjes penale dhe dënimit me burg **kanë përparësi ndaj çdo mase ndëshkuese.** Synimi është që të mituri të mos përfshihet në sistemin penal tradicional, përveç rasteve kur kjo është absolutisht e domosdoshme. Organet e hetimit dhe gjyqimit mund të zbatojnë institutin e shmangies, ndërmjetësimin me viktimën, paralajmërimin, detyrimin për ndjekje shkollë ose programe rehabilitimi, si dhe shërbimin në komunitet. **Këto masa përbëjnë një drejtësi edukative dhe parandaluese, që i jep fëmijës mundësinë të korrigjojë sjelljen pa u stigmatizuar nga dënimi penal.**

Ky parim është shprehje e **humanizmit dhe e drejtësisë edukative.** Shmangia nga ndjekja penale ndihmon në **mbrojtjen e personalitetit të fëmijës** dhe në parandalimin e stigmatizimit që sjell procesi penal. Këto masa japin rezultat vetëm nëse shoqërohen me mbështetje institucionale, me përfshirjen e psikologëve, punonjësve socialë, familjes dhe shkollës, të cilët luajnë rol thelbësor në rehabilitimin e të miturit në përballje me ligjin. **Shmangia është mënyra më efektive për të parandaluar përsëritjen e sjelljeve delikuede dhe për të nxitur përgjegjësinë individuale të të miturit.**

Në Komentin e Përgjithshëm nr. 10 (2007) të Komitetit të OKB-së për të Drejtat e Fëmijës¹⁴, është theksuar se, qëllimi i drejtësisë për të miturit është **“rehabilitimi dhe riintegrimi, jo ndëshkimi”**. Masat alternative e bëjnë të mundur këtë qëllim duke e ruajtur dinjitetin e fëmijës dhe duke i dhënë atij një mundësi reale për ndryshim.

Në këtë aspekt, **vlërësimi individual mund të ndihmojë për të përcaktuar përshtatshmërinë e shmangies nga dënimi penal.** Programet që i lejojnë fëmijët të mbajnë lidhjet e tyre familjare dhe të vazhdojnë shkollimin duket se japin rezultate më të mira se burgjet në të cilat jeta familjare, arsimit dhe puna janë të një standardi të ndryshëm. Paraburgimi çon në nivele më të ulëta të arsimimit dhe në rrezikun e përsëritjes në të ardhmen të shkeljeve penale. Zbatimi i masave alternative të shmangies nga dënimi bën që ndikimi te i mituri bëhet më pak i dëmshëm, fakt që nuk ngjet te të miturit e paraburgosur apo që dënohen me burgim, ku te shumë të dënuar krijohen pasoja mendore dhe emocionale, për shkak të humbjes së lidhjeve të tyre familjare e shoqërore.

Parimi i përparësisë së masave alternative të shmangies i **jep drejtësisë penale për të mitur karakter human,** duke e vënë të miturin në qendër të procesit dhe duke e konsideruar ndërhyrjen penale vetëm si zgjidhje të fundit (*ultima ratio*), pra duke i dhënë përparësi edukimit dhe rishoqërizimit të tyre.

d. Parimi i pjesëmarrjes së të miturit në proces

Neni 16 i KDPM-së përfaqëson konkretizimin normativ të parimit të pjesëmarrjes së të miturit në procesin penal. **Ai e shndërron fëmijën në subjekt aktiv, duke garantuar të drejtën për t'u dëgjuar, për t'u informuar dhe për të marrë pjesë në përshtatje me moshën dhe nivelin e tij të zhvillimit.** Kjo dispozitë përputhet me nenin 12 të KDF-së dhe me Udhërrëfyesin mbi Drejtësinë miqësore ndaj fëmijëve të Këshillit të Evropës, të cilat e konsiderojnë pjesëmarrjen e fëmijës si një të drejtë themelore.¹⁵

14 Committee on the Rights of the Child, *General Comment Nr. 10 (2007): Children's rights in juvenile justice*, CRC/C/GC/10, paragrafët 24–27 dhe 81–84.

15 Council of Europe, *Guidelines on Child-Friendly Justice* (Strasbourg: Council of Europe, 2010), §§ 24–27.

i. E drejta e të miturit për t'u dëgjuar dhe për të shprehur mendimin e tij

Paragrafi i parë i nenit 16 të KDPM-së garanton që i mituri të ketë të drejtë të dëgjohej dhe të shprehë pikëpamjet e tij, të cilat duhen marrë parasysh në përputhje me moshën dhe zhvillimin e tij mendor, duke parashikuar: "***1. E drejta e pjesëmarrjes në proces përfshin të drejtën e të miturit për t'u dëgjuar dhe për të shprehur pikëpamjet e tij, të cilat mbahen parasysh në përputhje me moshën dhe nivelin e zhvillimit të të miturit. Në rastet kur i mituri kërkon të dëgjohej, kërkesa e tij pranohet, përveçse për arsye të rëndësishme, të cilat arsyetohen në vendimin përkatës. Nëse i mituri nuk mund ta ushtrojë këtë të drejtë, mund ta realizojë atë nëpërmjet prindit si përfaqësues ligjor.***"

E drejta për t'u dëgjuar është e sanksionuar shprehimisht në **nenin 12** të KDF-së, që u kërkon shteteve të garantojnë se, **çdo fëmijë që është i aftë të formojë pikëpamjet e veta t'i shpreh ato lirshëm**, dhe që këto pikëpamje **të merren në konsideratë sipas moshës dhe pjekurisë**. Veçanërisht, fëmija duhet të ketë mundësinë të dëgjohej drejtpërdrejt ose përmes përfaqësuesit në çdo procedurë gjyqësore apo administrative që e prek. Kjo normë shënon një kalim cilësor nga "mbrojtja" tek **pjesëmarrja aktive** - fëmija trajtohet si **subjekt i të drejtave**, jo thjesht si objekt i mbrojtjes. Kjo dispozitë është në harmoni me standardin ndërkombëtar të përcaktuar në **Komentin e Përgjithshëm nr. 12 të Komitetit për të Drejtat e Fëmijës**, sipas të cilit dëgjimi duhet të jetë real dhe jo formal.¹⁶

Edhe LDMF-ja, në nenin 13 § 2 të tij, parashikon se: "**1. Fëmijës i garantohet e drejta për t'u dëgjuar vetë ose nëpërmjet prindit, kujdestarit, ose përfaqësuesit në të gjitha proceset administrative e gjyqësore që lidhen me të, sipas rregullave procedurale për këtë qëllim. Nëse autoritetet refuzojnë të marrin mendimin e fëmijës, në çdo rast duhet dhënë vendim i arsyetuar për shkaqet e refuzimit.**"

Sipas **Gjykatës tonë Kushtetuese, e drejta për t'u dëgjuar, në unitet edhe me të drejta të tjera, ka për qëllim garantimin e një procesi gjyqësor ku individit i krijohen mundësitë që, përpara marrjes së vendimit gjyqësor, të dëgjohej realisht për thelbin e çështjes**. Nëpërmjet pjesëmarrjes dhe krijimit të kushteve për t'u dëgjuar, individëve u krijohen mundësi të barabarta për deklarimet e tyre, për parashkrimin e fakteve, provave e vlerësimeve ligjore (*shih vendimet nr. 7, datë 12.03.2010, paragrafi 4; nr. 12, datë 06.06.2005, paragrafi 7, të GJK-së*).¹⁷

Në këndvështrimin e GjEDNj-së, është e vështirë të përfytyrohet se si do të mund t'i ushtronte një i akuzuar të drejtat që i garantohen atij shprehimisht nga neni 6 § 3 c), d) dhe e), konkretisht të drejtën që "të mbrohet vetë", "të pyesë ose të kërkojë që të merren në pyetje dëshmitarët" dhe "të ndihmohet falas nga një përkthyes, në qoftë se nuk kupton ose nuk flet gjuhën e përdorur në gjyq", **po qe se ai nuk është i pranishëm në procesin e tij**. Detyrimi për t'i garantuar të akuzuarit të drejtën për të qenë i pranishëm në sallën e gjyqit është prej elementeve thelbësore të nenit 6.¹⁸

Udhëzimet e Këshillit të Evropës për Drejtësinë Miqësore ndaj Fëmijëve (2010) e vendosin pjesëmarrjen e fëmijës në qendër: **fëmijët "kanë të drejtë të dëgjohej në vendimet që i prekin ata, dhe të rriturit duhet t'i marrin seriozisht pikëpamjet e tyre"**. Udhëzimet kërkojnë **procedura të përshtatura me moshën, gjuhë të thjeshtë dhe mjedis jofrikësues**, si dhe profesionistë të trajnuar që **lehtësojnë shprehjen e pikëpamjeve** (jo thjesht e tolerojnë).¹⁹ Kjo përfshin edhe standarde të veçanta për marrjen në pyetje/dëgjim, përdorimin e materialeve vizuale, pushime të shpeshta gjatë pyetjes apo zhvillimit të procesit gjyqësor, prani të psikologut dhe mundësinë që fëmija të shprehet **drejtpërdrejt në gjykatë ose përmes rrugëve të tjera** kur kërkohet.²⁰

16 Committee on the Rights of the Child, *General Comment Nr. 12 (2009): The right of the child to be heard*, CRC/C/GC/12, par. 32–35.

17 *Udhërrëfyes për jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese 1998-2023 lidhur me ankimin kushtetues individual*, i aksesueshëm në: [udherrefyesh_gjk_2803.pdf](#) f. 167, konsultimi i fundit 20.10.2025.

18 *Hermi kundër Italisë*, kërkesa nr. 18114/02, GjEDNJ [DhM], 18 tetor 2006, §§ 58-59 dhe *Sejdovic kundër Italisë*, kërkesa nr. 56581/00, GjEDNJ [DhM], 1 mars 2006, §§ 81 dhe 84.

19 Council of Europe, *Guidelines on Child-Friendly Justice (2010)*, seksionet mbi pjesëmarrjen/dëgjimin e fëmijëve, i konsultueshëm në: [Council of Europe](#), aksesimi i fundit, 18.10.2025.

20 FRA-EU, *Child-friendly justice – Perspectives and experiences (2015)*, që sintetizon zbatimin praktik të Udhëzimeve të KE-së në: [\(FRA\)](#) konsultimi i fundit 15.10.2025.

Në fushën penale, **Direktiva (BE) 2016/800** (garancitë procedurale për fëmijët e dyshuar ose të akuzuar) në lidhje me të drejtën për t'u dëgjuar, kërkon që i mituri të **informohet paraprakisht dhe në mënyrë të kuptueshme për të drejtat e tij**, të vlerësohet individualisht dhe t'i ofrohet ndihmë ligjore, përfshirë prindin/personin e besuar. E drejta për informacion për natyrën e veprimit procedural që do të marrë pjesë i mituri dhe për të drejtat e tjera që i gëzon nga ligji shërbejnë si **parakushte** të ushtrimit të të drejtës për t'u dëgjuar. Ndihma e mësipërme përbën domosdoshmëri, në mënyrë që i mituri **të ndjekë dhe të marrë pjesë realisht** në çdo fazë të hetimit dhe gjykimit (polici gjyqësore, prokurori, gjykim).

Fëmijët duhet gjithashtu të konsultohen mbi mënyrën në të cilën ata duan të dëgjoen. Një fëmijë nuk duhet të përjashtohet nga të dëgjuarit vetëm në bazë të moshës. Kurdo që një fëmijë merr iniciativën për t'u dëgjuar në një rast që e prek atë, **gjyqtari nuk duhet** (përveç nëse është në interesin më të mirë të fëmijës) **të refuzojë dëgjimin e fëmijës dhe duhet t'i dëgjojë pikëpamjet dhe opinionet e tij/saj për çështjet që ndërlidhen me të në rast.** Avokatët duhet t'i ofrojnë fëmijës të gjitha informacionet dhe shpjegimet e nevojshme në lidhje me pasojat e mundshme të pikëpamjeve dhe/ose opinionëve të fëmijës.

Komiteti i KDF-së thekson se fëmija ka të drejtë të dëgjoet drejtpërdrejtë dhe jo vetëm përmes përfaqësimit të tij, nëse kjo është në interesin e tij më të mirë. Në këtë pikë, duhet të përsëritet rëndësia e qasjes shumë-disiplinore drejt vlerësimit të interesave më të mirë të fëmijës. Me ndihmën e profesionistëve tjerë (punonjësve socialë, psikologë, mësues etj.) pjekuria e fëmijës mund të vlerësohet dhe pikëpamjeve të tij duhet t'u kushtohet rëndësia e duhur. Në këtë fazë duhet të identifikohet çdo vështirësi në komunikim që do të mund të pengonte pjesëmarrjen e plotë të të miturit.

GjEDNj-ja e ka lidhur të drejtën e fëmijës për t'u dëgjuar me nenin 6 (*procesi i drejtë*). Në **S.C. kundër Mbretërisë së Bashkuar**²¹, Gjykata theksoi se për një të mitur nuk mjafton prania fizike: ai/ajo duhet të ketë **"kuptim të gjerë të natyrës së procesit dhe të asaj që është në lojë"** për të marrë pjesë efektivisht, duke argumentuar se: *"në rastin e një fëmije, është thelbësore që ai/ajo të trajtohet në një mënyrë që merr plotësisht parasysh moshën e tij/saj, nivelin e pjekurisë dhe kapacitetet intelektuale dhe emocionale, dhe që ndërmerren hapa për të promovuar aftësinë e tij/saj për të kuptuar dhe për të marrë pjesë në procedura, duke përfshirë kryerjen e seancës në mënyrë të tillë që të ulë sa më shumë që është e mundur ndjenjat e tyre të frikësimit dhe ndalimit"*.

Në **T. kundër Mbretërisë së Bashkuar** dhe **V. kundër Mbretërisë së Bashkuar** Gjykata e Strasburgut kërkoi masa shtesë (gjuhë të thjeshtë, ndërprerje të herëpashershme të pyetjes apo seancës gjyqësore, mjedis të përshtatshëm të zhvillimit të gjykimit) që fëmija të kuptojë e të shprehë, ndryshe, kemi shkelje të nenit 6 të KEDNj-së. Po kështu, në **Panovits kundër Qipros**²², mungesa e ndihmës efektive dhe informimit të kuptueshëm për një i mitur në polici u vlerësua si dështim për të garantuar **pjesëmarrje reale** dhe ushtrim të të drejtave të mbrojtjes. Në **Blokhin kundër Rusisë** GjEDNj konsolidoi idenë se, **vulnerabiliteti (cenueshmëria) i të miturit kërkon garanci të forta për ta bërë pjesëmarrjen e tij në proces reale**, jo formale.

GjEDNj-ja ka sqaruar se **"pjesëmarrja efektive"** për fëmijët është standard i lartë cilësor, por prania formale nuk mjafton, sepse **kuptimi i procedurave nga i mituri, komunikimi aktiv i tij dhe mundësia reale për të shprehur pikëpamje janë thelbësore, ndryshe cenohet barazia e armëve dhe integriteti i procesit.** Në çështjen **Sahin kundër Gjermanisë**,²³ Gjykata konstatoi se shkelja themelore ishte **mosdëgjimi i pikëpamjeve të vetë fëmijës** dhe u shpreh se gjykata kombëtare duhet të merrte hapa të konsiderueshëm për të siguruar kontakt të drejtpërdrejtë me fëmijën dhe se, vetëm nëpërmjet këtij instrumenti, mund të sigurohen interesat më të mira të fëmijës.

21 *S.C. kundër Mbretërisë së Bashkuar*, kërkesa nr. 60958/00, GjEDNj, 15 Qershor 2004, § 26.

22 *Panovits kundër Qipros*, kërkesa nr. 4268/04, GjEDNj, 11 Dhjetor 2008.

23 *Sahin kundër Gjermanisë*, kërkesa Nr. 30943/96, GjEDNj [DhM], 8 Korrik 2003.

E drejta për t'u dëgjuar forcon idenë se fëmija nuk duhet të ketë të drejta më të kufizuara se të rriturit. Të miturit duhet të kenë mundësinë të **shprehin mendimin e tyre**, në mënyrë që **procedura të përshtatet më mirë me nevojat e tyre**. Të dëgjohesh nuk është detyrim, por një e drejtë, çka nënkupton se kundërpeshë e saj është e drejta për të heshtur. Që t'i garantosh të miturit të drejtën për t'u dëgjuar duhet që organi procedues ta dëgjojë me vëmendje atë, sepse dëgjimi kërkon që bashkëbiseduesi të bëjë përpjekje për ta mirëpritur dhe kuptuar fjalën. **Pjesëmarrja efektive e të miturit në proces sigurohet përmes masave të tilla si krijimi i një mjedisi të qetë dhe të sigurt dhe një ritmi procedural të përshtatshëm me aftësitë njohëse të fëmijës.**

Është gjithashtu thelbësore që subjektet në proces të jenë të trajnuar dhe të përdorin mjete që mundësojnë një qasje multidisiplinare. Nëpërmjet fjalës së të miturit tregohen "kufijtë e tij" për të vlerësuar aftësinë për t'iu nënshtruar procesit gjyqësor. Gjyqtari mund të vlerësojë se nuk është në interesin e të miturit të marrë pjesë në gjykim, megjithatë është e domosdoshme që gjyqtari të jetë i detyruar të arsyetojë këtë vendimmarrje. E drejta e fjalës që i njihet të miturit nuk përjashton përgjegjësinë e të rriturve që janë **përfaqësuesit e tij ligjorë** për të marrë pjesë në proces gjyqësor. Ata kanë detyrimin të përfaqësojnë zërin e të miturit dhe ta shoqërojnë atë gjatë gjithë procedurës.

ii. E drejta e përfaqësimit dhe pjesëmarrja vullnetare e të miturit

Paragrafët 2 dhe 3 të nenit 16 të KDPM-së sanksionojnë tre rregulla: (i) **të drejtën e të miturit të marrë pjesë në çdo proces vendimmarrës që e prek, drejtpërdrejt ose përmes përfaqësuesit ligjor;** dhe (ii) **mosdetyrimin e tij të marrë pjesë personalisht në gjykim**, si dhe (iii) ndalimin që **mospjesëmarrja të rëndojë pozitën e tij**. Ky model pasqyron standardet universale dhe evropiane që e trajtojnë fëmijën si **subjekt të së drejtës**, por njëkohësisht **person të cenueshëm** që mund të ushtrojë të drejtat e veta **edhe nëpërmjet përfaqësimit** kur pjesëmarrja personale rrezikon mirëqenien, dinjitetin ose efektivitetin e mbrojtjes.

Neni 12 i KDF-së njeh të drejtën e çdo fëmije që është në gjendje të formojë pikëpamje t'i shprehë ato lirshëm, duke i detyruar organet proceduese që t'i vlerësojnë ato në bazë të moshës/pjekurisë. Kjo dispozitë, kërkon veçanërisht që i mituri "të dëgjohej në çdo procedurë gjyqësore ose administrative që e prek, drejtpërdrejt ose përmes përfaqësuesit". **Komenti i Përgjithshëm Nr. 12 (2009) i Komitetit të OKB-së** e ka interpretuar kështu këtë normë: **pjesëmarrja e fëmijës duhet të jetë e informuar, vullnetare, e sigurt dhe e respektueshme**, me mbështetje komunikimi që të shmangen ndikimet negative (lodhje, frikë, traumatizim). Kjo justifikon parashikimin legjislativ që **nuk e detyron pjesëmarrjen personale** (p.sh., dëgjim në sallë), kur e drejta realizohet në mënyrë të barasvlershme përmes përfaqësuesit.

Gjykata Kushtetuese e ka konsideruar si thelbësore për një proces të drejtë, të drejtën e një personi të akuzuar për të qenë i pranishëm në seancën dëgjimore të akuzave të ngritura. Kjo përfshin jo vetëm praninë fizike, por **edhe aftësinë për të dëgjuar dhe ndjekur procedimet**, për të kuptuar provat dhe argumentet, për të orientuar përfaqësuesit ligjorë dhe për të dhënë fakte. Shteti ka detyrimin për ta njoftuar të pandehurin në mënyrë efektive dhe të përshtatshme për seancën, si dhe të marrë masa për të siguruar praninë e tij. Po ashtu, një nga kriteret e gjykimit të drejtë është edhe e drejta e çdokujt, i akuzuar për një vepër penale, për t'u mbrojtur efektivisht nga një mbrojtës ligjor, e drejtë e cila nuk humbet edhe pse personi i akuzuar penalisht nuk ndodhet vetë personalisht në gjyq (*shih vendimet nr. 14, datë 21.06.2022, paragrafi 24; nr. 84, datë 26.12.2017, paragrafi 13; nr. 45, datë 10.10.2011, paragrafi 15, të GJK-së*).²⁴

E drejta e palëve për të qenë të pranishme dhe për t'u mbrojtur në procesin gjyqësor i ngarkon autoritetet me detyrat që të njoftojnë, në kohë të mjaftueshme, palët dhe mbrojtësit e tyre për datën dhe vendin e mbajtjes së procedurave gjyqësore, për të kërkuar praninë e tyre dhe për të mos i përjashtuar ata padrejtësisht nga gjykimi. Do të ishte pa vlerë përshkrimi në detaje i garancive procedurale të palëve në proces në rast se atyre nuk do t'u

²⁴ Udhërrëfytes për jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese 1998-2023 lidhur me ankimin kushtetues individual, f. 174.

sigurohej ajo që në fakt bën të mundur respektimin e këtyre të drejtave dhe që është pjesëmarrja në gjykim (*shih vendimet nr. 6, datë 26.02.2013, paragrafi 38; nr. 42, datë 29.09.2011, paragrafi 9; nr. 11, datë 18.05.2005, paragrafi 5, të GJK-së*)²⁵.

Udhëzimet e Këshillit të Evropës për Drejtësinë Miqësore ndaj Fëmijëve e vendosin pjesëmarrjen e miturit në gjykim në qendër të një drejtësie të "*aksesueshme, të përshtatur për moshën dhe të përqendruar te fëmija*". Ato kërkojnë që i mituri **të dëgjohej me mjete miqësore** (gjuhë e thjeshtë, intonacion i përshtatshëm, pushime, prani psikologu), dhe të garantohet se **mënyra e pjesëmarrjes** (drejtpërdrejt apo nëpërmjet përfaqësuesit) do të zgjidhet sipas **interesit më të lartë** dhe **aftësive të kuptimit**, dhe jo si formalitet procedural. Udhëzimet parashikojnë gjithashtu se, kur pjesëmarrja personale do të dëmtonte fëmijën, autoritetet mund të zgjedhin përfaqësimin pa pasoja negative për pozitën procesuale të të miturit.

Direktiva (BE) 2016/800 detyron shtetet anëtare të sigurojnë që fëmijët e dyshuar/akuzuar të jenë në gjendje **të kuptojnë dhe të ndjekin procedurat**, duke iu garantuar informacion i kuptueshëm, ndihmë ligjore, prani e prindit/personit të besuar dhe **vlerësim individual** (pjekuri, nevoja psiko-sociale) që do të trajtohet në vijim të këtij studimi. Këto masa e bëjnë **pjesëmarrjen në procedimin penal të të miturit reale** dhe jo iluzore. Ndërkohë, Direktiva njeh të drejtën e të miturit që "*të jenë të pranishëm dhe të marrin pjesë në gjykim*", por nuk e kthen pjesëmarrjen personale në detyrim që mund të përdoret kundër fëmijës kur përfaqësimi siguron të njëjtin standard të mbrojtjes dhe të procesit të rregullt.

GjEDNj-ja, në interpretimin që i ka bërë nenit 6 të KEDNj-së ka mbajtur qëndrimin se, **prania fizike nuk barazohet me pjesëmarrjen në gjykim**, ndaj, në lëmin e të miturve autoritetet duhet të garantojnë që i mituri **e kupton procesin dhe mund të kontribuojë** në mbrojtjen e vet. Ky standard përputhet me logjikën e KDPM-së që **mospjesëmarrja personale nuk mund të përdoret në disfavor** të të miturit, nëse garancitë e mbrojtjes janë respektuar.

Si përfundim, i mituri **ka të drejtë të dëgjohej dhe të marrë pjesë** në procedurat e zhvilluara kundër tij, por **pa e detyruar atë të vetë-ekspozohet personalisht**, kur kjo bie ndesh me interesin e tij, dhe, veçanërisht **pa pësuar pasoja negative** nga zgjedhja e përfaqësimit.

iii. Konflikti i interesit midis të miturit në konflikt me ligjin dhe përfaqësuesit të tij

Paragrafi i shtatë i nenit 16 të KDPM-së rregullon një situatë të ndjeshme, kur mendimi i të miturit bie ndesh me atë të përfaqësuesit ligjor apo prindit. Ligji kërkon që autoritetet të vlerësojnë cilin pretendim i shërben më shumë interesit më të lartë të fëmijës.²⁶ Ky standard pasqyron jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, ku, në rastin **Neulinger dhe Shuruk kundër Zvicrës**²⁷ u theksua se interesi i fëmijës nuk mund të identifikohet gjithmonë me atë të prindërve.

Në procedurat penale që përfshijnë të miturit, **prania e përfaqësuesit ligjor** përbën një garanci thelbësore për respektimin e **interesit më të lartë të fëmijës** dhe të drejtës për një **proces të rregullt ligjor**. Megjithatë, në praktikë, ky parim mbrojtës mund të përplasht me vetë interesin e të miturit, sidomos kur përfaqësuesi ligjor ka interesa personale, emocionale apo juridike të kundërta me ato të fëmijës. Kjo situatë përbën një konflikt interesi, që vë në provë aftësinë e sistemit të drejtësisë për të garantuar mbrojtje efektive dhe të pavarur.

Në rastet kur përfaqësuesi ligjor ka një qëndrim të ndryshëm nga fëmija, për shembull, kur ai kërkon ndëshkim, ndërsa fëmija kërkon rehabilitim, ose kur përfaqësuesi është vetë palë në proces (p.sh. viktimë, kallëzues ose bashkëpunëtor), lind një konflikt objektiv interesi që komprometon të drejtën e fëmijës për mbrojtje të drejtë.

25 *Udhërrëfyes për jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese 1998-2023 lidhur me ankimin kushtetues individual, f.173.*

26 *Neulinger and Shuruk kundër Zvicrës*, kërkesa nr. 41615/07, GjEDNj, 6 Korrik 2010, §§ 138–140

27 *Neulinger and Shuruk kundër Zvicrës*, §§ 131–140.

GjEDNj-ja ka nënvizuar se **asnjë person që përfaqëson një të mitur nuk mund të ketë interesa të kundërta me të**, sepse kjo do të cenonte **thelbin e nenit 6 të KEDNj-së**, që garanton **proces të drejtë dhe mbrojtje efektive**²⁸

Konflikti i interesave në marrëdhënien përfaqësues-i mitur shfaqet në disa rrethana që mund t'i përmbledhim si në vijim:

- (i) kur përfaqësuesi ligjor është i përfshirë në veprën penale (p.sh. në raste dhune familjare);
- (ii) kur ai nuk pranon strategjinë mbrojtëse të fëmijës;
- (iii) kur përfaqësuesi kërkon të shmangë përgjegjësinë e tij prindërore duke e zhvendosur fajin te fëmija;
- (iv) kur interesi moral, social ose ekonomik i prindit (p.sh. ruajtja e reputacionit, shmangia e stigmatizimit, ose ulja e kostove gjyqësore) bie ndesh me interesin juridik të të miturit.

Në këto raste, përfaqësimi ligjor humbet funksionin mbrojtës dhe bëhet burim presioni psikologjik për të miturin. GjEDNj ka theksuar në mënyrë të përsëritur se e drejta e të miturit për avokat të pavarur është një garanci e domosdoshme kundër konfliktit të interesave.²⁹ **Shtetet kanë detyrimin pozitiv** të ndërhyjnë **kur ekziston ose dyshohet ekzistenca e një konflikti interesi**, duke garantuar **emërimin e një përfaqësuesi të posaçëm (ad hoc)** kur mungon përfaqësuesi ligjor dhe të informojë të miturin mbi të drejtat e tij në procedurale.

Konflikti i interesave midis të miturit dhe përfaqësuesit të tij ligjor **përbën një sfidë të ndjeshme për drejtësinë penale ndaj të miturve**, sepse prek drejtpërdrejt **të drejtën për mbrojtje efektive**. Ky parim, i përforcuar nga jurisprudenca e **GjEDNj-së**, kërkon që **mbrojtja e fëmijës të mos mbetet formale**, por të sigurojë që **zëri i tij të dëgjohej dhe të mbrohet** përtej çdo konflikti të mundshëm të interesave.

e. Parimi i shqyrtimit të çështjes pa vonesë dhe me përparësi

Neni 42, pika 2, i Kushtetutës, sanksionon se: " 2. *Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.*" Nga përmbajtja e kësaj dispozite kushtetuese konkludohet se, gjykimi brenda një afati të arsyeshëm është pjesë esenciale e të drejtës për një proces të rregullt ligjor. Kërkesa për "gjykim brenda një afati të arsyeshëm" vendos detyrimin për organizimin e sistemit gjyqësor në mënyrë të tillë që prokuroritë dhe gjykatat të plotësojnë standardet që kërkon e drejta për proces të rregullt ligjor. Në këtë drejtim gjykatat kanë për detyrë të sigurojnë që të gjitha subjektet që marrin pjesë në proces të sillen në mënyrë që të evitojnë çdo vonesë të panevojshme (*Vendimet nr. 33, datë 01.11.2021, paragrafi 27; nr. 22, datë 20.03.2017, paragrafi 11; nr. 12, datë 05.03.2012, paragrafi 12, të GJK-së*).³⁰

Edhe neni 6 § 1 i KEDNj-së sanksionon të drejtën e çdo personi që çështja e tij të dëgjohej brenda një afati të arsyeshëm. **Ky parashikim në fushën penale ka si qëllim që të sigurojë të akuzuarit të mos mbeten për një kohë tepër të gjatë nën një akuzë dhe të vendoset në një kohë të shpejtë për bazueshmërinë e saj.**³¹ Karakteri i arsyeshëm i kohëzgjatjes së një procedure vlerësohet sipas rrethanave të çështjes, të cilat kërkojnë një vlerësim tërësor³². Sado që disa faza të procedurës mund të jenë zhvilluar me një ritëm të pranueshëm, prapëseprapë kohëzgjatja e përgjithshme e ndjekjes penale mund ta tejkalojë një "afat të arsyeshëm"³³. Neni 6 këshillon shpejtësi të procedurave gjyqësore, por ai sanksionon gjithashtu edhe parimin, më të përgjithshëm, të miradministrimit të drejtësisë. Është më e udhës që të ruhet një baraspeshë e drejtë ndërmjet aspekteve të ndryshme të kësaj kërkesë themelore³⁴.

28 S.C. kundër Mbretërisë së Bashkuar, kërkesa nr. 60958/00, GjEDNj, 15 Qershor 2004, §§ 28–36.

29 Panovits kundër Qipros, §§ 68–74; Blokhin kundër Rusisë, § 195.

30 Udhërrëfyes për jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese 1998-2023 lidhur me ankimin kushtetues individual, op. cit. f. 248.

31 Wemhoff kundër Gjermanisë, kërkesa nr. 2122/64, GjEDNj, 27 Qershor 1968, § 18; Kart kundër Turqisë, kërkesa nr. 8917/05, GjEDNj [DhM], 3 Dhjetor 2009, § 68.

32 Boddaert kundër Belgjikës, kërkesa nr. 12919/87, GjEDNj, 12 tetor 1992, §§ 36, 39.

33 Dobbartin kundër Francës, kërkesa nr. 13089/87, GjEDNj, 25 shkurt 1993, § 44.

34 Boddaert k. Belgjikës, § 39.

Në këtë kontekst, **edhe neni 17 i KDPM-së vendos një detyrim të qartë për trajtimin me përparësi dhe pa vonesa të çdo çështjeje që përfshin të mitur në procesin penal.** Kjo dispozitë është e frymëzuar nga neni 40 § 2 (b) (iii) i KDF-së, ku përcaktohet se çdo fëmijë i akuzuar për shkelje të ligjit penal ka të drejtë që *“çështja e tij të shqyrtohet pa vonesë nga një autoritet kompetent, i pavarur dhe i paanshëm”*. Në thelb, ky nen synon të garantojë që **koha e procesit të mos bëhet vetë një formë ndëshkimi**, pasi zvarritja e procedurës mund të ketë pasoja serioze psikologjike, edukative dhe sociale për fëmijën. Pra, drejtësia për fëmijët nuk duhet të jetë vetëm e drejtë, por edhe e shpejtë, sepse çdo vonesë cenon qëllimin edukativ dhe rehabilitues të sistemit.

Gjykata e Strasburgut ka theksuar në mënyrë të përsëritur se, **në rastet që përfshijnë të mitur**, autoritetet duhet të tregojnë kujdes të veçantë, duke u përpjekur për **përfundim sa më të shpejtë të procesit**, për shkak të ndikimit që vonesat kanë në zhvillimin dhe stabilitetin e fëmijës. Në çështjen *T. dhe V. kundër Mbretërisë së Bashkuar*, GjEDNj vlerësoi se proceset ndaj të miturve duhet të jenë “jo vetëm të drejta, por edhe të përqendruara dhe të shkurtra në kohë”, për të shmangur stresin e zgjatur dhe pasojat arsimore. Po kështu, në *Blokhin kundër Rusisë* [DhM] (2016), Gjykata theksoi se vonesat në procesin penal ndaj një të mituri mund të çojnë në shkelje të nenit 6 dhe nenit 3 të Konventës, nëse ato krijojnë situata të ankthit, pasigurisë dhe izolimit të zgjatur për fëmijën. Gjykata e ka lidhur gjithashtu këtë standard me **interesin më të lartë të fëmijës**, duke kërkuar që çdo vonesë të jetë jo vetëm e justifikuar ligjërisht, por edhe **proporcionale me nevojat e zhvillimit të fëmijës**.

Dispozita e nenit 17 të KDPM-së *së pari*: vendos parimin e përgjithshëm të shpejtësisë dhe përparësisë në çdo fazë – nga hetimi deri te ekzekutimi i vendimit gjyqësor – duke e lidhur qartësisht me **interesin më të lartë të fëmijës** dhe, *së dyti*: vihet theksi se, çështjet që përfshijnë të mitur në konflikt me ligjin, por edhe ato që përfshijnë të mitur viktimë ose dëshmitarë, duhet të trajtohen me përparësi, duke garantuar që procesi **“të mos përkeqësojë traumën e përjetuar”**.

Ky nen mund të cilësohet si një garanci për drejtësi efektive, që synon të reduktojë efektet negative të sistemit penal mbi personalitetin në zhvillim të të miturit. Në periudhën e zhvillimit të personalitetit, pritja e gjatë për një vendim gjyqësor përjetohet si ndëshkim dhe ndikon në **ndjenjën e pasigurisë, vetëvlerësimit dhe integritet social të fëmijës**. Prandaj neni 17 është i lidhur ngushtë me parimin e rehabilitimit dhe riintegritet social, që përbën objektivin kryesor të drejtësisë për të miturit, sipas Komentit të Përgjithshëm nr. 10 të Komitetit për të Drejtat e Fëmijës (2007).

f. Parimi i pjesëmarrjes së detyrueshme të psikologut

Neni 18 i KDPM përcakton qartë se në **çdo fazë të procedimit penal** ndaj një të mituri në konflikt me ligjin, si edhe në rastet kur i mituri është **viktimë ose dëshmitar, prania e psikologut është e detyrueshme**. Kjo normë shpreh një nga garancitë themelore të drejtësisë miqësore për fëmijët: sigurimin që fëmija **të mos dëmtohet emocionalisht dhe të mund të komunikojë lirshëm e pa frikë** me organet e drejtësisë.

E drejta e të miturit për të pasur në çdo procedurë gjyqësore dhe administrative ndihmë psikologjike falas është parashikuar edhe në nenin 29 § 1 të LDMF-së, sipas të cilit *“1. Fëmijës, në çdo proces administrativ e gjyqësor, i garantohet ndihmë juridike e psikologjike falas, në përputhje me interesat, zhvillimin dhe aftësitë e tij.”* Ky përbën një detyrim pozitiv për shtetin shqiptar që, paragrafi i dytë i nenit 29 kërkon që t’i ofrohet *“fëmijës drejtpërdrejt dhe pa pengesa, bazuar në parimin e mosdiskriminimit dhe të interesit më të lartë të fëmijës”*. Ndihma psikologjike që i jepet të miturit përfshin *“të gjitha veprimet, si dhe këshillimet që kryen psikologu i caktuar nga autoritetet përgjegjëse sipas legjislacionit në fuqi.”*

Në jurisprudencën e GjEDNj-së nevoja për mbrojtje psikologjike të fëmijëve gjatë procesit gjyqësor është parë e lidhur me nenin 3 të KEDNj-së (ndalimi i trajtimit çnjerëzor ose poshtëruar) dhe me nenin 8 (e drejta për respektimin e jetës private). Në çështjen *Z. dhe tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, **Gjykata theksoi se shteti ka detyrime pozitive për të mbrojtur fëmijët nga dëmtime psikologjike gjatë procedurave gjyqësore, përfshirë mënyrën**

e marrjes në pyetje dhe komunikimit me organet e hetimit.³⁵ Në *S.N. kundër Suedisë*, Gjykata theksoi se fëmijët viktimë të abuzimit seksual duhet të merren në pyetje “në kushte që shmangin frikësimin, nën mbikëqyrjen e një profesionisti psikolog ose social”.³⁶

Në *Blokin kundër Ruisë*, GjEDNj e lidh në mënyrë eksplicite **mungesën e mbështetjes psikologjike gjatë paraburgimit të një të mituri** me shkeljen e nenit 3 të Konventës, duke theksuar se: “*fëmijët janë veçanërisht të ndjeshëm ndaj efekteve të izolimit, presionit psikologjik dhe komunikimit të pakujdesshëm nga autoritetet*”.³⁷ Këto raste tregojnë se përfshirja e psikologut në çdo fazë të procesit nuk është vetëm çështje procedurale, por detyrim konvencional që buron nga KEDNj-ja, si pjesë e mbrojtjes së dinjitetit dhe integritetit emocional të fëmijës.

Sipas **pikës 2 të nenit 18**, psikologu asistues ka dy funksione: **të ofrojë mbështetje psikologjike** për të miturin, për të siguruar që ky të ndihet i kuptuar dhe i mbrojtur gjatë procesit dhe të **vlërësojë thëniet e tij**, në përputhje me zhvillimin mendor dhe emocional. Këto funksione janë thelbësore për të garantuar **vlfshmërinë e dëshmisë**, sepse një deklaram i dhënë nën presion ose në gjendje emocionale të brishtë mund të jetë i pasaktë ose i pavlefshëm juridikisht. Në këtë kuptim, psikologu nuk është vetëm mbështetës, por edhe **garant procedural i drejtësisë**. **Mosprania e psikologut** në pyetjen e të miturit përbën shkelje të rëndë të së drejtës për një proces të rregullt ligjor dhe çon në **papërdorshmëri të provës**.

Pika 4 e nenit 18 përcakton një risi shumë të rëndësishme: nëse është e mundur, **i njëjti psikolog asistues duhet të ndjekë fëmijën gjatë gjithë procesit penal**. Ky parim i “vazhdimësisë profesionale” është në përputhje me **Udhëzimet e Këshillit të Evropës për Drejtësinë Miqësore ndaj Fëmijëve (neni 53)**, që kërkojnë të shmanget “*rotacioni i profesionistëve që punojnë me fëmijën*”, për të ruajtur besimin dhe ndjenjën e sigurisë psikologjike. Ky aspekt është veçanërisht i rëndësishëm për fëmijët viktimë, sepse **ndërrimi i vazhdueshëm i profesionistëve mund të çojë në “riviktimizim të dytë”** – pra, në rikthimin e traumës përmes ripërjetimit të ngjarjes.

Neni 18 përfundon me një rregull procedural: **psikologu që ofron mbështetje emocionale** përgjatë procesit penal **nuk mund të veprojë si ekspert vlerësues për të njëjtin fëmijë** (që hartojnë raportin e vlerësimit psikologjik të tyre). Ky ndalim parandalon konfliktin e interesit dhe garanton objektivitetin e ekspertimit psikologjik. Në doktrinën ndërkombëtare, ky standard njihet si **parimi i ndarjes së roleve** (*role separation principle*).³⁸

35 *Z. dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar*, kërkesa nr. 29392/95, GjEDNj, [DhM], 10 Maj 2001.

36 *S.N. kundër Suedisë*, kërkesa nr. 34209/96, GjEDNj, 2 Korrik 2002, §§ 47–52.

37 *Blokin kundër Ruisë*, §§ 195–202.

38 United Nations Economic and Social Council, *Guidelines on Justice in Matters involving Child Victims and Witnesses of Crime*, ECOSOC Resolution 2005/20, 22 Korrik 2005, § 22.

5. TË DREJTAT DHE GARANCITË PROCEDURALE TË TË MITURIT NË KONFLIKT ME LIGJIN GJATË PROCESIT PENAL

Neni 19 i KDPM-së përmbledh dhe sistematizon të drejtat themelore që i garantohen një të mituri gjatë procesit penal. Ai parashikon se i mituri në konflikt me ligjin gëzon jo vetëm të drejtat e përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale (KPP), por edhe një sërë të drejtash të posaçme, që burojnë nga nevojat e tij zhvillimore, sociale dhe psikologjike. Qëllimi i kësaj dispozite është të sigurojë një trajtim të veçantë procedural dhe mbrojtës, i cili i përgjigjet karakterit jo ndëshkues, por edukativ dhe rehabilitues të drejtësisë për të miturit. Më poshtë do të trajtojmë disa nga të drejtat procedurale më të qenësishme të të miturve që përballen me drejtësinë penale, duke nisur me standardet ndërkombëtare që parashikojnë këto të drejta.

a. Standardet ndërkombëtare mbi të drejtat procedurale të fëmijëve në konflikt me ligjin

Të drejtat e parashikuara në nenin 19 të KDPM-së janë rezultat i një procesi të gjerë harmonizimi me **standardet ndërkombëtare të mbrojtjes së fëmijëve**, që burojnë nga **sistemi i Kombeve të Bashkuara, Këshillit të Evropës dhe Bashkimit Evropian**. Tre dokumentet kyçe që formojnë themelin e këtij standardi janë: **KDF-ja (neni 40), Udhëzimet e Këshillit të Evropës për Drejtësinë Miqësore ndaj Fëmijëve**, dhe **Direktiva (BE) 2016/800** e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, mbi garancitë procedurale për fëmijët e dyshuar ose të akuzuar në procedime penale.

Neni 40 i KDF-së përbën bazën themelore ndërkombëtare të drejtësisë penale për të miturit. Ai kërkon që çdo fëmijë i dyshuar ose i akuzuar për një vepër penale të trajtohet **“në mënyrë që të përforcojë ndjenjën e dinjitetit dhe vlerës personale, duke nxitur respektin për të drejtat e njeriut dhe për integritetin e të tjerëve”**. Neni garanton një sërë të drejtash themelore, si: ndihmë juridike dhe përgatitje të mbrojtjes (neni 40 § 2 (b) (ii)), informim të menjëhershëm e të kuptueshëm për procesin penal të nisur (neni 40 § 2 (b) (i)), mbrojtje kundër vetëfajësimit (40 § 2 (b) (iv)), dhe pjesëmarrje efektive në proces. Për më tepër, ai kërkon që shtetet të krijojnë procedura të veçanta gjyqësore për fëmijët, të orientojnë drejt **masave alternative të shmangies ndaj ndëshkimit penal** dhe të garantojnë **rehabilitimin e fëmijës në shoqëri**.

Udhëzimet e Këshillit të Evropës për Drejtësinë Miqësore ndaj Fëmijëve, të miratuara nga Komiteti i Ministrave më 17 nëntor 2010, përbëjnë **kornizën më të plotë evropiane të politikave mbi drejtësinë që përfshin fëmijët**. Dokumenti përkufizon **“drejtësinë miqësore ndaj fëmijëve” si një drejtësi që është e aksesueshme, e përshtatur për moshën, e përqendruar në fëmijën, me respekt për dinjitetin e tij dhe për nevojat zhvillimore**. Udhëzimet kërkojnë që **të gjithë profesionistët e përfshirë në sistemin e drejtësisë** - gjyqtarë, prokurorë, policë dhe psikologë - **të trajtohen posaçërisht për të punuar me fëmijë**; që procedurat të zhvillohen **pa vonesë dhe në mjedise jo frikësuese**; dhe që t'u jepen përparësi **masave alternative ndaj burgimit**, duke siguruar informim të qartë, pjesëmarrje aktive dhe mbështetje psikologjike. Pika 57 e dokumentit përcakton shprehimisht se fëmijët duhet të shoqërohen gjithmonë nga prindër ose persona të besuar, ndërsa komunikimi me ta duhet të bëhet “në mënyrë të përshtatur me moshën dhe zhvillimin e tyre”.

Direktiva (BE) 2016/800 mbi garancitë procedurale për fëmijët e dyshuar ose të akuzuar në procedime penale, e miratuar më 11 maj 2016 nga Parlamenti Evropian dhe Këshilli, përfaqëson **standardin më të avancuar detyrues në të drejtën e BE-së për mbrojtjen procedurale të fëmijëve**. Ajo u kërkon shteteve anëtare të garantojnë që çdo fëmijë i dyshuar ose i akuzuar në procedura penale të trajtohet në përputhje me **nenin 24 të Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian**, që njih fëmijët si persona me të drejta dhe nevoja të veçanta. **Direktiva përcakton shtatë garanci thelbësore: (1) e drejta për informim të kuptueshëm; (2) e drejta për ndihmë ligjore;**

(3) e drejta për vlerësim individual të gjendjes së fëmijës; (4) e drejta për përfshirje të prindërve ose personit të besuar; (5) kufizimi i privimit nga liria si mjet i fundit; (6) e drejta për ruajtjen e konfidencialitetit; dhe (7) regjistrimi audio-vizual i marrjes në pyetje.

Në përfundim mund të thuhet se, paragrafët 1 dhe 2 të nenit 19 të KDPM-së afirmojnë **mbrojtjen e përfortuar ligjore për të miturit në konflikt me ligjin**, pasi përveç zbatimit të garancive të KPP-së, kërkohet edhe respektimi i garancive të veçanta për shkak të moshës së të miturit. **Kjo mbrojtje shtesë është e ngjashme me modelin evropian të drejtësisë për fëmijë**, ku procedurat penale duhet të jenë të njëjtat në thelb, por të përshtatura në formë.

b. Njohja e të miturit me të drejtat procedurale nëpërmjet letrës së të drejtave

Një nga risitë që kanë sjellë ndryshimet e bëra në Kodin e Procedurës Penale me reformën e kryer në vitin 2017³⁹ është detyrimi i ngarkuar organit procedues për t'i vënë në dispozicion të personit nën hetim/të pandehurit letrën e të drejtave. Këto të drejta duhet të jenë pasqyruar në një akt të shkruar dhe duhet detyrimisht të nënshkruhen nga i hetuari. Kodi parashikon disa raste ku Policia Gjyqësore (PGJ) apo prokurori e kanë detyrim procedural t'i bëjnë me dije personit nën hetim letrën e të drejtave që lidhen me garantimin sa më efektiv të të drejtës së mbrojtjes.

Ndërsa KPP-ja hesht në lidhje me pasojat që sjell mosdhënia e të letrës së të drejtave te personi nën hetim në rastet kur pyetet apo i merren deklaratime apo kur ai merr pjesë në kryerjen e akteve procedurale ku prani e tij kërkohet nga ligji, neni 256, që rregullon pyetjen e detyrueshme nga prokurori të personit të dyshuar për kryerjen e një veprë penale, për të cilën ai është arrestuar në flagrancë apo është ndaluar, në pikën 3 të tij⁴⁰ parashikon aplikimin e sanksionit procedural të papërdorshmërisë në gjykim të deklaratimeve të dhanë prej tij pa iu vënë në dispozicion letra e të drejtave.

Rastet e parashikuara nga KPP-ja ku organi që procedon është i detyruar që t'i bëjë të ditur paraprakisht personit të hetuar/të pandehurit letrën e të drejtave personit nën hetim, janë si në vijim:

- (i) kur personi nën hetim pyetet për herë të parë apo përpara kryerjes së akteve ku prania e tij është e detyrueshme - neni 34/a § 2;
- (ii) kur personi arrestohet në flagrancë, në kushtet e neneve 251 & 252) apo ndalohet si i dyshuar për një krim, sipas neni 253 të KPP-së – nenet 34/b § 2 dhe 255 § 3;
- (iii) kur PGJ-ja bën ekzekutimin e një mase sigurimi të caktuar në mungesë të të hetuarit, në zbatim të nenit 244 të KPP-së nga gjyqtari i hetimeve paraprake– neni 246 § 1;
- (iv) kur i arrestuari apo i ndaluar merret në pyetje nga prokurori – neni 256 §§ 2 & 3.
- (v) kur personi që i atribuohet kryerja e veprës penale merret në pyetje nga PGJ-ja– neni 296 § 1.
- (vi) kur prokurori i dërgon ftesë për paraqitje personit nën hetim, me qëllim marrjen në pyetje të tij – neni 308 § 2 (d).

Të drejtat që i bëhen me dije personit nën hetim, përfshi edhe të miturit në konflikt me ligjin, sipas përmbajtjes së pikës 1, të nenit 34/a të KPP-së, janë:

- a) të njoftohet në një kohë sa më të shkurtër, në gjuhën që kupton, për veprën penale për të cilën hetohet, si edhe për shkaqet e akuzave;
- b) të përdorë gjuhën që flet ose kupton ose të përdorë gjuhën e shenjave, si dhe të ndihmohet nga një përkthyes dhe interpretues nëse ka paaftësi të kufizuar në të folur dhe në të dëgjuar;
- c) të heshtë, të paraqesë lirisht mbrojtjen e tij, si dhe të mos u përgjigjet pyetjeve të caktuara;
- ç) të mbrohet vetë ose me ndihmën e një mbrojtësi të zgjedhur prej tij;

39 Me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017, KPP-ja pësoi ndryshime të thella në 284 dispozita. Për më shumë shih përmbajtjen e këtij ligji në faqen zyrtare të internetit të QPZ-së: https://qbz.gokundwral/share/vSIGWAwyQkqmp4oM_LWMTw.

40 Pika 3 e nenit 256 të KPP-së bën këtë përcaktim: "3. **Deklarimet e bëra nga i arrestuari ose i ndaluar përpara se të ketë marrë letrën e të drejtave ose përpara takimit me mbrojtësin e tij, nuk mund të përdoren.**"

- d) të ketë një mbrojtës të siguruar nga shteti, nëse mbrojtja është e detyrueshme ose nuk ka mundësi financiare për të pasur një mbrojtës, sipas parashikimeve të këtij Kodi dhe legjislacionit në fuqi për ndihmë juridike;
- d) të takohet privatisht dhe të komunikojë me mbrojtësin që e përfaqëson;
- e) të ketë kohë të mjaftueshme dhe lehtësi për të përgatitur mbrojtjen.

Ndërkohë, personi i arrestuar apo i ndaluar, përveç të drejtave të mësipërme, për të cilat njoftohet shprehimisht dhe për njohjen me to nënshkruan dokumentin ku janë cituar, **gëzon edhe disa të drejta specifike**⁴¹, për shkak të kufizimit të lirisë së tij dhe posaçërisht të drejtën:

- a) të takojë vetëm për vetëm mbrojtësin e tij përpara marrjes në pyetje për herë të parë;
- b) të njihet me aktet, provat e nevojshme dhe arsyet e arrestimit ose ndalimit të tij;
- c) të kërkojë që një anëtar i familjes ose një person tjetër i afërt të njoftohet menjëherë për arrestimin e tij. Në rast se i arrestuari ose i ndaluari është shtetas i huaj, ai ka të drejtë të kërkojë të njoftohet përfaqësia konsullore ose diplomatike e vendit të tij dhe në rast se është person pa shtetësi apo refugjat, ai ka të drejtë të kërkojë të njoftohet një organizatë ndërkombëtare;
- ç) të marrë menjëherë përkujdesjen e nevojshme mjekësore.

Në lidhje me të miturin në konflikt me ligjin, neni 35 i KPP-së (i trajtuar më herët në këtë studim), nuk bën ndonjë rregullim të posaçëm në dukje për të miturit, por gjithsesi ai parashikon që atij i sigurohet ndihmë juridike dhe psikologjike, në çdo gjendje dhe shkallë të procedimit, me praninë e prindit, kujdestarit ligjor ose të personave të tjerë të kërkuar nga i mituri dhe të pranuar nga autoriteti që procedon.

Ndërkaq, KDPM-ja e përmend letrën e të drejtave që i dorëzohet të miturit vetëm në rastin e arrestimi/ndalimit të tij nga PGJ-ja apo prokurori, të rregulluar nga neni 73 § 3 të tij, duke sanksionuar se: "**3. Organi procedues menjëherë sapo e sjell të miturin në mjediset e institucionit përkatës njofton përfaqësuesin ligjor të të miturit ose personin e rritur, të treguar dhe pranuar prej tij, lidhur me arrestimin e të miturit, vendndodhjen e mbajtjes në paraburgim dhe shpjegon arsyet e arrestimit dhe i vë në dispozicion një kopje të Letrës së të Drejtave.**"

Gjithsesi, ky parashikim nuk pengon zbatimin e dispozitave relevante të KPP-së, për sa kohë vetë neni 5 i KDPM-së që rregullon raportin e këtij të fundit me ligje të tjera, lejon që të zbatohen edhe dispozitat e Kodit të Procedurës Penale për sa kohë *lex specialis* për fëmijët (KDPM-ja) nuk i rregullon.

Duke u kthyer në analizën e **nenit 35 § 1 të KPP-së** në lidhje me ofrimin e ndihmës juridike dhe psikologjike ndaj të miturit, çmohet se kjo garanci e dhënë **përbën një detyrim pozitiv për organet proceduese që në çdo rast letrën e të drejtave t'ia vënë në dispozicion të miturit në prani të përfaqësuesit i tij ligjor, mbrojtësit dhe psikologut.** Kjo prani duhet provuar me nënshkrimin e letrës së të drejtave, krahas të miturit, edhe nga "garantuesit" e të drejtës së mbrojtjes së të tij – prindi, mbrojtësi dhe psikologu. Nënshkrimi i këtij dokumenti nga këta të fundit, përbën një garanci që të drejtat procedurale të mbrojtjes janë kuptuar dhe shpjeguar në mënyrë të mjaftueshme nga i mituri në konflikt me ligjin, përpara kryerjes së veprimeve procedurale që ligji kërkon pjesëmarrjen e detyrueshme të tij. Rrjedhimisht, përgjatë studimit do të qëmtohet fakti dhe koha e dorëzimit të letrave të të drejtave, si dhe për personat që i kanë nënshkruar ato.

c. E drejta për t'u informuar menjëherë për procedimin penal

Informimi i menjëhershëm i mundëson të miturit të kuptojë natyrën e procedurës dhe të drejtat e veta. Sipas KDPM-së informacioni duhet t'i përshtatet **nivelit të zhvillimit individual** të të miturit, jo vetëm moshës kronologjike. Ky është një standard i harmonizuar me **nenin 28 § 2 fjalia e parë**⁴² të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, **nenin**

⁴¹ KPP, neni 34/b (1).

⁴² Neni 28 § 2 fjalia e parë e Kushtetutës lexon: "**1. Kushdo, të cilit i hiqet liria, ka të drejtë të njoftohet menjëherë në gjuhën që ai kupton, për shkaqet e kësaj mase, si dhe për akuzën që i bëhet.**"

40 § 2 (b) (iii) të KDF⁴³, nenet 5 § 2⁴⁴ dhe 6 § 3(a)⁴⁵ të KEDNJ-së, nenin 4 të Direktivës (BE) 2016/800, Udhëzimet e Këshillit të Evropës për Drejtësinë Miqësore ndaj Fëmijëve dhe Komentin e Përgjithshëm nr. 10 (2007) të Komitetit të OKB-së për të Drejtat e Fëmijës.

Në referim të nenit 4 të Direktivës (BE) 2016/800, fëmijës duhet t'i ofrohet një shpjegim i të drejtave të tij/saj në një gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme. Shpjegimi i procesit do të ndihmojë të miturin të kuptojë se çfarë pritet prej tij gjatë procedurave dhe kur ai do të jetë në gjendje të shprehet përpara gjykatës. Është po aq e rëndësishme të sigurohet që fëmijët të informohen siç duhet gjatë procedurave gjyqësore, në mënyrë që ata të jenë në gjendje t'i ndjekin ato dhe të marrin pjesë aty ku është e përshtatshme. Gjyqtarëve dhe avokatëve mund t'u duhet kohë për t'u shpjeguar fëmijëve se çfarë po ndodh, në mënyrë që ata të mos ndjehen të humbur. Përveç procedurës, avokatët duhet të sigurojnë gjatë gjithë procedurës (por sidomos para dhe gjatë gjykimit) që klientët e tyre fëmijë i kuptojnë akuzat kundër tyre dhe rezultatet e mundshme.⁴⁶

Ndërkohë, GjEDNJ pranoi në *S.C. kundër Mbretërisë së Bashkuar se, të akuzuarit i duhet të kuptojë gjerësisht natyrën e procesit të gjykimit dhe asaj që rrezikon, përfshirë edhe peshën e çdo ndëshkimi që mund t'i jepet, në mënyrë që individit të marrë pjesë në mënyrë efektive në procedurë*. Megjithatë, duhet të përmendet se Direktiva nuk kërkon që fëmijët të kuptojnë çdo aspekt të gjykimit.

Në këtë pikë duhet të vëmë në dukje se, **aftësia e një fëmije për të kuptuar pozitën e tyre dhe për të kuptuar informacionin që u është dhënë nga organi i procedimit apo edhe mbrojtësi i tyre në përgjithësi është më i kufizuar se ai i një të rrituri**. Duhet pasur parasysh se një fëmijë i cili është arrestuar nga policia mund të përballet për herë të parë me sistemin e drejtësisë penale dhe ata mund ta përjetojnë këtë përvojë më vështirë se shumica e të rriturve. Avokati, psikologu dhe prindi duhet të bëjnë kujdes të veçantë për të siguruar që një fëmijë i dyshuar të kuptojë informacionin që i jepet, qoftë duke e interpretuar atë vetë ose duke nxitur policinë të përdorë një gjuhë të thjeshtë, miqësore me fëmijët dhe duke shpjeguar pasojat që mund të vijnë.

Në këtë aspekt, **Gjykata Kushtetuese shqiptare**, ka arsyetuar se, qëllimi i së drejtës për t'u informuar për akuzën, i sanksionuar nga neni 6(3)-a i KEDNJ-së, është që informacioni i kërkuar t'i jepet të akuzuarit në momentin e ngritjes së akuzës ose në momentin e fillimit të procesit gjyqësor dhe është thelbësor fakti që vepra penale për të cilën dënohet një person është ajo për të cilën ai është akuzuar (*Vendimet nr. 24, datë 30.04.2012, paragrafët 12 - 13 dhe nr. 4, datë 10.02.2012, paragrafi 12, të GJK-së*).⁴⁷

Ndërsa në çështjen *T. dhe V. kundër Mbretërisë së Bashkuar*, GjEDNJ konstatoi se përdorimi i gjuhës juridike të ndërlikuar gjatë procesit ndaj të miturve shkelte nenin 6, pasi fëmijët nuk mund ta kuptonin realisht natyrën e akuzës. Informimi nuk duhet të jetë formal, por **efektiv dhe i përshtatur me zhvillimin e të miturit**, me ndihmën e psikologut kur është e nevojshme.

"Informimi i menjëhershëm" i cituar në aktet normative të mësipërme, në kontekstin e procedurave penale ndaj të miturve nënkupton detyrimin që çdo informim, njoftim apo ndërveprim procedural me të miturin të ndodhë **sa**

43 Neni 40 § 2 (b) (iii) i KDF-së ka këtë përmbajtje: "2. Për këtë qëllim dhe duke pasur parasysh dispozitat përkatëse të instrumenteve ndërkombëtare, Shtetet Palë sigurojnë në veçanti që: ... iii) Çështja e tij të shqyrtohet pa vonesë nga një autoritet ose organ gjyqësor kompetent, të pavarur dhe të paanshëm, sipas një procedure të drejtë ligjore, në praninë e ndihmës juridike ose të një ndihme tjetër të përshtatshme, dhe, përveç kur gjykohet se kjo nuk është në interesin më të mirë të fëmijës, sidomos për arsye të moshës ose gjendjes së tij, të prindërve ose përfaqësuesve të tij ligjorë."

44 Neni 5 § 2 i KEDNJ-së përcakton: "2. Çdo person i arrestuar duhet të informohet brenda një afati sa më të shkurtër dhe në një gjuhë që ai e kupton, për arsyet e arrestimit të tij dhe në lidhje me çdo akuzë që i bëhet."

45 Neni 6 § 3 (a) --- "3. Çdo i akuzuar për një vepër penale ka të drejtat minimale të mëposhtme: a) të informohet brenda një afati sa më të shkurtër, në një gjuhë që ai e kupton dhe në mënyrë të hollësishme, për natyrën dhe për shkakun e akuzës që ngrihet ndaj tij"

46 Direktiva e BE-së Mbi masat mbrojtëse procedurale për fëmijët që janë të dyshuar apo akuzuar në procedura penale - Manual mbi zbatimin, botim i "Fair Trials International", f. 37, § 121, i aksesueshëm në: <https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2021/04/06.-ALB-Children-Directive-Toolkit-1.pdf>, konsultimi i fundit, 6.10.2025.

47 Udhërrëfyes për jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese 1998-2023 lidhur me ankimin kushtetues individual, op. cit., f. 176.

më shpejt që të jetë praktikisht e mundur, sapo të ekzistojnë **dyshime të arsyeshme dhe të mbështetura në prova konkrete** për përfshirjen e tij në një vepër penale. Në këtë moment, organet proceduese janë të detyruara të garantojnë që i mituri **të informohet menjëherë**, në mënyrë të **përshtatur me moshën, nivelin e arsimimit, zhvillimin psikologjik dhe aftësinë e tij për të kuptuar**, për natyrën e akuzave dhe bazën provuese mbi të cilën mbështeten ato.

E drejta për t'u informuar menjëherë është e pandashme nga **garancia e procesit të rregullt ligjor**, si një nga garancitë më substanciale të shtetit të së drejtës. Në rastin e fëmijëve, dimensionin kohor merr peshë të veçantë, pasi proceset e zgjatura ndikojnë **drejtpërdrejt në zhvillimin dhe mirëqenien psikologjike të tyre**.

Në kontekstin shqiptar, kjo konsideratë merr rëndësi të veçantë për shkak të natyrës së moshës penalisht përgjegjëse (14–18 vjeç), e cila përkon me **fazën më dinamike të zhvillimit fizik, emocional dhe arsimor**. Një proces penal i zgjatur – qoftë hetim, gjykim apo apelim – mund të ndikojë në **arsimimin, socializimin dhe formimin moral** të të miturit, duke lënë pasojë të qëndrueshme në jetën e tij. Shpejtësia e procedurës ndikon në **parandalimin e stigmatizimit dhe ruajtjen e aftësive zhvillimore të adoleshentit**.

Si përfundim, informimi i plotë, i saktë dhe me një gjuhë të kuptueshme i të miturit, në prani të mbrojtësit dhe psikologut, për natyrën e veprës penale të atribuuar, provat e mbledhura, burimet e tyre dhe të drejtave procedurale që gëzon, duhet të konsiderohet si kusht themelor për besueshmërinë e procesit dhe për përgatitjen e duhur të një mbrojtjeje efektive, e cila është një nga garancitë themelore për realizimin e së drejtës për një proces të rregull ligjor, të sanksionuar në nenin 42 të Kushtetutës dhe në nenin 6 të KEDNJ-së.

d. E drejta për ndihmë ligjore

E drejta për të pasur një mbrojtës është një e drejtë themelore dhe pjesë shumë e qenësishme e parimit madhor kushtetues të gjykim të drejtë. Vetëm nëpërmjet gëzimit të saj, mund të sigurohet gëzimi i të drejtave të tjera. E drejta e mbrojtjes është veçanërisht e rëndësishme për fëmijët, moshën dhe përvojën e të cilëve mund të përbëjnë pengesa shtesë që vënë në dyshim aftësinë e tyre për të marrë pjesë në mënyrë efektive në procedurat e tyre penale.

Nenet 37 § 5 dhe 40 § 2 të KDF-së u imponojnë shteteve detyrimin që të sigurojnë që **"fëmijët të cilëve u është hequr liria të kenë të drejtën të kenë akses të shpejtë në ndihmë juridike ose çdo ndihmë tjetër të përshtatshme"**, si dhe që fëmijët e dyshuar, të akuzuar ose të dënuar për shkelje të ligjit penal të mund të **"përfitojnë nga ndihma juridike ose çdo ndihmë tjetër e përshtatshme për përgatitjen dhe paraqitjen e mbrojtjes së tyre"**.⁴⁸

Ndërkohë, **neni 15 i Rregullave të Pekinit** e parashikon këtë të drejtë me përmbajtjen vijuese: *"Gjatë gjithë procedurës, i mituri ka të drejtën të përfaqësohet nga mbrojtësi i tij ose të kërkojë caktimin e një avokati kryesisht (ex officio), kur në legjislacionin kombëtar parashikohen dispozita që garantojnë këtë ndihmë."*

Ndërsa, **pika 18, shkronja "a" e Rregullave të Kombeve të Bashkuara për mbrojtjen e të miturve të privuar nga liria**⁴⁹ vendos si detyrim pozitiv për shtetet që: *"Të miturit duhet të kenë të drejtën për shërbimet e një avokati dhe mundësinë për të kërkuar ndihmë juridike kur kjo është e parashikuar, si dhe të komunikojnë rregullisht me mbrojtësin e tyre. Duhet të garantohet karakteri privat dhe konfidencial i këtyre komunikimeve ..."*

Neni 6 i Direktivës (BE) 2016/343 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 9 mars 2016,⁵⁰ sanksion se: *"1. Fëmijët që janë të dyshuar ose persona të ndjekur penalisht në kuadër të procedurave penale gëzojnë të drejtën e*

48 Konventa për të Drejtat e Fëmijëve, neni 37, e aksesueshme në: <https://qbz.gokundwral/preview/0bf6d47f-11a5-47e8-b163-f937cc8a1cc3>, konsultimi i fundit, 21.10.2025.

49 Rregullat e Kombeve të Bashkuara për mbrojtjen e të miturve të privuar nga liria, të miratuara nga Asambleja e Përgjithshme me rezolutën 45/113 të datës 14 dhjetor 1990, pika 18(a).

50 Direktiva (BE) 2016/343 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të datës 9 mars 2016, për forcimin e disa aspekteve të parimit të prezumimit të pafajësisë dhe të drejtës për të qenë i pranishëm në gjykim në kuadër të procedurave penale, neni 6.

aksesit te një avokat, në përputhje me Direktivën 2013/48/BE. Asnjë dispozitë e kësaj direktive, dhe në veçanti e këtij neni, nuk cenon këtë të drejtë (...)."

Pika 120.2 e Rekomandimit CM/Rec (2008) 11 të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës kërkon që: "Autoritetet kompetente duhet të ndihmojnë në mënyrë të arsyeshme të miturin që të ketë akses efektiv dhe konfidencial te këshillimi dhe ndihma juridike, përfshirë takime të pakufizuara dhe të pambikëqyrura me avokatin e tij."

E drejta e të miturit për të pasur ndihmë ligjore, me qëllim sigurimin e mbështetjes emocionale dhe zhvillimore gjatë procesit, është sanksionuar në nenin 31(ç)⁵¹ të Kushtetutës, si parim i përgjithshëm, por pa specifikuar personat e mitur. Në vijim, edhe neni 29, paragrafët 1 e 2 të LDMF-së, i cituar më lart, parashikon që, të miturit, në çdo proces administrativ e gjyqësor, i garantohet ndihmë juridike falas, në përputhje me interesin më të lartë të tyre dhe pa asnjë pengesë. Me konkretisht, në lidhje me gamën që përfshin ndihma juridike që jepet, paragrafi i tretë i nenit 29 parashikon se "përfshin të gjitha veprimet administrative, gjyqësore, si dhe këshillimet që kryen përfaqësuesi, avokati i zgjedhur prej tij ose i caktuar nga autoritetet përgjegjëse sipas legjislacionit në fuqi, gjatë të gjithë procesit administrativ ose gjyqësor."

Sigurimi i ndihmës juridike dhe psikologjike për të miturin në konflikt me ligjin është parashikuar edhe në nenin 35 KPP-së, që përcakton se, atij i sigurohet ndihmë juridike dhe psikologjike, në çdo gjendje dhe shkallë të procedimit, duke i garantuar praninë e prindit apo kujdestarit ligjor, por edhe të personave të tjerë të kërkuar nga i mituri dhe të pranuar nga autoriteti që procedon (§1) Sipas përmbajtjes së paragrafit të dytë të nenit 35, organi procedues mund të kryejë veprime pa qenë të pranishëm i mituri dhe përfaqësuesi i tij ligjor, por gjithmonë në praninë e mbrojtësit dhe vetëm pasi të ketë argumentuar në aktin që dokumenton kryerjen e veprimit që mosprania e tyre është në interes të të miturit apo që vonesa mund të dëmtojë rëndë procedimin.

Gjithsesi, dispozitat ligjore që parashikojnë shprehimisht **mbrojtjen e detyrueshme për të miturin në konflikt me ligjin** janë neni 49(1)-a⁵² i KPP-së dhe neni 19(3)-a⁵³ i KDPM-së. Mbrojtja e detyrueshme e të miturit në konflikt me ligjin është parashikuar si në aktet ndërkombëtare, ashtu edhe në legjislacionet kombëtare të shteteve demokratike, për shkak të cenueshmërisë së veçantë dhe mungesës së pjekurisë juridike e psikologjike të fëmijës, i cili nuk është në gjendje të kuptojë plotësisht natyrën, pasojat dhe të drejtat e veta gjatë një procedure penale. Këto parashikime ligjore synojnë të garantojnë mbrojtje efektive të të drejtave të të miturit, të parandalojnë abuzimin, presionin ose vetëfajësimin, dhe të sigurojnë një trajtim që vë në qendër interesin më të lartë të fëmijës.

Për shkak të zhvillimit të debatit gjyqësor për çështje të ligjit, pjesëmarrja e të pandehurit në gjykimin e çështjes në gjykatat më të larta nuk është paraqitur e domosdoshme, me përjashtim të rasteve kur cilësitë personale të të pandehurit kanë pasur rëndësi vendimtare për dhënien e drejtësisë. Mbi këtë bazë është konsideruar si i mjaftueshëm njoftimi i avokatit për ankimin e ushtruar në shkallët më të larta të gjykimit. Në rast se as avokati dhe as i pandehuri nuk paraqiteshin në seancë gjyqësore, është konsideruar i palejueshme vazhdimi i mëtejshëm i saj.⁵⁴

Sipas GjEDNj-së, paragrafi 3 germa c) e nenit 6 të KEDNj-së, paraqet disa aspekte të veçanta të së drejtës për një proces të rregullt të garantuar në paragrafin e parë.⁵⁵ Ai garanton që procedura e drejtuar kundër një të akuzuari

51 Neni 31 (ç) i Kushtetutës parashikon: "Gjatë procesit penal kushdo ka të drejtë: ... ç) **të mbrohet vetë ose me ndihmën e një mbrojtësi ligjor të zgjedhur prej tij; të komunikojë lirisht dhe privatisht me të, si dhe t'i sigurohet mbrojtja falas, kur nuk ka mjete të mjaftueshme;**"

52 Neni 49 i KPP-së bën këtë përcaktim: "1. **Organi procedues i siguron menjëherë një mbrojtës të paguar nga shteti të pandehurit që nuk ka zgjedhur mbrojtës ose ka mbetur pa të kur: a) është nën moshën tetëmbëdhjetë vjeç.**" i aksesueshëm në: <https://www.qbz.gokundwral/preview/b4819f4d-c246-49b3-87a9-2e6c8512c975>, konsultimi i fundit është bërë më 23.10.2025.

53 Neni 19 § 3 (a) i KDPM-së parashikon: "3. **Në çdo fazë të procedimit penal, i mituri gëzon të drejtat e mëposhtme: a) të drejtën për ndihmë ligjore dhe psikologjike ose çdo ndihmë tjetër të duhur për përgatitjen dhe paraqitjen e mbrojtjes së tij.**"

54 Shih vendimet nr. 5, datë 04.03.2008; nr. 23, datë 13.10.2005, paragrafi 7; nr. 25, datë 30.07.2003, paragrafët 9-11, të GJK-së

55 *Correia de Matos kundër Portugalisë (vendim mbi pranueshmërinë)*, kërkesa nr. 48188/99, GjEDNj, 15 Nëntor 2001; *Foucher kundër Francës*, kërkesa nr. 22209/93, GjEDNj, 18 Mars 1997, § 30.

nuk do të zhvillohet pa qenë ky i fundit i përfaqësuar në mënyrë të përshtatshme për qëllimet e mbrojtjes së tij.⁵⁶ Ai parashtron tri të drejta të ndryshme: atë për t'u mbrojtur vetë, atë për të pasur ndihmën e një mbrojtësi të zgjedhur vetë dhe atë për t'u ndihmuar falas nga një avokat.

E drejta e çdo të akuzuarit për t'u mbrojtur efektivisht nga një avokat është një nga elementet themelore të procesit të rregullt⁵⁷. Në parim, çdo i dyshuar duhet të ketë akses te një avokat sapo të vendoset në ndalim ose në paraburgim⁵⁸. E drejta e të akuzuarit për të marrë pjesë efektivisht në procesin e tij penal përfshin, në përgjithësi, jo vetëm të drejtën për të qenë i pranishëm, por edhe të drejtën për të pasur ndihmën e një avokati në rast nevojë⁵⁹. Po ashtu, vetëm prania e avokatit të të akuzuarit nuk mund ta kompensojë mungesën e këtij të fundit.⁶⁰

Garantimi i mbrojtjes juridike për të miturin është parashikuar edhe në **nenin 6 të Direktivës (BE) 2016/800**, që kërkon që fëmijët të kenë akses në avokat dhe të mos merren në pyetje pa përfaqësim. Kjo dispozitë kërkon që Shtetet Anëtare të sigurojnë që një i dyshuar ose i akuzuar fëmijë të ndihmohet nga një avokat. **Neni i sipërcituar e bën të qartë se një i dyshuar ose i akuzuar fëmijë ka të drejtën për akses në ndihmë juridike që nga momenti më i hershëm i procedurës penale**, pra sapo njoftohen se janë persona të dyshuar ose të akuzuar dhe kurdoherë para se të merren në pyetje nga autoriteti procedues.

GjEDNj, në disa vendime ka pranuar se “edhe pse jo absolute, e drejta e çdo të pandehuri për t'u mbrojtur në mënyrë efektive nga një avokat, nëse është e nevojshme i caktuar edhe nga shteti, përbën një nga elementet themelore të procesit të rregullt ligjor”⁶¹. Prania e avokatit lejon të kompensohet “në mënyrë të përshtatshme” cenueshmëria në të cilën ndodhet i pandehuri gjatë ndalimit në polici, duke siguruar që të respektohet “e drejta e çdo të pandehuri për të mos u vetëfajësuar”.⁶² Në vijim të jurisprudencës së saj GjEDNj-ja ka argumentuar se, çdo kufizim sistematik i ndihmës së një mbrojtësi gjatë ndalimit në polici, i parashikuar nga ligji në fuqi, “mjafton për të konstatuar shkelje të kërkesave të nenit 6 të Konventës, pavarësisht faktit që kërkuesi ka heshtur gjatë ndalimit në polici”.⁶³

Në çështjen **Salduz kundër Turqisë**, që kishte të bënte me një të mitur 17-vjeçar në momentin e arrestimit të tij, **GJEDNJ** thekson se, **aksesi te një avokat duhet të lejohet që në momentin e parë të marrjes në pyetje nga policia**, përveç rasteve kur mund të dëshkohet ekzistenca e “arsyeve të domosdoshme” për ta kufizuar këtë të drejtë. Ajo sqaroi se, kur deklaratat vetinkriminuese, të dhëna gjatë marrjes në pyetje nga policia pa mundësinë e ndihmës së një avokati, përdoren për të bazuar një dënim, atëherë vihet në rrezik “në mënyrë të pariparueshme e drejta e mbrojtjes.” Ky vendim u analizua në dritën e **rrethanave të veçanta të rastit**, pasi përpara se të konkludonte për shkeljen e të drejtave të mbrojtjes, Gjykata vuri në dukje se “një nga elementet karakteristike të çështjes ishte mosha e kërkuesit” dhe theksoi “**rëndësinë themelore për çdo të mitur në ndalim policor të pasjes aksesit te një avokat**”.

Të miturit **nuk kanë aftësinë për të vlerësuar rëndësinë e pranisë së një avokati**. U takon **shteteve** të sigurojnë që kjo e drejtë të garantohet në mënyrë efektive, në mënyrë që i mituri, “duke marrë parasysh cenueshmërinë e tij”, të ketë “vetëdije të plotë për të drejtat e tij”.⁶⁴ Kjo përfshin veçanërisht **të drejtën për të marrë takim me mbrojtësin përpara se të japë deklarime** në organin procedues. Shtetet kanë një detyrim pozitiv për të vepruar në mënyrë “aktive”⁶⁵ që i mituri të kuptojë realisht mundësinë për të kërkuar ndihmën e një mbrojtësi, në mënyrë që të

56 *Pakelli kundër Gjermanisë*, kërkesa nr. 8398/78, Report of the European Commission of Human Rights, 12 Korrik 1982, §§ 31 e 84.

57 *Salduz kundër Turqisë*, kërkesa nr. 36391/02, GjEDNj [DhM], 27 Nëntor 2008, § 51.

58 *Dayanan kundër Turqisë*, kërkesa nr. 7377/03, GjEDNj, 13 Tetor 2009, § 31.

59 *Lagerblom kundër Suedisë*, kërkesa nr. 26891/95, GjEDNj, 14 Janar 2003, § 49 dhe *Galstyan kundër Armenisë*, kërkesa nr. 26986/03, GjEDNj, 15 Nëntor 2007, § 89.

60 *Zana kundër Turqisë [DhM]*, kërkesa nr. 18954/91, GjEDNj, 25 Nëntor 1997, § 72.

61 GjEDNj, *Poitrimol kundër Francës*, 23 nëntor 1993, nr. 14032/88, § 34

62 Po aty, §54.

63 *Dayanan kundër Turqisë*, § 33.

64 *Panovits kundër Qipros*, § 68.

65 Po aty § 72.

jetë në gjendje “të vlerësojë sa më mirë pasojat e veprimeve të tij”.⁶⁶ Një **njoftim i thjeshtë**, në formën e **leximit të tekstit të ligjit të brendshëm** “nuk mund të konsiderohet i mjaftueshëm për t’i bërë të qartë të miturit natyrën e të drejtave të tij”.⁶⁷

Duke marrë parasysh cenueshmërinë e brendshme që buron nga vetë statusi i të miturit, GjEDNj nënvizon rolin e shtuar të avokatit si forcë ekuilibruese, e cila i mundëson të miturit të **shmangë çdo presion të mundshëm nga autoritetet për të pranuar fajin**.⁶⁸ I mituri duhet të jetë në gjendje të ketë “një kuptim të gjerë të natyrës së hetimit, të asaj që është në lojë për të, përfshirë rëndësinë e dënimit që mund të caktohet, si dhe të drejtave të tij të mbrojtjes dhe, në veçanti, të drejtës për të heshtur”.⁶⁹

Megjithatë, nëse avokati ka detyrimin të sigurojë mbrojtjen e klientit të tij, **shteti ka detyrimin të ndërhyjë kur avokati i caktuar kryesisht tregon mangësi të dukshme** në përfaqësim. Në një vendim të datës 20 janar 2009, në çështjen **Güveç kundër Turqisë**,⁷⁰ që kishte të bënte me një **të mitur në konflikt me ligjin 15 vjeçar**, gjyqtarët evropianë theksuan se: “veprimet ose vendimet e mbrojtësit të një të pandehuri nuk mund të ngarkojnë shtetin me përgjegjësi, pasi mënyra e ushtrimit të mbrojtjes i përket në thelb të pandehurit dhe avokatit të tij, qoftë i caktuar në kuadër të ndihmës juridike ose i paguar nga klienti; megjithatë, kur mangësia e avokatit të caktuar kryesisht është e dukshme, neni 6 § 3 (c) i Konventës detyron autoritetet kombëtare të ndërhyjnë.”⁷¹ Para se të vendoste për shkeljen e garancisë së përfaqësimit efektiv në gjykim, GjEDNj-ja mori parasysh, ndër të tjera, “**moshën e re të të interesuarit [...] dhe mangësinë e dukshme të avokates së tij**”, e cila duhej ta kishte shtyrë gjykatën e shkallës së parë të reagoonte përballë “nevojës urgjente për mbrojtës kompetentë”.⁷²

Ndërkohë, **Udhëzimet e Këshillit të Evropës mbi Drejtësinë Miqësore për Fëmijët**, në pikën 2, shkronja “C” - “Drejtësia miqësore gjatë procesit gjyqësor”- kërkon që mbrojtësit që përfaqësojnë fëmijët të trajnohen dhe të kenë njohuri mbi të drejtat e fëmijëve dhe çështjeve që kanë lidhje me ta, të marrin trajnime të thelluara dhe vazhduese dhe të jenë të aftë të komunikojnë me fëmijët në përputhje me nivelin e tyre të të kuptuarit.

5.4 E drejta e të miturit në konflikt me ligjin për t’i kryer vlerësimin individual

Vlerësimi psikologjik dhe individual i të miturit në konflikt me ligjin përbën një nga elementet më të rëndësishëm të drejtësisë penale për të miturit, pasi siguron që çdo reagim shtetëror të jetë i **personalizuar, proporcional dhe rehabilitues** dhe jo ndëshkues. Sipas **nenit 22 të KDPM-së**, gjykata dhe prokuroria janë të detyruar që përpara çdo vendimmarrjeje të marrin në konsideratë **rrethanat individuale** të të miturit në përballje me ligjin, si moshën, nivelin e zhvillimit, kushtet e jetesës, edukimi, gjendja familjare e shëndetësore dhe të kërkojnë ndihmën e **ekspertëve të fushave të ndryshme**, në mënyrë që të kuptojnë **personalitetin, përgjegjshmërinë dhe shkallën e përgjegjësisë penale të tij**. Ky parim përfaqëson konkretizimin në legjislacionin shqiptar të standardeve ndërkombëtare të drejtësisë miqësore për fëmijët.

KDF-ja, në nenin 40, kërkon që çdo fëmijë i dyshuar ose i akuzuar të trajtohet në mënyrë që të **forcojë dinjitetin dhe ndjenjën e vlerës personale**, si dhe të **lehtësojë riintegrimin** e tij në shoqëri. Ky nen lidhet ngushtë me nenin 3 (interesi më i lartë i fëmijës) dhe nenin 12 (e drejta për t’u dëgjuar), të cilët kërkojnë që çdo ndërhyrje procedurale të bazohet në **një vlerësim të kujdesshëm të karakteristikave personale, zhvillimore dhe emocionale të fëmijës**.

Komenti i Përgjithshëm nr. 10 (2007) i Komitetit për të Drejtat e Fëmijës përcakton qartë se “çdo vendim që prek

66 Po aty §§ 68, 71.

67 Po aty § 74.

68 *Adamkieicz kundër Polonisë*, kërkesa nr. 54729/00, GjEDNj, 2 Mars 2010, §§ 86–92; *Blokhin kundër Rusisë*, § 195.

69 *Martin kundër Estonisë*, kërkesa nr. 35985/09, GjEDNj, 30 Maj 2013, § 92.

70 *Güveç kundër Turqisë*, kërkesa nr. 70337/01, GjEDNj, 20 Janar 2009.

71 Po aty § 130.

72 Po aty §§ 131–131

një fëmijë në sistemin e drejtësisë penale duhet të bazohet në një vlerësim të plotë të personalitetit dhe të gjendjes së tij”, përfshirë historinë e familjes, gjendjen shëndetësore, arsimimin dhe ndikimet në komunitet.⁷³ Ky vlerësim, sipas Komitetit, është **parakusht** për të zgjedhur midis **masave alternative ndaj ndëshkimit penal dhe formave të tjera rehabilituese** që i shërbejnë më mirë interesit të fëmijës. Po ashtu, **Komenti i Përgjithshëm nr. 24 (2019)** e përforcon këtë standard, duke kërkuar që vlerësimi të jetë **ndërdisciplinar dhe i hershëm**, për të orientuar procesin në drejtim të shmangies nga ndjekja penale ose të masave më të buta.⁷⁴

Udhëzimet e Këshillit të Evropës për Drejtësinë Miqësore ndaj Fëmijëve i japin një rol qendror vlerësimit individual dhe psikologjik, duke theksuar se *“çdo fëmijë që vjen në kontakt me sistemin e drejtësisë duhet të vlerësohet individualisht nga profesionistë të trajnuar për të identifikuar nevojat, kapacitetet dhe cënueshmëritë e tij.”*⁷⁵ Sipas këtyre udhëzimeve, vlerësimi duhet të ketë për qëllim **jo vetëm analizimin e të kaluarës**, por edhe **parashikimin e mënyrës më të përshtatshme për ta mbështetur fëmijën në të ardhmen**, në mënyrë që ai të mos rikthehet në sjellje të dënueshme.

Në mënyrë të ngjashme, **Rregullat Evropiane për Sanksionet dhe Masat për të Miturit (CM/Rec (2008) 11)** kërkojnë që çdo ndërhyrje penale të paraprihet nga një raport individual, që pasqyron gjendjen psikologjike dhe sociale të të miturit dhe që ndihmon autoritetet të zgjedhin **masat më pak kufizuese të mundshme.**⁷⁶

Direktiva (BE) 2016/800 mbi garancitë procedurale për fëmijët e dyshuar ose të akuzuar në procedime penale përcakton detyrimin për një **vlerësim individual të çdo fëmije**, për të përcaktuar masat që i përshtaten më mirë rrethanave dhe pjekurisë së tij. Sipas nenit 7 të kësaj Direktive, *“vlerësimi individual synon të identifikojë nevojat specifike të fëmijës lidhur me mbrojtjen, arsimin dhe riintegrimin.”*⁷⁷ Kjo nënkupton se procesi nuk duhet të fokusohet vetëm në faktin penal të ndodhur, por edhe në **rrethanat e jetës së të miturit dhe potencialin e tij për zhvillim pozitiv**. Ky standard është përfshirë në mënyrë të drejtpërdrejtë në **nenin 22 të KDPM-së shqiptare**, që kërkon bashkëpunim midis **ekspertëve psikologë, shërbimit të provës dhe njësive të mbrojtjes së fëmijëve (NJMF)**, në përputhje me Ligjin nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”.

Vlerësimi psikologjik, ashtu siç përcaktohet në **nenin 22 të KDPM-së** dhe në standardet ndërkombëtare, ka dy qëllime thelbësore: (a) të sigurojë që vendimmarrja gjyqësore të jetë **në përputhje me pjekurinë dhe aftësinë zhvillimore të fëmijës**, dhe (b) të orientojë sistemin e drejtësisë drejt **masave rehabilituese dhe edukative**, në vend të ndëshkimit penal. Në këtë kuptim, vlerësimi psikologjik i lejon gjykatës të kuptojë se çdo fëmijë është një individ unik, me nevoja dhe potenciale të veçanta.

5.5 E drejta për të pasur të pranishëm prindin apo një person të besuar gjatë kryerjes së veprimeve procedurale

I mituri, në rast se është arrestuar/ndaluar apo ndaj tij ka filluar një procedim penal dhe është e nevojshme kryerja e veprimeve hetimore në lidhje me të, **ka të drejtë që të kërkojë që të asistohet edhe nga përfaqësuesi i tij ligjor** (prindi apo kujdestari) apo nga ndonjë person tjetër i besuar (më poshtë referuar si “përfaqësuesi ligjor”), i zgjedhur prej tij. **Përfaqësuesi ligjor, nëse thirret nga i mituri, duhet të marrë pjesë gjatë kryerjes së veprimeve procedurale, në zbatim të përcaktimeve të nenit 49 § 1 të KDPM-së**, që sanksionon se: **“Çdo veprim procedural i kryer në lidhje me të miturin bëhet në prani të mbrojtësit, përfaqësuesit ligjor dhe psikologut.”** Për pasojë,

73 UN Committee on the Rights of the Child, *General Comment Nr. 10 (2007): Children's rights in juvenile justice*, CRC/C/GC/10, §§ 27–29

74 UN Committee on the Rights of the Child, *General Comment Nr. 24 (2019): Children's rights in the child justice system*, CRC/C/GC/24, §§ 46–47

75 Council of Europe, *Guidelines of the Committee of Ministers on Child-Friendly Justice*, 17 Nëntor 2010, §§ 37–39.

76 Council of Europe, *European Rules for Juvenile Offenders subject to Sanctions or Measures*, Recommendation CM/Rec(2008)11, Rules 15–19.

77 Directive (EU) 2016/800 of the European Parliament and of the Council, 11 Maj 2016, Art. 7.

përpara kryerjes së këtyre veprimeve procedurale me të miturit, organi i ndjekjes penale apo gjykata, duhet të sigurojë detyrimisht praninë e përfaqësuesit ligjor, duke e njoftuar për t'u paraqitur për këtë qëllim, përveç rasteve përjashtimore që parashikon paragrafi i dytë i nenit 49⁷⁸, në lidhje me konfliktin e interesit që mund të jetë krijuar ndërmjet tyre.

Me t'u **kërkuar nga i mituri** për ta shoqëruar atë në çdo veprim hetimor ku atij i kërkohet të paraqitet, **përfaqësuesi ligjor shndërrohet në përfaqësues procedural**, ndaj ai duhet të njoftohet nga organi procedues dhe ka detyrimin të paraqitet, duke i ofruar të miturit ndihmë dhe mbështetje emocionale dhe psikologjike. Për këtë qëllim, neni 53 i KDPM-së, që parashikon mënyrën e njoftimit të të miturit, sanksionon në paragrafin e tretë⁷⁹ se ky i fundit merr dijëni nëpërmjet përfaqësuesit të tij ligjor (kur nuk është i paraburgosur).

Për më tepër, ligjvënësi ka parashikuar se, përfaqësuesi ligjor mund të njoftohet edhe personalisht për aktin hetimor që njoftohet për të marrë pjesë i mituri në konflikt me ligjin, sipas diskrecionit të organit procedues që mund të njoftojë atë apo mbrojtësin e të miturit, sipas përcaktimeve të paragrafit të fundit të nenit 53 që lexon: **"Një kopje e njoftimit të thirrjes së të pandehurit të mitur i dorëzohet ose i dërgohet mbrojtësit të të miturit ose përfaqësuesit të tij ligjor."** Përfaqësuesi ligjor i të miturit ka të drejtë që në mënyrë të pavarur nga i mituri të caktojë mbrojtësit për të, me detyrimin që të garantojë interesin më të lartë për të, sikundër parashikon paragrafi i parë i nenit 48⁸⁰ të KDPM-së.

Ndërkohë, neni 73 i KDPM-së, në paragrafin e parë të tij⁸¹, përcakton të drejtën që ka i mituri i arrestuar për të kërkuar njoftimin e prindit apo në mungesë të tij (mosidentifikim, mosgjetje, mosdiponueshmëri apo papajtueshmëri) një personi tjetër madhor të besuar prej tij. Prania e prindit apo e personit të besuar në këtë fazë të procedimit penal është çmuar e domosdoshme, pasi në momentet e para pas arrestimit i mituri ka nevojë për mbështetje morale dhe emocionale, si dhe orientim për sigurimin e të drejtës së mbrojtjes, nëpërmjet caktimit të një avokati. **Prania e prindit në këtë fazë forcon vetëvlerësimin e të miturit dhe shërben si garanci për respektimin e të drejtave që gëzon ai në këtë gjendje të procedimit.**

Për sa i përket lidhjes që duhet të ketë person i besuar i caktuar nga i mituri KDPM-ja hesht. **Logjika kërkon që njerëz të besuar për të miturin të jenë familjarë të afërt të tij** në lidhje gjinore (gjyshërit e tij, vëllezër apo motra madhorë), si dhe të afërm të tjerë (ungjër apo emta etj.), por jo çdo person që përcakton i mituri. Në këtë rast mund të bëjnë përjashtim persona që provohet të ketë me të miturin në konflikt me ligjin lidhje të qëndrueshme, të njohura dhe të afërta. Natyrisht, edhe personi i besuar, sikundër prindi, nuk duhet të jetë në konflikt interesi me të miturin, pra nuk duhet të ketë lidhje me faktin penal që i atribuohet të miturit, nuk duhet të jetë në situata armiqësie me të apo prania e tij nuk duhet të ndikojë në mbarëvajtjen e hetimit penal ndaj të miturit.

Gjithsesi, zgjedhja e personit të besuar prej të miturit nuk është e detyrueshme për organin që procedon, nëse ai vlerëson se, kjo zgjedhje nuk është në pajtim me interesin më të lartë të të miturit. Në këtë rast, organi procedues nuk e pranon zgjedhjen e personit të besuar dhe vendos vetë t'i caktojë atij një person të besuar, i cili, si rregull, përzgjidhet nga lista e personave të vënë në dispozicion nga Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve pranë bashkisë përkatëse.

Prania e përfaqësuesit ligjor të të miturit, gjithsesi, nuk është e detyrueshme në pyetjen e të miturit në konflikt me ligjin. Kështu, neni 76(5) i KDPM-së parashikon se: *"Pyetja e të miturit bëhet në prani të mbrojtësit dhe*

78 Paragrafi i dytë i nenit 49 të KDPM-së parashikon se: *"Gjyqtari, gjatë gjykimit dhe prokurori në fazën e hetimit, mund të ndalojnë përfaqësuesin ligjor të të miturit në konflikt me ligjin të marrë pjesë në veprimin procedural vetëm nëse një gjë e tillë është në interesin më të lartë të të miturit."*

79 Neni 53(3) i KDPM-së përcakton se: *"Njoftimi i të miturit në konflikt me ligjin bëhet, sipas rastit, nëpërmjet përfaqësuesit të tij ligjor/procedural ose drejtuesit të institucionit ku i mituri është vendosur."*

80 Neni 48(1) i KDPM-së ka këtë përmbajtje: *"1. Përfaqësuesi ligjor i të miturit ka të drejtë të zgjedhë dhe të caktojë, në mënyrë të pavarur, një mbrojtës, duke marrë parasysh interesin më të lartë të të miturit."*

81 Neni 48(1) i KDPM-së ka këtë përmbajtje: *"1. Organi procedues, që në momentin e arrestimit të të miturit, e informon atë lidhur me të drejtën për të njoftuar prindin dhe, në mungesë të tij, një person tjetër të rritur të treguar dhe pranuar prej tij."*

psikologut. **Nëse i mituri jep pëlqimin, gjatë pyetjes së tij mund të marrë pjesë edhe përfaqësuesi ligjor/procedural.**" Në vështrim të kësaj dispozite, por edhe përmbajtjes tërësore të nenit 76, arrihet në përfundimin se, **ndërsa prania e mbrojtësit dhe psikologut është e detyrueshme në çdo veprim procedural** dhe sidomos në atë të pyetjes së të miturit të dyshuar për kryerjen e një veprë penale, **prani e përfaqësuesit ligjor ose atij të besuar, mbetet në diskrecionin e të miturit.**

Shoqërimi i fëmijës nga përfaqësuesi i tij ligjor përgjatë kryerjes së veprimeve procedurale përbën një masë të rëndësishme për sigurimin e drejtësisë së procedurës. Natyrisht që, efektiviteti i këtij shoqërimi varet sesi zbatohen në praktikë. **Komiteti i Ministrave i Këshillit të Evropës, në Rekomandimin nr. R (2003)20 mbi metodat e reja të trajtimit të delikuencës së të miturve dhe rolin e drejtësisë për të miturit, rekomandon që prindërve, "kur rrethanat e lejojnë, t'u ofrohet ndihmë, mbështetje dhe këshillim"**⁸²

Ndërsa, **Rekomandimi i vitit 2008 mbi rregullat evropiane për delinkuentët e mitur që i nënshtrohen sanksioneve ose masave** është më i qartë, pasi thekson se:

"Për të përmbushur nevojat specifike të të miturve, e drejta e brendshme duhet të përcaktojë:

- a) *detyrimin e autoritetit kompetent për t'u shpjeguar delinkuentëve të mitur dhe, nëse është e nevojshme, prindërve ose kujdestarëve të tyre ligjorë, përmbajtjen dhe qëllimet e dispozitave ligjore që rregullojnë sanksionet ose masat e zbatuara në komunitet;*
- b) *detyrimin për çdo autoritet kompetent që të kërkojë bashkëpunimin më të mirë të mundshëm me delinkuentët e mitur dhe prindërit ose kujdestarët e tyre ligjorë.*"⁸³

Aktualisht, **ky shoqërim shpesh reduktohet në një prani formale, pa ndonjë ndihmë apo mbështetje të qartë – gjë që ngre dyshime mbi efektivitetin e tij real.** Duhet kujtuar se prindërit mbeten edukatorët e parë dhe bartësit kryesorë të përgjegjësisë për fëmijët e tyre. Nisur nga kjo cilësi e tyre, prindërit duhet të mbështeten në pikat e tyre të forta, e jo të gjykohen vetëm nga dobësitë e tyre, ndërkohë që shtetet kanë detyrimin të ofrojnë "ndihmën e përshtatshme për prindërit dhe përfaqësuesit ligjorë të fëmijës në ushtrimin e përgjegjësisë së tyre prindërore"⁸⁴.

Këtu duhet theksuar se, **prania e thjeshtë fizike e prindërve gjatë procedurës nuk mund të konsiderohet garanci për respektimin e parimit të barazisë së armëve.** Për t'u respektuar plotësisht ky parim duhet që **prindërit të jenë në gjendje të kuptojnë natyrën dhe qëllimin e procedurës,** në mënyrë që të jenë realisht të aftë ta shoqërojnë fëmijën e tyre. Gjithsesi, **pjesëmarrja e prindërve nuk duhet të bëhet shkak i fshehtë për cenimin e interesave dhe të drejtave të të miturit.** Për pasojë, një qasje bashkëpunuese me prindërit është mënyra e vetme për t'u përballur me vështirësitë e tyre dhe për të bërë që prindi të shndërrohet në garant të të drejtave të fëmijës së vet.

Një pengesë për pjesëmarrje efektive të prindërve në procedurën penale ndaj fëmijëve të tyre është ndjenja e stigmatizimit që ata përjetojnë për veprën penale të kryer nga fëmija, duke bërë që në shumë raste të mos iu ofrojnë mbështetje të vërtetë atyre. Duhet pasur parasysh se shumica e prindërve e përjetojnë përfshirjen në kriminalitet të fëmijës së tyre si një dështim personal. Një studim i kryer në Kanada ka mbledhur përjetimet emocionale të prindërve që mungonin në sallën e gjyqit. Prindërit pjesëmarrës në këtë studim kanë deklaruar se "**ndihen të vëzhguar, të gjykuar dhe të poshtëruar kur thirren publikisht në gjykatë dhe kur përmenden gjatë shqyrtimit të çështjes** [...] Të painformuar mbi rrjedhën e procedurës, ata ndihen të pafuqishëm në një mjedis që e perceptojnë si armiqësor."⁸⁵

82 Recommendation Nr. R (2003)20 concerning new ways of dealing with juvenile delinquency and the role of juvenile justice, Committee of Ministers, Council of Europe, 24 September 2003.

83 Recommendation CM/Rec(2008)11 of the Committee of Ministers to member states on the European Rules for juvenile offenders subject to sanctions or measures, 5 Nëntor 2008.

84 KDF, nenet 5 dhe 18.

85 J. Trépanier, Les transformations du régime canadien relatif aux mineurs délinquants : un regard sur le droit et les pratiques, RSC, vol. 4, nr. 4, 2012, f. 850, i disponueshëm në faqen e internetit: <https://droit.cairn.info/revue-de-science-criminelle-et-de-droit-penal-compare-2012-4-page-819?lang=fr>.

Megjithatë, edhe pse gjendja e cenueshmërisë së të miturit autor të një veprë penale justifikon praninë e përfaqësuesve ligjorë dhe veçanërisht të prindërve, ekzistojnë edhe situata në të cilat prania e tyre mbetet e pamundur ose e komprometuar. Në rastet kur ka një konflikt interesi ndërmjet prindërve dhe fëmijëve, organi procedues duhet të caktojë një përfaqësues procedural nga Njësia e Mbrojtjes së Fëmijës e njësishë administrative vendore në juridiksionin e së cilës vepron organi procedues (neni 74 i KDPM-së).

5.6 E drejta për të mos dëshmuar ose pranuar fajësinë

Prezumimi i pafajësisë përfshin të drejtën për të mos kontribuar në inkriminimin e vetvetes nga ana e personit të akuzuar, e cila nga ana e saj përfshin të drejtën për të mos folur përpara autoritetit procedues (e drejta për të ruajtur heshtjen e tij) dhe të drejtën për të mos u detyruar nga organet e ndjekjes penale për të prodhuar prova që do të ndikonin në pozitën e tij. E thënë ndryshe, bëhet fjalë për të zbatuar parimin e lashtë romak "*Nemo tenetur prodere seipsum*" (askush nuk mund të detyrohet të akuzojë vetveten). I akuzuari mund të refuzojë t'u përgjigjet pyetjeve, duke mos dhënë "kontributin" e tij në krijimin e elementëve provues, detyrë që i mbetet organit të prokurorisë.

GjEDNj-ja⁸⁶ ka theksuar se, edhe pse nuk është përmendur në mënyrë të shprehur në Konventë, e drejta për të mos u vetinkriminuar është një normë ndërkombëtare përgjithësisht e njohur dhe është pjesë integrale e konceptit të "procesit të drejtë". Ky parim mbron të pandehurin kundër shtrëngimit të padrejtë të autoriteteve shtetërore, duke reduktuar në këtë mënyrë gabimet gjyqësore dhe duke lejuar të zbatohet parimi i barazisë së armëve.

E drejta e të miturit për të mos dhënë dëshmi vetëfajësuese nënkupton "**të drejtën e tij të heshtë**", të mos i përgjigjet pyetjeve të caktuara ose të gjitha pyetjeve⁸⁷. Çdo lloj forme/mekanizmi/mënyre imponimi fizik apo psikologjik është e papranueshme për të marrë deklaratime nga i mituri në konflikt me ligjin, sepse, *së pari*, çdo veprim i tillë konsiderohet se bie në fushën e zbatimit të nenit 3 të KEDNj-së, si trajtim çnjerëzor apo degradues për të marrë një pohim fajësie ose rrëfim, duke përbërë kështu një shkelje të rëndë të të drejtave të fëmijëve dhe, *së dyti*, një pohim apo rrëfim i tillë nuk mund të pranohet si provë⁸⁸. Mosha e të miturit, zhvillimi i tij, kohëzgjatja e intervistimit, të moskuptuarit e situatës ku ndodhet, gjendja emocionale e krijuar nga procesi, frika nga pasojat e panjohura ose nga burgimi janë faktorë që mund ta shtyjnë atë të një pohim, i cili nuk është i vërtetë.⁸⁹

Sikundër e pohuam edhe më lart, **akuza duhet të kërkojë t'i bazojë argumentet e saj, pa iu drejtuar provave të marra nëpërmjet shtrëngimit apo presionit**. Në këtë kuptim, paragrafi i parë i nenit 92 të KDPM-së pengon organet e procedimit penal që i mituri "*të detyrohet të bëjë deklaratime që tregojnë vetëpërgjegjësi penale*". Sikundër është shprehur edhe **GjEDNj-ja, siguria dhe rendi publik nuk mund të shërbejnë si justifikime për të shkelur këto të drejta**. Bëhet fjalë për të drejta që janë të lidhura ngushtësisht me njëra-tjetrën, ndaj çdo shtrëngim i ushtruar me qëllim marrjen e provave nga i pandehuri që e implikonjë atë në kryerjen e një veprë penale përbën shkelje të së drejtës për të qëndruar në heshtje - për të mos folur. P.sh. shteti dhunon të drejtën e të pandehurit për të mos folur nëse ai përpiqet ta shtrëngojë atë që të japë deklaratime në lidhje me të dhënat bankare të tij hetuesve të shërbimeve doganore.⁹⁰

Të detyrosh një të akuzuar që ta bashkëpunojë me autoritet e ndjekjes penale gjatë fazës së hetimeve paraprake, mund të shkelë të drejtën e tij për të mos dhënë deklaratime apo për të mos paraqitur prova vetëfajësuese dhe të

86 *Heaney and McGuinness kundër Irlandës*, kërkesa nr. 34720/97, GjEDNj, datë 21.12.2000.

87 Shih nenin 37 të Kodit të Procedurës Penale. Vërejmë se deklaratimet e dhëna jo në cilësinë e personit nën hetim/i pandehur që tregojnë vetpërgjegjësi nuk mund të përdoren si provë.

88 Konventa kundër torturës dhe trajtimeve a dënimeve të tjera mizore, çnjerëzore ose poshtëruese, miratuar nga Asambleja e Përgjithshme me Rezolutën e saj 39/46 të datës 10 dhjetor 1984, në nenin 15 të saj parashikon se: "*Çdo shtet palë siguron për çdo deklaratë e cila është provuar të jetë marrë nëpërmjet torturës, të mos përdoret si element prove në një proces, përveç rastit kur ky fakt përdoret kundër personit të akuzuar për torturë për të provuar se është dhënë deklarata.*"

89 Merkaç, Tereza, *Komentari i Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur i interpretuar me praktikë gjyqësore*, op. cit. f. 451.

90 *Funke kundër Francës*, kërkesa nr. 10828/84, GjEDNj, 25.02.1993, në përmbledhjen A 256-A.

komprometojë paanësinë e gjithë procesit gjyqësor që do të zhvillohet më pas, d.m.th. të drejtën për një proces të drejtë gjyqësor.

Ndalimi i parashikuar nga neni 38 § 2 i KPP-së që ndaj personit të marrë në pyetje nuk mund të përdoren metoda ose teknika për të ndikuar mbi vullnetin e lirë të tij mund të lexohet vetëm në kuptimin më të gjerë të mundshëm, duke ndaluar çdo sjellje nga ana e organeve të zbatimit të ligjit që mund të lërë shteg për dyshime se vullneti i personit të marrë në pyetje është dhunuar.

Neni 25 i Kushtetutës sonë ndalon çdo lloj forme torture ose trajtimi çnjerëzor, kurse neni 32 i saj parashikon dy ndalime: *së pari*, që askush nuk mund të detyrohet të dëshmojë kundër vetvetes dhe as të pohojë fajësinë dhe, *së dyti*, që askush nuk mund të deklarohet fajtor mbi bazën e të dhënave të mbledhura në mënyrë të paligjshme. Çdo i pandehur ka absolutisht të drejtë që të mos japë asnjë lloj kontributi gjatë hetimit gjyqësor ose gjatë procesit dhe kjo është një e drejtë e pamohueshme.⁹¹

5.6.1 E drejta e të miturit në konflikt me ligjin për të heshtur

E drejta e të miturit për të mos dhënë shpjegime gjatë marrjes në pyetje shtrihet që në fazën e hetimit paraprak të procedimit penal nga policia gjyqësore dhe deri në zhvillimin e gjykimit të çështjes. **I mituri duhet të ketë të drejtën të mos japë shpjegime, në mënyrë që ai të mos zbulojë përpara se të fillojë procesi gjyqësor strategjinë e tij të mbrojtjes në gjykim.**

Në mënyrë që kjo e drejtë të garantohet efektivisht, duhet që i dyshuari të informohet (vihet në dijeni) nga personi që e merr në pyetje për të drejtën që ka, sikundër është parashikuar në Kodin e Procedurës Penale (neni 255 § 3). Në këtë aspekt, legjislatori shqiptar, duke reflektuar përvojën ligjore të shumicës së vendeve evropiane, është treguar mjaft i kujdesshëm që *një të drejtë të tillë ta parashikojë në mënyrë eksplicite në ligj*, bashkë me paralajmërimin se nëse nuk dëshiron të përfitojë nga një e drejtë e tillë, çdo gjë që ai do të thotë, mund të përdoren ndaj tij në gjykim.⁹²

Ndërkohë, paragrafi i dytë i nenit 92 të KDPM-së⁹³, parashikon një ndalim shumë të rëndësishëm – **nga heshtja e të miturit në konflikt me ligjin nuk mund të nxirren konkluzione fajësie**. Në kontekstin e fëmijëve dhe të miturve në konflikt me ligjin, e drejta për të heshtur merr një dimension edhe më të thellë mbrojtës, pasi presioni psikologjik mbi fëmijën gjatë procedurës penale mund ta bëjë çdo ‘heshtje’ një reagim mbrojtës e jo një akt vullnetar.

Vëmë në dukje se, nga heshtja e një të pandehuri të rritur, në raste përjashtimore dhe kur ekzistojnë kushtet e nevojshme, mund të nxirren konkluzione fajësie. *Vetëm atëherë kur provat e paraqitura nga organi i akuzës “kërkojnë” një shpjegim nga ana e të pandehurit, në eventualitetin e refuzimit të tij për të dhënë shpjegime, mund të nxirren përfundime të arsyeshme, që nuk ekziston asnjë shpjegim i mundshëm për të kundërtën dhe, për pasojë, i pandehuri është fajtor*. Në të kundërt, nëse argumentet e paraqitura nga organi i akuzës kanë një fuqi provuese aq të dobët, saqë nuk mund t’i rezistojnë kundërshtimeve të palës tjetër, përfitimi nga e drejta për të heshtur nga ana e të pandehurit nuk mund të çojë në përfundimin se ky person është fajtor. *GJEDNJ ka saktësuar se përfundimet e arsyeshme të nxjerra nga sjellja e të pandehurit nuk duhet të kenë efekt në zhvendosjen e barrës së provës nga akuza tek mbrojtja, duke dhunuar në këtë mënyrë parimin e prezumimit të pafajësisë.*

Vendimi themelor mbi këtë çështje është **John Murray kundër Mbretërisë së Bashkuar**⁹⁴, ku Gjykata pranoi se nxjerrja e **përfundimeve të arsyeshme nga heshtja e të pandehurit** nuk është në vetvete shkelje e nenit 6 të

91 Vendimi nr. 14, datë 03.05.2011, i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.

92 Neni 255 § 1 i KPP parashikon si një nga detyrat me të rëndësishme të oficerëve apo agjentëve të policisë gjyqësore kur kryejnë një arrestim apo ndalim, atë të vënies menjëherë në dijeni të personit që i kufizohet liria që *“nuk ka asnjë detyrim të bëjë deklaratë”*.

93 Kjo dispozitë përcakton: *“Heshtja e të miturit gjatë procedurës së hetimit dhe gjykimit nuk mund të konsiderohet si pranim i fajësisë.”*

94 *John Murray kundër Mbretërisë së Bashkuar*, kërkesa nr. 18731/91, GjEDNJ, 8 Shkurt 1996.

KEDNJ-së, me kusht që provat e paraqitura nga akuza të jenë **të mjaftueshme për të kërkuar një shpjegim** dhe që heshtja të mos jetë **burimi i vetëm i dënimit**. GjEDNJ-ja theksoi se përfundime të tilla janë të lejueshme vetëm kur të gjitha rrethanat e çështjes i justifikojnë, dhe se në çdo rast barrën e provës e mban ekskluzivisht organi i ndjekjes penale. Ky standard u zhvillua më tej në çështjen **Condron kundër Mbretërisë së Bashkuar**⁹⁵, ku Gjykata sqaroi se përdorimi i heshtjes kundër të pandehurit kërkon një **analizë individuale të motiveve** të saj. Nëse heshtja buron nga këshilla e avokatit ose nga rrethana personale që e pengon të pandehurin të flasë (p.sh. stres, gjendje shëndetësore, mosbesim ndaj sistemit), ajo nuk mund të interpretohet si provë faji.

Në rastin **Averill kundër Mbretërisë së Bashkuar**⁹⁶, Gjykata përforcoi më tej këtë parim duke deklaruar se kur provat e akuzës janë të dobëta ose të paqarta, çdo përfundim i nxjerrë nga heshtja **rrezikon të zhvendosë barrën e provës nga akuza tek mbrojtja**, duke cenuar parimin e prezumimit të pafajësisë. Në të njëjtën linjë, në çështjen **Heaney and McGuinness kundër Irlandës**⁹⁷, Gjykata theksoi se e drejta për të heshtur dhe për të mos u vetëfajësuar është “një nga standardet më të njohura ndërkombëtarisht të procesit të drejtë” dhe se çdo ndëshkim për heshtjen – qoftë i drejtpërdrejtë, qoftë përmes konkluzioneve të nxjerra prej saj – **përbën shkelje të nenit 6 § 2 të Konventës**. Po kështu, në **Funke kundër Francës**, Gjykata vlerësoi se, detyrimi për të dorëzuar dokumente që mund të përdoren për të provuar fajësinë e vet bie ndesh me të drejtën për të mos u vetinkriminuar, duke e konsideruar këtë si “themel të procesit të drejtë dhe të shtetit të së drejtës”.

Nga kjo linjë jurisprudenciale del qartë se **heshtja e të pandehurit nuk është provë në vetvete**, por një element që mund të merret në konsideratë **vetëm nëse plotësohen disa kushte të rrepta**:

- (i) provat e akuzës duhet të jenë të mjaftueshme për të kërkuar një shpjegim logjik nga i pandehuri;
- (ii) gjykata duhet të verifikojë nëse heshtja nuk është pasojë e ndonjë presioni ose rrethane të jashtme; dhe
- (iii) çdo përfundim i nxjerrë nga heshtja **nuk mund të jetë baza e vetme e dënimit**. Në të kundërt, përdorimi i heshtjes si provë fajësie ose për të kompensuar mungesën e provave reale **do të përbënte një zhvendosje të padrejtë të barrës së provës**, duke shkelur parimin e prezumimit të pafajësisë dhe vetë thelbin e procesit të drejtë.

Në mënyrë që e drejta për të heshtur të jetë efektive, ajo nuk duhet interpretuar në dëm të të miturit. **Përfshirja e saj si ndalim në KDPM përbën një mburojë ndaj çdo forme presioni të ushtruar për të nxjerrë me forcë pranimin e fajësisë**. Për më tepër, mosrespektimi i detyrimit për ta njoftuar të miturin mbi të drejtën për të heshtur, edhe kur pyetja është bërë në prani të mbrojtësit, nuk mundet në asnjë rrethanë ta bëjë të vlefshëm aktin procedural të dokumentimit të këtij veprimi.

5.6.2 Pranimi i fajësisë nga i mituri

Në lidhje me pranimin e fajësisë nga i mituri në konflikt me ligjin, paragrafi i tretë i nenit 92 të KDPM-së bën këtë përcaktim: “3. **Në rast se i mituri pranon fajësinë, gjykata, në çdo rast, duhet të sigurohet që kjo nuk ndodh për shkaqë që lidhen me moshën, zhvillimin dhe aftësinë e të miturit për të perceptuar dhe kuptuar frikën e një dënimi të mundshëm ose frikën prej tejzgjatjes së kohës së marrjes në pyetje.**”

Me fjalë të tjera, një pranim fajësie ka vlerë vetëm nëse është rezultat i **vullnetit të lirë dhe të informuar të të miturit**, ndërsa çdo element që mund të ndikojë në autonominë e tij duhet të çojë në pavlefshmëri të aktit procedural dhe në papërdorshmëri të provës së marrë. Nuk duhet të harrohet se, **procesi penal, për fëmijët, është shpesh një përvojë traumatike, ku pohimi i fajësisë nuk është shprehje e një vullneti të lirë dhe e një ndërgjegjeje të patrazuar, por një reagim ndaj frikës dhe dëshirës për t’i dhënë fund sa më shpejt të jetë e mundur të përballjes me drejtësinë penale**. Presioni që rrjedh nga qëndrimi i zgjatur në paraburgim apo nga ndikimi psikologjik i hetimit mund ta çojë të miturin në një pohim fajësie që nuk pasqyron realitetin objektiv, duke cenuar drejtësinë e procesit.

95 *Condron kundër Mbretërisë së Bashkuar*, kërkesa nr. 35718/97, GjEDNJ, 2 Maj 2000.

96 *Averill kundër Mbretërisë së Bashkuar*, kërkesa nr. 36408/97, GjEDNJ, 6 Qershor 2000.

97 *Heaney and McGuinness kundër Irlandës*, kërkesa nr. 34720/97, GjEDNJ, 21 Dhjetor 2000.

E drejta e të miturit për të pohuar ose për të mos pohuar fajësinë në mënyrë të lirë dhe të ndërgjegjshme përbën një nga garantitë më të rëndësishme të procesit të drejtë dhe një konkretizim të parimit të **mosinkriminimit** të sanksionuar në nenin 32 §1⁹⁸ të Kushtetutës, nenin 6 të KEDNj-së dhe nenin 40 të KDF-së.

Standardi kushtetues në lidhje me procesin e rregullt ligjor gjatë hetimit dhe gjykimit penal kërkon që organi procedues të provojë përtej çdo dyshimi të arsyeshëm se i pandehuri e ka kryer veprën penale që i atribuohet. Çdo i pandehur ka absolutisht të drejtë të mos japë asnjë lloj kontributi gjatë hetimit gjyqësor ose gjatë procesit dhe kjo është një e drejtë e pamohueshme (*Vendimi nr. 14, datë 03.05.2011, paragrafi III.12, i GJK-së*).⁹⁹

Mënyra e marrjes së provave ka rëndësi thelbësore për zhvillimin e drejtë të procesit penal. **Sigurimi i paligjshëm i provës dhe pranimit i saj nga trupi gjyqësor nuk mund të mos nënkuptojnë që procesi ishte i parregullt.** Asnjë gjykatë nuk ka mundësi, pa dëmtuar dhënien e "përmasës së duhur të drejtësisë", të mbështetet në prova që janë marrë jo vetëm me metoda të pandershme, por, mbi të gjitha, që janë edhe të kundërligjshme. Në bazë të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, gjykatat e kanë për detyrë të vlerësojnë në tërësi nëse procedurat lidhur me mënyrën se si janë siguruar provat kanë qenë të drejta. (*Vendimet nr. 67, datë 10.11.2017, paragrafi 13; nr. 7, datë 27.04.2005, paragrafi 5; nr. 95, datë 27.07.2001, paragrafi 4, të GJK-së*)¹⁰⁰

Neni 92 § 3 i KDPM-së përcakton se, në rastet **kur i mituri pranon fajësinë, gjykata duhet të sigurohet se kjo ndodh vërtet në mënyrë të lirë dhe të vetëdijshme, duke përjashtuar çdo ndikim që lidhet me moshën, zhvillimin apo frikën nga dënimi ose nga zgjatja e procedurës.** Kjo dispozitë përfaqëson një detyrim pozitiv për organet gjyqësore që të verifikojnë **vullnetin real të të miturit** përpara se të pranojnë pohimin e tij si provë. Kjo e drejtë lidhet me parimin e **"barazisë së armëve"**, pasi çdo presion i heshtur i autoriteteve mbi të miturit për të bashkëpunuar, përmes premtimeve ose sugjerimeve të dënimit më të lehtë, përbën shkelje të nenit 42§ 2¹⁰¹ të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNj-së.

Në të drejtën ndërkombëtare, ky standard mbështetet drejtpërdrejt në nenin 40 § 2 (b) (iv) të KDF-së, i cili ndalon që një fëmijë **"të detyrohet të dëshmojë ose të pranojë fajësinë."** Komiteti për të Drejtat e Fëmijës, në **Komentin e Përgjithshëm nr. 10 (2007)**, thekson se çdo deklarament fajësie i një fëmije duhet të bëhet vetëm pasi ai të ketë marrë **ndihmë ligjore dhe psikologjike adekuate**, dhe pasi të ketë kuptuar plotësisht pasojat juridike dhe morale të deklaramentit.¹⁰² Kjo kërkesë lidhet me funksionin rehabilitues të drejtësisë penale për të miturit, duke e mbrojtur fëmijën nga vetë-stigmatizimi dhe nga pasojat afatgjata në jetën e tij shoqërore të një pranimi të pavetëdijshëm.

Udhëzimet e Këshillit të Evropës për drejtësinë miqësore ndaj fëmijëve kërkojnë që, gjatë marrjes në pyetje të fëmijëve, pyetjet dhe procedurat të përshtaten me nivelin e tyre të zhvillimit dhe të jenë miqësore ndaj fëmijës. **Shtetet anëtare duhet të hartojnë dhe zbatojnë protokolle standarde të intervistimit, që marrin parasysh moshën dhe pjekurinë e fëmijës, për të garantuar vlefshmërinë dhe besueshmërinë e dëshmisë.** Gjykata mund të pranojë që fëmija të mos dëshmojë, nëse kjo është në përputhje me interesin më të lartë dhe mirëqenien e tij.¹⁰³

Në jurisprudencën e **GjEDNj-së**, vlefshmëria e deklaramenteve të fajësisë është trajtuar në mënyrë të qëndrueshme si pjesë e **të drejtës për proces të drejtë**. Në *çështjen Saunders kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Gjykata sqaroi

98 Neni 32 § 1 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë sanksionon: "1. *Askush nuk mund të detyrohet të dëshmojë kundër vetvetes ose familjes së vet dhe as të pohojë fajësinë e tij.*"

99 *Udhërrëfyes për jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese 1998-2023 lidhur me ankimin kushtetues individual*, op. cit., f. 269.

100 *Udhërrëfyes për jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese 1998-2023 lidhur me ankimin kushtetues individual*, op. cit., f. 270.

101 Kushtetuta, në nenin 42 § 2 të saj parashikon: "2. *Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj*"

102 Committee on the Rights of the Child, *General Comment Nr. 10 (2007): Children's rights in juvenile justice*, UN Doc. CRC/C/GC/10, §§ 56–58.

103 Council of Europe, *Guidelines of the Committee of Ministers of the Council of Europe on Child-Friendly Justice*, CM/Del/Dec(2010)1098/10.2, adopted on 17 Nëntor 2010, §§ 65–68, i disponueshëm në: <https://rm.coe.int/16804b2cf3>

se e drejta për të mos u vetë-inkriminuar “përfshin lirinë për të mos dhënë deklaratë që burojnë nga ndërgjegjja e të pandehurit dhe që mund të përdoren për ta dëmtuar atë.”¹⁰⁴ Çdo pranim faji që rrjedh nga presioni psikologjik, frika nga dënimi ose kërcënimi me pasoja më të rënda bie ndesh me nenin 6 të KEDNj-së.

Në mënyrë të veçantë, në çështjen **S.C. kundër Mbretërisë së Bashkuar**, të cituar edhe më herët, Gjykata vlerësoi se për të miturit, çdo pranim fajësie duhet të analizohet duke marrë parasysh **aftësinë për të kuptuar natyrën e procesit dhe pasojat e deklaramit**.¹⁰⁵ Nëse deklarimi është rezultat i frikës, presionit ose dëshirës për t’i dhënë fund procedurës, ai **nuk mund të konsiderohet pranim i vlefshëm** në kuptimin e nenit 6 të Konventës. Gjykata nënvizoi detyrimin e shtetit që të sigurojë ndihmë ligjore efektive dhe kushte komunikimi të përshtatshme me moshën e të miturit, në mënyrë që pohimi i fajësisë të jetë një akt i ndërgjegjshëm dhe jo produkt i manipulimit apo i stresit procedural.

104 *Saunders kundër Mbretërisë së Bashkuar*, §§ 68–74.

105 *S.C. kundër Mbretërisë së Bashkuar*, §§ 27–29

6. GJETJET E STUDIMIT DHE ANALIZA E TYRE

Sikundër e pohuam edhe në pjesën hyrëse të këtij studimi, në funksion të këtij të fundit janë marrë në analizë fashikuj nga procedime penale nga gjashtë Prokurori pranë Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, respektivisht e Tiranës, Durrësit, Elbasanit, Fierit, Vlorës dhe Shkodrës, si dhe janë intervistuar dhjetë të mitur të paraburgosur, që ishin në proces hetimi apo gjykimi. Nga qëmtimi i tyre i fashikujve dhe analiza e intervistave më të miturit janë evidentuar një sërë gjetjesh që, në vlerësimin tonë, duhen shmangur, siç do të rekomandohet në fund të studimit.

Më poshtë po rendisim **disa nga gjetjet kryesore të vërejtura:**

1. Vonesa në regjistrimin e procedimit pas referimit të faktit penal dhe mosshënimi i emrit të të miturit në konflikt me ligjin në Regjistrin e Njoftimit të Veprave Penale njëkohësisht me veprën penale që dyshohet të jetë kryer.
2. Kufizimi i lirisë së të miturit në konflikt me ligjin nga Policia Gjyqësore nëpërmjet aktit të “kapjes në flagrancë” dhe mungesa e leftësimit të tij nga Prokurori dhe/ose gjykata.
3. Mosdhënia e letrës së të drejtave apo mungesa e nënshkrimit të letrës së të drejtave nga përfaqësuesi ligjor, avokati dhe psikologu, si dhe mosplotësimi i datës dhe/apo orës në letrën e të drejtave.
4. Mosdokumentimi nga Policia Gjyqësore i veprimeve që parashikon nenin 48 § 3 i KDPM-së në lidhje me sigurimin e pranisë së mbrojtësit.
5. Marrja në pyetje e të miturve në konflikt me ligjin nga oficerët e Policisë Gjyqësore pa praninë e mbrojtësit apo me “argumentimin” se i mituri nuk kërkon mbrojtës në këtë fazë, si dhe mosdokumentimi i pranisë së mbrojtësit në aktin përkatës ku merr pjesë.
6. Marrja në pyetje e të miturit në konflikt me ligjin, të arrestuar në flagrancë apo të ndaluar, nga oficeri i Policisë Gjyqësore në shkelje të normave të Kodit të Procedurës Penale që një veprim të tillë ia ngarkon ekskluzivisht prokurorit.
7. Lejimi i deklarimeve të të miturve që tregojnë vetëpërgjegjësi dhe moskryerja e veprimeve të detyrueshme në dispozitat e KPP-së për deklarinimin si të papërdorshme të tyre.
8. Mospjesëmarrja apo mosdokumentimi në procesverbalin përkatës të pranisë së prindit apo psikologut gjatë kryerjes së veprimeve procedurale me të miturin në konflikt me ligji.
9. Mospërfundimi i hetimeve paraprake brenda një afati të arsyeshëm, pa shkaqe objektive që mund të justifikonin vonesën.
10. Mungesa e hartimit të raportit të vlerësimit individual për të miturin në konflikt me ligjin

Për qëllime të këtij punimi jemi përqendruar vetëm te gjetjet më të qenësishme, që janë evidentuar në së paku 25% të numrit të procedimeve penale të konsultuara apo në pretendimet kryesore të ngritura nga të miturit. Ndonjë nga gjetjet që nuk përmbush kriterin e mësipërm është vlerësuar të vihet në dukje për shkak të rëndësisë themelore të shkeljes që ne kemi gjykuar se është kryer, me dëshirën e mirë që pasqyrimi i saj të mund të parandalohet që të kryhet në të ardhmen. Në vijim po bëjmë analizën e gjetjeve të vërejtura, duke cituar procedimet ku janë konstatuar apo të miturit e paraburgosur që i kanë pretenduar.

6.1 Vonesa në regjistrimin e procedimit pas referimit të faktit penal dhe mosshënimi i emrit të të miturit në konflikt me ligjin në Regjistrin e Njoftimit të Veprave Penale njëkohësisht me veprën penale që dyshohet të jetë kryer

Prokuroria kompetente në lëndë dhe territor, kur merr njoftim për kryerjen e një veprë penale dhe për autorin e dyshuar apo kur vepra dhe autori i rezultojnë asaj gjatë hetimeve që zhvillon vetë, është e detyruar t'i regjistrojë këto fakte në regjistrin përkatës. Ky detyrim rezulton qartazi nga përmbajtja e nenit 287 § 1 të KPP-së, sipas të cilit: **“Prokurori shënon në regjistër çdo njoftim të veprës penale që i vjen ose që ka marrë me iniciativën e vet dhe në të njëjtën kohë ose nga momenti në të cilin rezulton, emrin e personit të cilit i atribuohet vepra penale.”**

Natyrisht që, **jo në çdo rast njoftimet që merr Prokuroria nga burime të ndryshme për fakte penale të kryera dhe persona të dyshuar si autorë “meritojnë” të hetohen prej saj.** Mund të ndodhë që fakti i referuar dukshëm (*prima facie*) nuk ekziston apo nuk parashikohet nga ligji si vepër penale (nenet 2 dhe 3 § 1 të Kodit Penal). Më tej mund të ndodhë që, personi të cilit i atribuohet kryeja e veprës penale të ketë vdekur (neni 47 § 1 i Kodit Penal), të mos ketë mbushur moshën për lindjen e përgjegjesisë penale (neni 12 i Kodit Penal) apo të ketë qenë i papërgjegjshëm përpara ligjit penal në kohën e kryerjes së faktit penal (neni 17 i KPP-së). Po kështu, mund të ndodhë që vepra penale të jetë shuar, për shkak të parashkrimit të veprës penale (neni 66 i Kodit Penal) apo për këtë vepër penale të jetë dhënë amnisti nga Kuvendi i Shqipërisë (neni 82 § 2 (ë) i Kushtetutës). Së fundi, në veprat penale që ndiqen me ankimin e viktimës mundet që ajo të mos bëjë ankim (neni 284 i KPP-së) apo të heqë dorë prej tij (neni 285 i KPP-së).

Në të gjitha rastet e mësipërme që, ligji procedural penal në nenin 290 i konsideron si rrethana që nuk lejojnë fillimin e procedimit penal, Prokuroria kompetente nuk operon menjëherë me regjistrimin e veprës penale në Regjistrin e Njoftimeve të Veprave Penale të kallëzimeve të protokolluara pranë saj, sipas kërkesave të nenit 287 të KPP-së. Fillimisht, ajo bën një verifikim paraprak të ekzistencës së rrethanave të mësipërme, gjithsesi për jo më shumë se 15 ditë, përpara se të urdhërojë regjistrimin e veprës penale apo të vendosë mosfillimin e procedimit, në zbatim të nenit 291 § 1 të KPP-së.

Gjithsesi, afati 15 ditor i referohet vetëm verifikimit të rrethanave të përcaktuara në përmbajtjen e nenit 290 dhe nuk ka lidhje e nuk zbatohet kur jemi përpara veprave penale të dukshme (të konstatueshme *ictu oculi*), të kryera pak ditë nga referimi në organin e prokurorisë dhe që për autorët e supozuar nuk ngrihen dyshime për mbushjen e moshës për përgjegjësi penale dhe as kryerja e veprës penale në kushtet e humbjes tërësisht të ekuilibrit mendor. Në raste të tilla, **regjistrimi i veprës penale dhe i autorit të dyshuar në Regjistrin e Njoftimeve të Veprave Penale duhet të kryhet pa vonesë nga prokurori që i është ngarkuar me hetimin e çështjes.**

6.1.1 Problematika e parë lidhet me vonesat në regjistrimin e veprës penale, pas referimit të saj nga Policia Gjyqësore

Në procedimet penale të marra në shqyrtim, në një pjesë të konsiderueshme, zbatohet drejt dispozita e pikës 1 të nenit 287 të KPP-së. Në këto raste **prokurori** i ngarkuar me hetimin paraprak të çështjes **urdhëron regjistrimin në Regjistrin e Njoftimit të Veprave Penale,** jo vetëm **të veprës penale që dyshohet të jetë kryer,** por edhe **emrin e personit** që i atribuohet kryerja e saj. **Ky regjistrim, për veprat penale serioze,** të referuara nga Policia Gjyqësore, **kryhet menjëherë me marrjen e njoftimit ose ditën e nesërme të punës.** Në vepra penale të tjera më pak të rënda vërehet se ato regjistrohen në harkun kohor të 3-4 ditëve punë, duke mos u konstatuar si mangësi, për sa kohë magjistratët, edhe për shkak të ngarkesës në punës, e kanë të vështirë t'i kryejnë detyrat në afate të arsyeshme. *Për qëllime të studimit, nuk janë vlerësuar si të meta mosurdhërimi i shënimit në regjistër të kallëzimeve që nuk kalojnë 10 ditë,* duke gjykuar se ky afat në momentin jo të zakonshëm që po kalon organi i prokurorisë, duhet të konsideruar si afat i arsyeshëm.

Këtu duhet vënë në dukje se, **në të gjitha procedimet penale ku janë vërejtur mosrespektim i afatit të arsyeshëm për regjistrimin e veprës penale, referimi është bërë nga Policia Gjyqësore. Kjo e fundit, për**

secilin prej referimeve i ka njoftuar në çdo rast prokurorisë edhe emrin e personit që i atribuohet vepra penale. Këto referime, si rregull, janë paraqitur në kohë në prokurori, brenda 72 orëve, sikundër urdhëron neni 293 § 1 i KPP-së. Por, edhe kur ky afat nuk është respektuar nga Policia Gjyqësore, kjo kohë nuk është llogaritur për të verifikuar kohëzgjatjen e regjistrimit të veprës penale dhe emrit të personit që i atribuohet ajo.

Nga studimi i fashikujve të procedimeve penale të gjashtë prokurorive të juridiksionit të zakonshëm janë konstatuar edhe raste të tejkalimit joracional të afatit të regjistrimit të veprës penale dhe autorit të dyshuar, si dhe mosregjistrim i emrit të personit që i atribuohet kryerja e saj, edhe pse identiteti dhe autorësia e dyshuar ka qenë e qartë, madje në disa raste edhe për vepra penale ku autori është arrestuar në kushtet e flagrancës (neni 252 i KPP-së), në kryerje e sipër të veprës penale. Më poshtë po pasqyrojmë disa raste pikante të moszbatimit të duhur të nenit 287 § 1 të KPP-së.

Në procedimi penal nr. 10/2023¹⁰⁶, të Prokurorisë së Shkodrës, ku të miturit J.B. iu sekuestrua një armë zjarri nga kontrolli në kushtet e flagrancës i Policisë Gjyqësore, në datë 21.12.2022, vërehet se **prokurori** i çështjes, në datë 10.1.2023, ka urdhëruar regjistrimin në Regjistrin e Njoftimit të Veprave Penale vetëm të veprës përkatëse, edhe pse, ndërkohë, autori i dyshuar ishte identifikuar që në referimin e bërë nga Policia Gjyqësore. Nga verifikimi në tërësi i fashikullit vërehet se, **emri i të miturit në konflikt me ligjin nuk është urdhëruar të shënohet**, në kundërshtim me pikën 1 të nenit 287 të KPP-së, edhe pse ai është akti i parë që paraprin çdo veprim tjetër procedural ku merr pjesë autori i dyshuar.

Megjithatë, mendojmë se në rastin e mësipërm duhet të jemi përpara një ometimi të përfshirjes në fashikullin e prokurorit të aktit përkatës, ku është urdhëruar shënimi në regjistër edhe i emrit të të dyshuarit, sepse në datë 10.3.2023¹⁰⁷ prokurori ka urdhëruar zgjatjen e afateve të hetimit, në zbatim të nenit 324 § 1¹⁰⁸ të KPP-së. Sipas pikës 2, të nenit 323 të KPP-së: *"Afati i përfundimit të hetimeve është tre muaj nga data në të cilën emri i personit që i atribuohet vepra penale është shënuar në regjistrin e njoftimit të veprave penale, dhe gjashtë muaj për veprat penale të parashikuara nga shkronjat "a" dhe "b", të nenit 75/a, të këtij Kodi."* Nga kuptimi që i jepet afatit të hetimeve paraprake në normën e mësipërme, arrijmë në përfundimin që, ato kanë si pikë nistore ekzistenciale shënimin në Regjistrin e Njoftimit të Veprave Penale të emrit të personit që i atribuohet vepra penale, ndaj nuk mund të kemi zgjatje të afatit të hetimit, pa nisur ky afat dhe pa u përfunduar afati fillestar prej 3 muajsh.

Për fat të mirë, rasti i mësipërm është rast i izoluar, të cilin çmuam ta evidentonim për shkak të rëndësisë që paraqet për korrektësinë e hetimit paraprak shënimi i emrit të personit që dyshohet se ka kryer një vepër penale. Megjithatë, në procedimin që po trajtojmë, kjo nuk është parregullsia e vetme. Një e metë tjetër është regjistrimi i procedimit penal në datë 10.1.2023, 19 ditë pas referimit të faktit penal nga Policia Gjyqësore në Prokurori, protokolluar në këtë të fundit me nr. 1830, në datë 22.12.2022.

Nga fashikujt e procedimeve të analizuara rezulton se, **vonesën më të madhe në regjistrimin e veprës penale e mban një dosje e Prokurorisë së Tiranës,** që procedimin penal **nr. 2578/2024**, në ngarkim të të miturve A.G., T.Ç. dhe Xh.M., të referuar nga Policia Gjyqësore në datë 26.2.2024, e regjistroi vetëm në datë 12.4.2024, pra **1 muaj e 16 ditë më vonë.** Menjëherë pas saj vjen **Prokuroria e Vlorës** që procedimin penal **nr. 796/2023**, në ngarkim të të miturit F.K., e regjistroi në datë 21.7.2023, ndërkohë që Policia Gjyqësore e kishte referuar në datë 7.6.2023, pra **1 muaj e 14 ditë më vonë.** Pas tyre, **me 27 ditë vonesë** vjen procedimi penal **nr. 328/2024**, i **Prokurorisë së Fierit**, ku regjistrimi i veprës penale dhe i autorëve E.P. dhe R.R. në Regjistrin e Njoftimit të Veprave Penale u urdhërua të kryhej në datë 26.2.2024, edhe pse referimi i policisë gjyqësore ishte bërë në datë 29.1.2024.


106 Procedimi penal **nr. 10/2023**, i **Prokurorisë së Shkodrës**, në ngarkim të të miturit në konflikt me ligjin, **J.B.**, për veprën penale *"Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe municioneve"*, parashikuar nga neni 278 § 4 i Kodit Penal.", f. 11.

107 Shih f. 16-18 të procedimit penal **nr. 10/2023** të **Prokurorisë së Shkodrës.**

108 Neni 324 § 1 i KPP-së ka këtë përmbajtje: *"Prokurori mund ta zgjasë afatin e hetimeve për një kohë deri në tre muaj. Në rastin e Prokurorisë së Posaçme ky afat është deri në gjashtë muaj."*

Vonesa më të vogla vërehen në dy procedime penale të Prokurorive të Shkodrës dhe Elbasanit, ku procedimi penal **nr. 37/2023 i Prokurorisë së Shkodrës** ndaj të miturit në konflikt me ligjin A.G. është regjistruar më 17.1.2023, **12 ditë më vonë** nga referimi i bërë nga Policia Gjyqësore, më 4.1.2023, ndërkohë që procedimi penal **nr. 809/2024 i Prokurorisë së Elbasanit** u regjistrua në datë 2.7.2024 (**11 ditë më vonë**) ndërkohë që referimi i Policisë Gjyqësore për faktin penal dhe autorësinë e atribuuar të miturit P.C. kishte mbërritur në prokurori më 20.6.2024.

Tabela tregon kohën e kaluar nga referimi i veprës penale nga Policia Gjyqësore në Prokurori deri në regjistrimit e veprës penale në Regjistrin e Njoftimit të Veprave Penale, sipas procedimeve penale të marra në analizë:



6.1.2 Problematika e dytë lidhet me mosshënimin e njëkohshëm në regjistrin e veprave penale edhe të emrit të personit që i atribuohet vepra penale, kur në referimet e policisë gjyqësore autorësia është e evidentuar qartë

Procedimi penal më problematik është ai i **Prokurorisë së Vlorës, nr. 796/2023**, që i përket të miturit në konflikt me ligjin, **F.K.**, emri i të cilit u regjistrua në Regjistrin e Njoftimit të Veprave Penale më 14.10.2024, **1 vit e 2 muaj më vonë** nga regjistrimi i veprës penale (21.7.2023). Në gjykimin tonë, ky afat sfidon çdo standard ndërkombëtar dhe shqiptar, që kërkon që procedimi penal ndaj të miturit në konflikt me ligjin të zhvillohet sa më shpejt dhe, madje me përparësi nga çështjet e tjera, parim që është shpërfillur dukshëm në këtë procedim.


Çështja tjetër që ndjek për nga rëndësia atë të sipërcituar, por që, gjithsesi, zgjat më pak muaj, është ajo e **Prokurorisë së Shkodrës** - procedimi penal **nr. 446/2023** - ku **emri i të miturit, A.G.**, për dy veprat penale, të regjistruar respektivisht më 8.5.2023 për veprën e parë penale (neni 284 i Kodit Penal) dhe më 30.5.2023 për veprën e dytë (neni 291 i Kodit Penal) u regjistrua në datë 8.1.2024, d.m.th. **8 muaj** pas regjistrimit të veprës së parë penale dhe **mbi 7 muaj** pas regjistrimit të veprës së dytë.

Në vijim, vjen procedimi penal **nr. 2578/2024**, i **Prokurorisë së Tiranës**, ku koha e kaluar nga regjistrimi i veprës penale (12.4.2024) deri në regjistrimin e emrit të autorëve që i atribuohet vepra penale, **A.G., T.Ç. dhe Xh.M.**, ishte **5 muaj e 25 ditë**.

I katërti në radhë për nga rëndësia e të metës së konstatuar është procedimi penal **nr. 44/2023 i Prokurorisë së Shkodrës**, ku emri i personit nën hetim, **G.N.**, u regjistrua në datë 15.5.2024, **3 muaj e 28 ditë** pasi kishte regjistruar veprën penale, më 17.1.2024.

I fundit procedim penal **nr. 37/2023**, është sërish i **Prokurorisë së Shkodrës**, ku emri i të miturit në konflikt me ligjin, **A.G.**, u regjistrua më 3.4.2023, **2 muaj e 16 ditë** më vonë nga regjistrimi i veprës penale, më 17.1.2024.

Gjetjet mbi vonesën ndërmjet regjistrimit të veprës penale dhe regjistrimit të emrit të të miturit në Regjistrin e Njoftimit të Veprave Penale:



6.2 Kufizimi i lirisë së të miturit në konflikt me ligjin nga Policia Gjyqësore nëpërmjet aktit të “kapjes në flagrancë” dhe mungesa e vleftësimit të tij nga Prokurori dhe/ose gjykata

Në pesë fashikuj hetimorë të këqyrrur është vërejtur se, të miturit në konflikt me ligjin janë “kapur në flagrancë” nga Policia Gjyqësore. Gjendja e flagrancës është përcaktuar në nenin 252 të KPP-së me këtë përkufizim: “*Është në gjendje flagrante ai që është kapur në kryerje e sipër të veprës penale ose ai që menjëherë pas kryerjes së veprës ndiqet nga policia gjyqësore, nga personi i dëmtuar ose nga persona të tjerë ose që është kapur me sende dhe prova e materiale, nga të cilat duket se ka kryer veprën penale.*”

Në rastet e shqyrtuara, vërehet se, në katër prej tyre të miturit në konflikt me ligjin janë kapur në kryerje e sipër të veprës penale: (i) **K.B.**, duke mbajtur një armë të ftohtë (dorezë hekuri) – procedimi penal **nr. 627/2023 i Prokurorisë së Shkodrës**; (ii) **J.B.** duke mbajtur në banesën e tij një armë zjarri – procedimi penal **nr. 10/2023 i Prokurorisë së Shkodrës**; (iii) **K.Ç.**, duke drejtuar një automjet i pa pajisur me leje drejtimi - procedimi penal **nr. 1123/2023 i Prokurorisë së Fierit** dhe (iv) **J.D.**, duke drejtuar një automjet i pa pajisur me leje drejtimi – procedimi penal **nr. 146/2025 i Prokurorisë së Fierit**. Ndërkohë që, i mituri, R.V., iu kufizua liria nga Policia Gjyqësore menjëherë pas kryerjes së veprës penale të “*Vrasjes kundër dy a më shumë personave*”, mbetur në tentativë, pas një ndjekje të pandërprerë – procedimi penal nr. 6711/2024 i Prokurorisë së Tiranës.

Në të gjithë rastet e përmendura nuk vihet në diskutim gjendja e flagrancës e të miturve në konflikt me ligjin, por detyrimi apo diskrecioni i oficerëve të Policisë Gjyqësore (OPGJ) për të kryer arrestimin në flagrancë, në kuptim të nenit 251 të KPP-së, i cili bën këtë përcaktim:

1. *Oficerët dhe agjentët e policisë gjyqësore kryejnë detyrimisht arrestimin e cilitdo që kapet në flagrancë për një krim me dashje, të kryer ose të mbetur në tentativë, për të cilin ligji cakton dënimin me burgim jo më të ulët në maksimum se pesë vjet.*
2. *Oficerët dhe agjentët e policisë gjyqësore kanë të drejtë të arrestojnë cilindo që kapet në flagrancë për një krim me dashje, të kryer ose të mbetur në tentativë, për të cilin ligji cakton dënimin me burgim jo më të ulët në maksimum se dy vjet ose për një vepër penale të kryer nga pakujdesia, për të cilën ligji cakton dënimin me burgim jo më të ulët në maksimum se dhjetë vjet.*

3. **Kur lind nevoja e domosdoshme, për shkak të rëndësisë së faktit ose të rrezikshmërisë së subjektit, e motivuar me akt të veçantë, oficerët dhe agjentët e policisë gjyqësore kanë të drejtë të arrestojnë cilindo që kapet në flagrancë, edhe kur nuk janë kushtet e pikës 2.**

Në rastet e parashikuara nga paragrafi 1, çdo person është i autorizuar të kryejë arrestimin në flagrancë për krimet që ndiqen kryesisht. Ai që ka kryer arrestimin duhet të dorëzojë menjëherë të arrestuarit në policinë gjyqësore, e cila mban procesverbal për dorëzimin dhe i jep një kopje të tij."

Përpara se të analizojmë rrethanat e arrestimeve të të miturve, duhet të bëjmë një sqarim që, në asnjë dispozitë të KPP-së nuk parashikohet "kapja në flagrancë" si veprim procedural që lejon Policinë Gjyqësore të kufizojë përkohësisht lirinë e personit. **I vetmi akt i policisë gjyqësore me të cilin realizohet ky kufizim lirie është "arrestimi në flagrancë", i rregulluar në nenin 251 të sipërcituar.** Pra, **një person mund të arrestohet pasi kapet në flagrancë, sepse flagranca është gjendje, ndërkohë që arrestimi është veprimi procedural i Policisë Gjyqësore për të ndërprerë këtë gjendje paligjshmërie** dhe që dokumentohet në një procesverbal të veçantë. Për pasojë, cilindo qoftë emërtimi që Policia Gjyqësore i bën aktit që kufizon lirinë e personit që gjendet në kushtet e flagrancës duke kryer një vepër penale, ai në thelb është arrestim në flagrancë.

Le të vijojmë me analizën e rrethanave të arrestimeve të secilit prej të miturve të sipërcituar:

- (i) i mituri **K.B.** është dyshuar për kryerjen e veprës penale të mbajtjes së armës së ftohtë, në automjet, e parashikuar nga neni 279 § 2¹⁰⁹ i Kodit Penal dhe e dënueshme nga 1 deri në 5 vjet. Nga përmbajtja e dispozitës arrihet në përfundimin se, jemi përpara një krimi, ai kryhet vetëm me dashje (mbajtja e armës së ftohtë) dhe dënohet në maksimum me 5 vjet. Duke u ndodhur përpara këtyre përcaktimeve **oficerët dhe agjentët e policisë gjyqësore kanë qenë të detyruar të kryenin arrestimin në flagrancë të të miturit, K.B., në zbatim të përcaktimeve të nenit 251 § 1 të KPP-së.**
- (ii) i mituri **J.B.**, është dyshuar se mbante armë luftarake në banesë, vepër penale e parashikuar nga neni 278 § 4¹¹⁰ i Kodit Penal dhe e dënueshme nga 1 deri në 3 vjet. Në këtë rast jemi sërish përpara një krimi, që dënohet në maksimum deri në 3 vjet. Në këto kushte, **oficerët dhe agjentët e policisë gjyqësore kanë zbatuar pushtetin diskrecionar që i ka njohur pika 2, e nenit 251 të KPP-së, për të arrestuar në flagrancë të miturin, J.B., që i lejon të arrestojnë, sipas vlerësimit të tyre, edhe personat që kryejnë me dashje krime që dënohen me burgim në maksimum jo më pak se dy vjet.**
- (iii) ndërkohë, në lidhje me të miturit **K.Ç.** dhe **J.D.**, rezulton se ata kanë drejtuar automjete pa leje drejtimi, fakt që parashikohet si krim, që kryhet me dashje dhe që neni 291¹¹¹ i Kodit Penal, e dënon në maksimum me 3 vjet burgim. Edhe në rastin e të miturve K.Ç. dhe J.D. **oficerët dhe agjentët e policisë gjyqësore kanë zbatuar diskrecionin që buron nga neni 251 § 2 i KPP-së, për të arrestuar në flagrancë të miturit e lartpërmendur.**
- (iv) së fundi, në rastin e të miturit **R.V.**, ai ka tentuar të vrasë tre të mitur të tjerë¹¹², ndaj fakti penal është krim shumë i rëndë, kryhet me dashje dhe dënohet gjër me burgim të përjetshëm, ndaj edhe në këtë rast **oficerët dhe agjentët e policisë gjyqësore kanë qenë të detyruar të kryenin arrestimin në flagrancë të të miturit, K.B., në zbatim të përcaktimeve të pikës 1, të nenit 251 të KPP-së.**

Në dosjet e analizuar është vërejtur se, për të miturit KB, J.B, K.Ç dhe J.D. prokurorët respektivë të çështjeve kanë çmuar që ata të mos hetohen me ndonjë masë sigurimi personal me karakter shtrëngues (neni 232 i KPP-së dhe neni dhe 82 të KDPM-së). Ndërsa e kanë vlerësuar si të dobishme që të miturit të hetohen në liri, në zbatim të kërkesës ligjore për "të mos ndërprerë proceset edukative, të mirërritjes dhe të zhvillimit normal të një të mituri" (pika 2

109 Neni 279 § 2 i Kodit Penal parashikon: "**Mbajtja, blerja apo shitja në automjete apo në çdo mjet tjetër të motorizuar, në mjedise publike ose në mjedise të hapura për publikun, e armëve të ftohta si shpatat, bajonetat, thikat dhe mjete të tjera të përgatitura e të destinuara posaçërisht për sulm kundër personave ose për vetëmbrojtje, pa lejen e organeve kompetente, dënohen me burgim nga një deri në pesë vjet**".

110 Neni 274 § 4 i Kodit Penal ka këtë përmbajtje: "**Mbajtja e armëve në banesë, pa lejen e organeve kompetente shtetërore, dënohet me burgim nga një deri në tre vjet**".

111 Neni 291 § 1 i Kodit Penal parashikon: "**Drejtimi i automjeteve apo mjeteve të tjera të motorizuara në gjendje të dehur, nën efektin e lëndëve narkotike apo pa dëshminë përkatëse të aftësisë dënohet me burgim nga dhjetë ditë deri në tre vjet**".

112 Neni 79(dh) i Kodit Penal përcakton: "**Vrasja me dashje e kryer: ... dh) kundër dy ose më shumë personave; ... dënohet me burgim jo më pak se njëzet vjet ose me burgim të përjetshëm**".

e nenit 81 të KDPM-së) ata nuk kanë zbatuar kërkesën e pikës 2 të nenit 85 të KDPM-së që parashikon: **“2. Kur nuk urdhëron lirin e menjëhershëm, prokurori, pa vonesë, por, sidoqoftë brenda 48 orëve nga arrestimi ose ndalimi, kërkon vleftësimin e tyre në gjykatën kompetente.”**

Këtu duhet kujtuar që, në lëmin e paramasave të sigurimit, prokurori ka vetëm pushtet “negativ”, pra ai mund të vleftësojë të paligjshëm një arrestim apo ndalim të Policisë Gjyqësore, në zbatim të nenit 257¹¹³ të KPP-së, vetëm nëse plotësohen hipotezat e parashikuara në përmbajtjen e tij dhe që lidhen me:

- a) ngatërrimin e personit që duhej arrestuar/ndaluar;
- b) mungesën e kushteve ligjore për të kryer një arrestim/ndalim dhe
- c) tejkalimin e afatit prej 48 orësh për të kërkuar në gjykatë që arrestimi në flagrancë apo ndalimi të vleftësohet i ligjshëm.

Në rastet e studiuara nuk disponohet asnjë akt i prokurorit që të ketë urdhëruar lirin e menjëhershëm të të miturve për ndonjë prej shkaqeve që përmendëm në paragrafin paraardhës. Duke mos vepruar sipas përcaktimeve të nenit 257 të KPP-së, në lidhje me nenin 85, pika 2¹¹⁴ të KDPM-së, **ka mbetur pa u verifikuar nga gjykata ligjshmëria e kufizimit të përkohshëm të lirisë së të miturve, veprim i domosdoshëm dhe detyrim kushtetues, i sanksionuar në nenet 27, paragrafi 2, nënparagrafi “c” dhe 28, paragrafi 2 të Kushtetutës.** Pa këtë akt të domosdoshëm mbetet e paqartë sesa kanë qëndruar nën këtë paramasë sigurimi të miturit dhe nuk është gjykuar mbi ligjshmërinë e arrestimit në flagrancë të kryer nga Policia Gjyqësore, vlerësim ky i domosdoshëm për të garantuar respektimin e të drejtës kushtetuese për liri dhe siguri.

Ndërsa, në rastin e të miturit **R.V.**, ai ndonëse është arrestuar njëherë në flagrancë “kapur në flagrancë”, në orën 15:00 të datës 23.9.2021, ai sërish “arrestohet në flagrancë”, në orën 17:30 të të njëjtës datë.¹¹⁵ Duke qenë përpara një akti që kufizon lirinë “data dhe ora e kapjes në flagrancë” janë edhe çasti kohor kur efektivisht personit të arrestuar i është kufizuar liria, ndaj duke filluar nga ky moment duhet të llogaritet respektimi i afatit prej 48 orësh brenda të cilit duhet dërguar kërkesa në gjykatë për vleftësimin e ligjshëm të arrestit në flagrancë.

E drejta për liri dhe siguri e cilitdo person dhe aq më tepër e të miturit në konflikt me ligjin, është një nga të drejtat themelore më të rëndësishme të njeriut, ndaj **çdo masë e Policisë Gjyqësore dhe prokurorit që e kufizon, qoftë edhe përkohësisht këtë liri, duhet të verifikohet nga gjykata, në zbatim të detyrimeve konventore (neni 5 i KEDNJ-së) dhe kushtetuese.** Qëndrimet neglizhente në këtë aspekt, mund të kontribuojnë në krijimin e një klime paligjshmërie që është e papajtueshme me parimet dhe normat kushtetuese të shtetit të së drejtës.

6.3 Mosdhënia e letrës së të drejtave apo mungesa e nënshkrimit të letrës së të drejtave nga përfaqësuesi ligjor, avokati dhe psikologu, si dhe mosplotësimi i datës dhe/apo orës në letrën e të drejtave

Nga studimi i akteve të përfshira në fashikujt e procedimeve penale të analizuara për efekt të këtij studimi rezulton se, **përgjithësisht, nga organet proceduese respektohet detyrimi i vendosur nga nenet 140(1), 256, 296(1) dhe 308(2)-d të KPP-së për t’i dhënë të miturit në konflikt me ligjin letrën e të drejtave**, përpara se ai të merret në pyetje apo menjëherë pasi ai është arrestuar/ndaluar apo është ekzekutuar masa e sigurimit “Arrest në burg”, të caktuar në mungesë, në zbatim të nenit 73(3) të KDPM-së të lexuar së bashku me nenet 246(1) dhe 255(3) të KPP-së.

113 Neni 257 i KPP-së bën këtë përcaktim: “1. Kur del e qartë se arrestimi ose ndalimi është bërë për shkak se është ngatërruar personi ose nuk janë respektuar kërkesat e ligjit ose kur masa e arrestit ose e ndalimit e ka humbur fuqinë për shkak të shkeljes së afatit të kërkesës për vleftësimin e masës, prokurori urdhëron, me vendim të motivuar, që i arrestuari ose i ndaluari të lirohet menjëherë. Në këto raste liri urdhërohet edhe nga oficeri i policisë gjyqësore, i cili njofton menjëherë prokurorin e vendit ku është kryer arrestimi ose ndalimi”

114 Neni 85, pika 2 e KDPM-së parashikon: “2. **Kur nuk urdhëron lirin e menjëhershëm, prokurori, pa vonesë, por, sidoqoftë brenda 48 orëve nga arrestimi ose ndalimi, kërkon vleftësimin e tyre në gjykatën kompetente.**”

115 Shih f. 74 & 76 të procedimi penal nr. 157/2021, të Prokurorisë së Tiranës.

Aktin e shkruar, ku janë dokumentuar këto të drejta, në të shumtën e rasteve e nënshkruajnë, krahas të miturit nën hetim, edhe mbrojtësi i tij, përfaqësuesi ligjor dhe psikologu. Në jo pak raste këtë letër e nënshkruan edhe oficeri i Policisë Gjyqësore apo prokurori që ka operuar me pyetjen e të miturit (sipas neneve 308 dhe 315 § (c) të KPP-së). Gjykojmë që, nënshkrimi i letrës së të drejtave të të miturit në konflikt me ligjin edhe nga përfaqësuesi i organit procedues është i nevojshëm, por gjithsesi jo i domosdoshëm, pasi nëpërmjet nënshkrimit në të merret dijenia për personin konkret (pjesë e organit procedues) që e ka zbatuar këtë detyrim të parashikuar nga ligji dhe që, vetëm duke qenë i evidentuar, këtij funksionari mund t'i kërkohet eventualisht edhe të japë llogari në lidhje me moszbatimin e ligjit.

Këtu gjejmë rastin të evidentojmë se, **OPGJ-të që kryejnë arrestimin në flagrancë apo ndalimin me iniciativë edhe të të miturve në konflikt me ligjin, nuk e pasqyrojnë thujtë asnjëherë në përmbajtjen e procesverbaleve që dokumentojnë veprimet e tyre** (arrestim apo marrje deklarimesh) **faktin e dorëzimit prej tyre të letrës së të drejtave, njohjes paraprakisht të këtyre të drejtave nga i miturit dhe sqarimi, nëpërmjet pyetjes së të miturit, nëse ky i fundit i ka kuptuar ato.** Njohja efektivisht e të miturit në konflikt me ligjin me të drejtat e tij procedurale është një detyrë e rëndësishme e Policisë Gjyqësore, sikundër kemi argumentuar më lart në këtë studim, por që nuk vlerësohet me seriozitetin e duhur. Ndryshe nga OPGJ-të, prokurorët, kur marrin në pyetje të miturit në konflikt me ligjin, gjithmonë kërkojnë të dinë paraprakisht nga ata nëse janë njohur me letrën e të drejtave dhe nëse i kanë kuptuar këto të drejta, model që duhet ta kërkojnë edhe të OPGJ-të, nëpërmjet udhëzimeve dhe urdhrave që japin.

Duke u kthyer të rëndësia e letrave të të drejtave duhet vënë në dukje se, hulumtimi i fashikujve të procedimit penal në gjashtë Prokurori pranë Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm na ka evidentuar, *in primis*, shembuj të mirë¹¹⁶ në lidhje me zbatimin e procedurës së dhënies së letrës së të drejtave dhe që i referohen **Prokurorisë së Elbasanit**. Nga fashikujt hetimorë të konsultuar për llogari të këtij studimi na rezultoi se është respektuar me përpikëri procedura e njohjes së të miturit në konflikt me ligjin me letrën e të drejtave përpara se atyre t'u merrreshin deklarime nga Policia Gjyqësore apo të pyeteshin, pasi iu ishte komunikuar akuza nga prokurori. **Letra është nënshkruar rregullisht nga të gjithë personat e kërkuar** (i mituri, përfaqësuesi ligjor, mbrojtësi, psikologu dhe OPGJ), **ka të shënuar datën e dorëzimit të saj te i mituri dhe për faktin e dhënies së paraprakisht të letrës dhe njohjen me të drejtat e përshkuara në të, të miturit i kanë pohuar në procesverbalet respektive.**

Edhe pse duhet pranuar që Policia Gjyqësore dhe prokuroria bëjnë përpjekje të dallueshme për t'i dhënë letrat e të drejtave të miturve në konflikt me ligjin, përsëri vërehet se ajo **në të shumtën e rasteve nuk mban datën dhe/ apo orën e dorëzimit të saj te i mituri apo nuk nënshkruhet nga të gjithë personat që ligji kërkon të marrin dijeni për të.** Në këtë pikë duhet të sqarojmë se, fakti i mos nënshkrimit të letrës së të drejtave nuk i referohet të miturit në konflikt me ligjin, pasi ai, në çdo rast të verifikuar në fashikujt hetimorë, e ka nënshkruar atë, por për mbrojtësin, përfaqësuesin ligjor dhe psikologun. Më poshtë do të jepen disa raste të mosplotësimit të kushteve ligjore në dorëzimin e letrave të të drejtave te i mituri në konflikt me ligjin.

Nga shqyrtimi i të gjithë fashikujve për qëllime të këtij studimi, u provua se **data e vënies në dispozicion e letrës së të drejtave të miturit në konflikt me ligjin, është shënuar vetëm në shtatë nga njëzet e pesë procedimet e analizuara, ku, përveç tre rasteve të Prokurorisë së Elbasanit, përmendim dy raste të Prokurorisë së Shkodrës (procedimi penal nr. 44/2023¹¹⁷ dhe procedimi penal nr. 627/2023¹¹⁸), një rast të Prokurorisë së Fierit (procedimi penal**

116 Procedimet penale të **Prokurorisë Elbasan: nr. 166/1-/2023**, që i përket të miturit në konflikt me ligjin, M.C. (16 vjeç) i akuzuar për veprën penale "Dhunë në familje", parashikuar nga neni 130(a)-4 i Kodit Penal"; **nr. 809/2023**, që i përket të miturit në konflikt me ligjin, P.C. (16 vjeç), akuzuar për veprën penale të "Vjedhjes", parashikuar nga neni 134(1) i Kodit Penal dhe **nr. 1227/2023**, që i përket të miturit në konflikt me ligjin, F.Z. (15 vjeç), i akuzuar për kryerjen e veprave penale të "Dhunës në familje", kryer dy herë, parashikuar nga nenet 130/a(1) dhe 130/a(3) të Kodit Penal

117 **Procedimi penal nr. 44/2023 i Prokurorisë së Shkodrës**, në ngarkim të të miturit në konflikt me ligjin, **G.N. (16 vjeç)**, i akuzuar për veprën penale "Njoftimi i rremë në organet e rendit publik", parashikuar nga neni 272 i Kodit Penal.

118 **Procedimi penal nr. 627/2023 i Prokurorisë së Shkodrës**, në ngarkim të të miturit në konflikt me ligjin, **K.B. (16 vjeç)**, i akuzuar për veprën penale "Mbajtje pa leje të armëve të ftohta", parashikuar nga neni 279(2) të Kodit Penal.

nr. 328/2024¹¹⁹) dhe një rast të Prokurorisë së Vlorës (procedimi penal nr. 14/2024)¹²⁰.

Më poshtë po rendisim procedimet penale ku letrën e të drejtës nuk e kanë nënshkruar, sipas rastit, prindi (përfaqësuesi ligjor), mbrojtësi (avokati) dhe psikologu.

a) Në procedimet penale të mëposhtme është vërejtur se, letra e të drejtave të të miturit në konflikt me ligjin nuk i është bërë e njohur as prindit, as avokatit dhe as psikologut:

- (i) *procedimi penal nr. 331/2024*¹²¹ i Prokurorisë së Tiranës;
- (ii) *procedimi penal nr. 44/2023* i Prokurorisë së Shkodrës;
- (iii) *procedimi penal nr. 146/2025*¹²² i Prokurorisë së Fierit;
- (iv) *procedimi penal nr. 836/2024*¹²³ i Prokurorisë së Vlorës dhe
- (v) *procedimi penal nr. 204/2019*¹²⁴ i Prokurorisë së Durrësit (letra e të drejtave dhënë të miturit L.L.).

Sa më lart përbën rastin më të rëndësishëm të shkeljes së të drejtave të të miturve në konflikt me ligjin për të pasur gjatë gjithë procedimit penal ndihmë ligjore dhe psikologjike, si pjesë e esenciale e të drejtës së mbrojtës së tyre, sikundër kërkon neni 35 i KPP-së dhe neni 19 § 3 (a) i KDPM-së. I mituri, duke mos pasur ndihmën e specializuar ligjore të mbrojtësit për të kuptuar natyrën dhe rëndësinë e të drejtave që i tregohen në dokumentin përkatës, ndihmën emocionale dhe shpirtërore të prindit apo të personit të besuar për të ruajtur vetëvlerësimin dhe ekuilibrin e nevojshëm emocional, si dhe mbështetjen psikologjike për t'u mos u stigmatizuar dhe për të përballuar psiqikisht tensionin që krijohet nga përballja me organet e procedimit penal, e ka pasur thuajse të pamundur që të përballojë me suksese pyetjen e tij apo çdo veprim tjetër procedural ku prania e tij është e domosdoshme.

b) Në rastet në vijim është vërejtur mosprania e njëkohshme e prindit të të miturit në konflikt me ligjin dhe e psikologut:

- (i) *procedimi penal nr. 331/2024* i Prokurorisë së Tiranës;
- (ii) *procedimi penal nr. 627/2023* i Prokurorisë së Shkodrës;
- (iii) *procedimi penal nr. 338/2023*¹²⁵ i Prokurorisë së Shkodrës dhe
- (iv) *procedimi penal nr. 204/2019* i Prokurorisë së Durrësit (që i përket të miturit në konflikt me ligjin, L.M.)

Edhe në këto procedime penale **konstatohet cenim i të drejtës së mbrojtjes** së të miturve në konflikt me ligjin, **në drejtim të ndihmës psikologjike dhe emocionale**, që janë shumë të nevojshme për të miturit, sidomos gjatë marrjes së tyre në pyetje gjatë hetimit paraprak, por edhe në veprimet e tjera që duhet të marrin pjesë.

119 **Procedimi penal nr. 328/2024 i Prokurorisë së Fierit**, që i përket të miturve në konflikt me ligjin, **E.P. dhe R.R. (të dy 15 vjeçarë)**, të akuzuar për veprën penale të "Vjedhjes", në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 134(2) i Kodit Penal.

120 **Procedimi penal nr. 14/2024 i Prokurorisë së Vlorës**, që i përket të miturve në konflikt me ligjin, **A.H (15 vjeç), P.K. (16 vjeç) dhe K.K. (16 vjeç)**, të akuzuar për veprën penale të "Vjedhjes", në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 134(2) i Kodit Penal.

121 **Procedimi penal nr. 331/2024 i Prokurorisë së Tiranës**, që i përket të miturit **S.K.** (16 vjeç), i akuzuar se në bashkëpunim me të rriturin G.K. kanë kryer krimin e "Trafikimit të lëndëve narkotike", të parashikuar nga neni 283/a(2) i Kodit Penal, në formën e importimit nga SHBA-të.

122 **Procedimi penal nr. 146/2025 i Prokurorisë së Fierit**, në ngarkim të të miturit në konflikt me ligjin, **J.D. (16 vjeç)**, i hetuar për veprën penale "Drejtim mjeti në mënyrë të parregullt", parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal.

123 **Procedimi penal nr. 836/2024 i Prokurorisë së Vlorës**, në ngarkim të të miturit në konflikt me ligjin, **I.H. (16 vjeç)**, i hetuar për veprën penale "Plagosje e rëndë me dashje në gjendje të tronditjes së fortë psikike", parashikuar nga neni 88/a i Kodit Penal.

124 **Procedimi penal nr. 204/2019 i Prokurorisë së Durrësit**, në ngarkim të të miturve në konflikt me ligjin: **L.L., L.M., F.M., E.M., K.M., K.K., E.H. dhe E.K.**, të akuzuar për kryerjen e veprës penale "Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me të mitur" që nuk ka arritur moshën katërmbëdhjetë vjeç, kryer në bashkëpunim dhe më shumë se një herë, parashikuar nga neni 100(2) i Kodit Penal.

125 **Procedimi penal nr. 338/2023 i Prokurorisë së Shkodrës**, në ngarkim të të miturit në konflikt me ligjin, **A.H. (16 vjeç)**, i akuzuar për veprën penale "Plagosjes së rëndë me dashje", parashikuar nga neni 88(1) të Kodit Penal.

- c) Në *procedimin penal nr. 1123/2023*¹²⁶ të Prokurorisë së Fierit të miturit në konflikt me ligjin, **gjatë njohjes me letrën e të drejtave nuk i është siguruar prania e avokatit dhe psikologut.**

Gjithashtu, në këtë rast të miturit i është mohuar ndihma e kualifikuar profesionale në fushën e të drejtës dhe mbështetja e nevojshme psikologjike nga specialistë të fushës.

- d) Në *procedimin penal nr. 796/2023*¹²⁷ të Prokurorisë së Vlorës, letra e të drejtave i është dhënë të miturit në konflikt me ligjin **në mungesë të prindit dhe mbrojtësit.**

Në këtë rast të miturit nuk i janë shpjeguar të drejtat e tij procedurale dhe as procedimi penal në tërësi, nga mungesa e ndihmës së mbrojtësit. Ndërkohë, të miturit, gjithashtu, nuk i është siguruar ndihma emocionale e shpirtërore nga mungesa e përfaqësuesit të tij ligjor (prindi/kujdestari/personi i besuar).

- e) **Në dy procedime letra e të drejtave nuk i është bërë me dije psikologut** (*procedimi penal nr. 3374/2019*¹²⁸ i Prokurorisë së Tiranës dhe *procedimi penal nr. 446/2023*¹²⁹ i Prokurorisë së Shkodrës)

Duke mos qenë i pranishëm psikologu, i mituri në konflikt me ligjin është lënë pa suportin e nevojshëm psikologjik gjatë përballjes me organet procedues.

- f) Në *procedimet penale nr. 6711/2021*¹³⁰ dhe *nr. 2578/2024*¹³¹ të Prokurorisë së Tiranës, **nuk janë thirrur për të qenë të pranishëm** gjatë dhënies së letrës së drejtave të miturve në konflikt me ligjin, **respektivisht prindi dhe avokati.**

Edhe kjo shkelje ka cenuar të drejtën e mbrojtjes së të miturit, pasi kjo e fundit, që të marrë atë përmasë që kërkon KDPM-ja, duhet që ndihma ligjore dhe ajo emocionale të jetë e njehershme.

Rezultatet e kërkimit të mësipërm po i pasqyrojmë në një tabelë, ku të dhënat e analizuara nga fashikujt procedimeve penale të disa prokurorive, në lidhje **me mosmarrjes pjesë të prindit/personit të besuar, mbrojtësit dhe psikologut në momentin e dorëzimit të letrave të të drejtave të miturve në konflikt me ligjin.** Simbolet janë përdorur për të pasqyruar marrjen () apo mosmarrjen pjesë ()

126 **Procedimi penal nr. 1123/2023 i Prokurorisë së Fierit**, në ngarkim të të miturit në konflikt me ligjin, **K.Ç. (15 vjeç)**, i hetuar për kryerjen e veprës penale *Drejtimi i mjetit në mënyrë të parregullt*, parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal.

127 **Procedimi penal nr. 796/2023 i Prokurorisë së Vlorës**, në ngarkim të të miturit në konflikt me ligjin, **F.K. (17 vjeç)**, i akuzuar për veprën penale *“Prodhimi, mbajtja, blerja apo shitja pa leje e armëve të ftohta”*, parashikuar nga nenet 279(2) i Kodit Penal.

128 **Procedimi penal nr. 3374/2019 i Prokurorisë së Tiranës**, në ngarkim të të miturit në konflikt me ligjin, **E.M. (15 vjeç)**, i akuzuar për veprën penale *“Vjedhja me dhunë”*, parashikuar nga neni 139 i Kodit Penal.

129 **Procedimi penal nr. 446/2023 i Prokurorisë së Shkodrës**, në ngarkim të të miturit në konflikt me ligjin, **A.K. (16 vjeç)**, i akuzuar për veprat penale *“Kultivimi i bimëve narkotike”* dhe *“Drejtimi i mjetit në mënyrë të parregullt”*, parashikuar nga nenet 284 dhe 291 të Kodit Penal.

130 **Procedimi penal nr. 6711/2021 i Prokurorisë së Tiranës**, në ngarkim të të miturit në konflikt me ligjin, **R.V. (16 vjeç)**, i akuzuar për veprën penale *“Vrasja në rrethana të tjera cilësuese”*, kundër dy ose më shumë personave, e mbetur në tentativë, parashikuar nga nenet 79(dh) e 22 të Kodit Penal.

131 **Procedimi penal nr. 2578/2024 i Prokurorisë së Tiranës**, në ngarkim të të miturve në konflikt me ligjin, **A.G., T.Ç. dhe Xh.M.**, të akuzuar për kryerjen e veprës penale *“Shtrëngimi me anë të kanosjes apo dhunës për dhënien e pasurisë”*, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 109/b-1 i Kodit Penal.

Nr.	Prokuroria	Nr. procedimi	I mituri (mosha)	Vepra penale dhe neni i KP	Prind / Përfaqësues ligjor	Avokat / Mbrojtës	Psikolog
1	Tiranë	331/2024	S.K.	Trafikim lëndësh narkotike (N. 283/a § 2)	✗	✗	✗
2	Shkodër	44/2023	G.N.	Njoftim i rremë në organet e rendit publik (N. 272)	✗	✗	✗
3	Fier	146/2025	J.D.	Drejtim mjete në mënyrë të parregullt (N. 291)	✗	✗	✗
4	Vlorë	836/2024	I.H.	Plagosje e rëndë me dashje (N. 88/a)	✗	✗	✗
5	Durrës	204/2019	L.L., L.M., F.M., E.M., K.M., K.K., E.H., E.K.	Marrëdhënie seksuale me të mitur <14 vjeç (N. 100 § 2)	✗	✗	✗
6	Shkodër	627/2023	K.B.	Mbajtje pa leje të armëve të ftohta (N. 279 § 2)	✗	☑	✗
7	Shkodër	338/2023	A.H.	Plagosje e rëndë me dashje (N. 88 § 1)	✗	☑	✗
8	Durrës	204/2019	L.M.	Marrëdhënie seksuale me të mitur (N. 100 § 2)	✗	☑	✗
9	Fier	1123/2023	K.Ç.	Drejtim mjete në mënyrë të parregullt (N. 291)	☑	✗	✗
10	Vlorë	796/2023	F.K.	Prodhim/mbajtje armësh të ftohta (N. 279 § 2)	✗	✗	☑
11	Tiranë	3374/2019	E.M.	Vjedhje me dhunë (N. 139)	☑	☑	✗
12	Shkodër	446/2023	A.K.	Kultivim bimësh narkotike dhe drejtim mjete (N. 284 & 291)	☑	☑	✗
13	Tiranë	6711/2021	R.V.	Vrasje në rrethana cilësuese, tentativë (N. 79(dh) & 22)	✗	☑	☑
14	Tiranë	2578/2024	A.G., T.Ç., Xh.M.	Shtërngim me kanosje për pasuri (N. 109/b § 1)	☑	✗	☑

Analizë e rezultateve:

- Në 5 raste mungojnë të tre figurat njëkohësisht: përfaqësuesit ligjorë, avokati dhe psikologu;
- Në shumicën e rasteve mungojnë dy prej tre aktorëve;
- Psikologu ka munguar më shpesh, me 11 raste nga 14 raste gjithsej, e ndjekur nga prindi (përfaqësuesi ligjor) me 10 raste dhe në fund avokati me 8 raste.

Nën dritën e asaj që pasqyruam më lart, por edhe të sa kemi shpjeguar më herët në këtë punim në lidhje me rëndësinë e bërjes me dije të **të drejtave procedurale të të miturit** në konflikt me ligjin me ligjin, që legjislatori ka kërkuar në nenin 34/a të KPP-së që të dokumentohen me shkrim dhe t'i jepen në dorëzim personave nën hetim, **duhet të theksojmë edhe një herë domosdoshmërinë e shpjegimit të tyre nga profesionistë të ligjit, pas krijimit të një atmosfere emocionale dhe psikologjike sa më të përshtatshme.** Ky kuptim i thelbit të të drejtave të të miturit nuk mund të jetë i plotë, nëse letra e të drejtave nuk analizohet në tërësi nga të gjithë "mbështetësit" e të miturit që po përballet me drejtësinë penale, çka nënkupton që pjesëmarrja e secilit aktor: prind, mbrojtës e psikolog është e domosdoshme. Kontributi që japin këta aktorë është i pazëvendësueshëm, pasi ata, edhe pse në role të ndara, janë komplementarë të njëri-tjetrit.

U ndalëm ndoshta gjatë të rëndësia e letrës së të drejtës, por e dhëna që përftuam **nga intervistimi që bëmë në funksion të këtij studimi në Institutin e të Miturve Kavajë, në datë 8.4.2025,** ishte sa e papritur, aq edhe befasuese. **Asnjë prej dhjetë të miturve të paraburgosur** që ishin në proces hetimi apo gjykimi për vepra të rënda penale në disa prej gjykatave të shkallëve të para apo në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, **nuk pranoi gjatë intervistimit të tyre t'iu ishin shpjeguar të drejtat e tyre procedurale menjëherë sapo ishin ndaluar apo arrestuar në flagrancë dhe vetëm një prej tyre, i mituri S.S. pranoi** (i hetuar nga Prokuroria e Tiranës për veprën penale të "Vjedhjes me dhunë" në bashkëpunim) **që letra e të drejtave iu është bërë me dije përpara marrjes së deklarimeve prej tyre.** Të pyetur në lidhje me nënshkrimin e tyre në letrat e të drejtave ata nuk e mohuan këtë fakt, por, sipas atyre, **ajo iu ishte vënë në dispozicion pasi ata ishin pyetur, pra kur funksioni këshillues e orientues i këtyre të drejtave ishte shterur.**

Ky informacion, edhe nëse nuk është tërësisht i vërtetë, është një kampion alarmi për organet proceduese për të hequr dorë nga praktikat e gabuara të moszbatimit të procedurave të reja që ka njohur ligji procedural penal që pas reformës së thellë që pësoi KPP-ja në vitin 2017 dhe miratimi i KDPM-së, në lidhje me forcimit e të drejtës së mbrojtjes së personit nën hetim në përgjithësi dhe të miturve në përballje me drejtësinë penale në veçanti. **Natyrisht, në dhënien e rëndësisë së duhur të procesit të njohjes së të drejtave të të miturit në konflikt me ligjin duhet të luajnë edhe mbrojtësit (e zgjedhur apo ata *ex-officio*), si dhe psikologët, pasi çdo tolerim nga ana e tyre çon në mosrespektimin e të drejtës së mbrojtjes së të miturit.** Në këtë pikë, **roli që mund të luajnë prindërit është më i vogël,** pasi ata përgjithësisht nuk janë njohës të ligjit dhe kanë nevojë vetë të informohen, **pa harruar këtu traumën që ata kanë pësuar** nga veprimet e dyshuara kriminale të fëmijëve të tyre, çka i bën ata **të ndihen të turpëruar dhe të stigmatizuar** në sytë e funksionarëve të organeve proceduese gjatë përballjes me ta, në shoqërimin e fëmijës.

6.4 Mosdokumentimi nga Policia Gjyqësore i veprimeve që parashikon nenin 48 § 3 i KDPM-së në lidhje me sigurimin e pranisë së mbrojtësit

Më lart në këtë studim argumentuam për rëndësinë thelbësore që paraqet e drejta e mbrojtës për të miturin në konflikt me ligjin dhe detyrimin pozitiv që shtetit i është vendosur për ta garantuar atë, për shkak të angazhimeve ndërkombëtare (Pakti Ndërkombëtar i OKB-së për të drejtat civile dhe politike (1966), KEDNJ-ja (1950) etj.) dhe legjislacionit të brendshëm (Kushtetuta, KPP-ja, KDPM-ja). Megjithatë, **e drejta e mbrojtjes, përpara se të sigurohet në substancë, duhet t'i paraprijë një procedurë korrekte që garanton praninë e mbrojtësit në çdo veprim procedural ku i mituri duhet të jetë i pranishëm.** Për domosdoshmërinë e pjesëmarrjes së mbrojtësit në

çdo veprim procedural ku i mituri merr pjesë ligji është mjaft i qartë – pika 4 e nenit 48¹³² të KDPM-së – ndërkohë që sanksioni i cili parashikohet nga mospërmbushja e këtij kushti është papërdorshmëria e aktit, sikundër urdhëron pika 5, e nenit 48¹³³ të KDPM-së.

Rëndësia që paraqet e drejta e mbrojtjes për të miturin në konflikt me ligjin dhe garantimi në çdo rast i interesit më të lartë të tij, kërkon që përfaqësuesi ligjor i të miturit, si rregull, të konsultohet edhe me të miturin, për të zgjedhur mbrojtësin e tij. Ky fakt nuk del i shprehur në mënyrë eksplicite në përmbajtjen e nenit 48 § 1¹³⁴ të KDPM-së, por e drejta që i njihet përfaqësuesit të të miturit që **“në mënyrë të pavarur”**, të zgjedhë mbrojtësit, të çon në konkluzionin se ky rast duhet të përbëjë përjashtim nga rregulli, sipas të cilit - **procesi i zgjedhjes së mbrojtësit të të miturit nga përfaqësuesi ligjor i të miturit duhet të bëhet në bashkëveprim me të.**

Natyrisht, në çdo rast që i mituri në konflikt me ligjin mbetet apo nuk ka zgjedhur një mbrojtës, është detyrim i organit procedues që t'i caktojë kryesisht një mbrojtës (pika 2 e nenit 48 të KDPM-së). Ky mbrojtës duhet të jetë i trajnuar posaçërisht për të ofruar shërbime ligjore dhe ndihmë juridike ndaj të miturve në konflikt me ligjin.

Nisur nga rëndësia kushtetuese që paraqet e gjithë veprimtaria që kryen organi procedues në sigurimin e ndihmës juridike ndaj të miturit në konflikt me ligjin, **pika 3 e nenit 48¹³⁵ të KDPM-së kërkon që kjo procedurë të dokumentohet, duke u mbajtur procesverbal për:**

- (i) *kërkesën e të miturit për t'iu caktuar një mbrojtës nga organi që procedon;*
- (ii) *marrjen e dëgjimit të të miturit për mbrojtësin e caktuar;*
- (iii) *dhënien e pëlqimit të të miturit për mbrojtësin e caktuar dhe*
- (iv) *në mungesë të dhënies së këtij pëlqimi nga i mituri, dhënien e pëlqimit nga përfaqësuesi i tij ligjor.*

Nga hulumtimi i bërë nga të gjithë fashikujt e procedimeve penale nuk u konstatua asnjë akt (procesverbal) që të kishte dokumentuar procesin e caktimit të mbrojtësit nga organi proces, në bashkërendim me të miturin dhe/ apo përfaqësuesin e tij ligjor apo personin e besuar. Sjellim në vëmendje që ky është një urdhërim ligjor, ndaj duhen marrë masa për zbatimin e tij në veprimtaritë e organeve proceduese gjatë procesit të caktimit të mbrojtësit kryesisht.

6.5 Marrja në pyetje e të miturve në konflikt me ligjin nga oficerët e Policisë Gjyqësore pa praninë e mbrojtësit apo me “argumentimin” se i mituri nuk kërkon mbrojtës në këtë fazë, si dhe mosdokumentimi i pranisë së mbrojtësit në aktin përkatës ku merr pjesë

Në këtë studim është argumentuar gjerësisht për domosdoshmërinë e pranisë së mbrojtësit gjatë të gjithë procedimit penal kundër të miturit në konflikt me ligjin, pra në çdo veprim procedural ku të miturit marrin pjesë. Edhe pse duhet pohuar se në këtë drejtim nga organe proceduese, gjatë hetimeve paraprake, tregohet kujdes për sigurimin e pranisë së mbrojtësit, përsëri vërehen raste të kryerjes së veprimeve hetimore pa praninë e tyre. Këto raste përbëjnë shkelje të rëndë të procedurës, pasi **aktet që hartohen në mungesë të mbrojtësve vlerësohen si të papërdorshme.**

132 Neni 248 § 4 e KDPM-së ka këtë përmbajtje: **“4. Në çdo rast pjesëmarrja e mbrojtësit është e detyrueshme.”**

133 Pika 5 e nenit 248 të KDPM-së parashikon: **“Thëniet e të miturit të dyshuar, të bëra jo në prani të mbrojtësit, nuk mund të përdoren si provë.”**

134 Kjo dispozitë përcakton: **“1. Përfaqësuesi ligjor i të miturit ka të drejtë të zgjedhë dhe të caktojë, në mënyrë të pavarur, një mbrojtës, duke marrë parasysh interesin më të lartë të të miturit.”**

135 Neni 48 § 3 i KDPM-së parashikon: **“3. Kërkesa për caktimin e mbrojtësit, marrja e dëgjimit të të miturit dhe dhënia e pëlqimit të të miturit dhe, në mungesë të këtij pëlqimi, të përfaqësuesit ligjor ose procedural të të miturit, shënohet në një procesverbal të veçantë. Sipas rastit, procesverbali nënshkruhet prej të miturit ose përfaqësuesit ligjor/procedural të të miturit dhe mbrojtësit.”**

Në vijim po referojmë tre raste të shkeljes së të drejtës së mbrojtjes së të miturve në konflikt me ligjin. Dy raste¹³⁶ lidhen me **marrjen e deklarimeve të të miturve në konflikt me ligjin nga OPGJ-të në mungesë të mbrojtësit të tyre**, edhe pse ishin të dyshuar për kryerjen e veprave penale. Ndërsa rasti i tretë¹³⁷ lidhet me **mungesën e mbrojtësit në procesin e njohjes së të miturit**, në kundërshtim me përcaktimet e vendosura në pikat 3 e 4 të nenit 171 të KPP-së, që parashikojnë respektivisht, praninë e detyrueshme të mbrojtësit dhe sanksionin pasues në rast të kryerjes së kësaj shkelje, pavlefshmërinë e njohjes së kryer.

Një gjetje tjetër e rëndësishme që për fat nuk është e përhapur, pasi është konstatuar vetëm në dy procedime penale¹³⁸ që i përkasin Prokurorisë së Shkodrës, por që është çmuar të evidentohet, për shkak të peshës shumë të madhe që ajo paraqet në cenimin e të drejtës së mbrojtjes së të miturit në konflikt me ligjin, është **pranimi i marrjes së deklarimeve nga OPGJ-të, sipas nenit 296 § 1 të KPP-së dhe nenit 76 të KDPM-së, në mungesë të mbrojtësit, me arsyetimin se i mituri nuk kërkon mbrojtës.**

Edhe pse përpara një situatë normative të qartë, OPGJ-të pranojnë të kryejnë një shkelje flagrante të ligjit, duke i marrë deklarimet e të miturit në mungesë të mbrojtësit, në pajtim me “vullnetin” e të miturit. Ky i fundit, siç kemi argumentuar edhe më herët, nuk ka pjekurinë e duhur dhe aftësitë e nevojshme për të kuptuar natyrën dhe rëndësinë e pranisë së mbrojtësit, sidomos gjatë marrjes në pyetje nga Policia Gjyqësore, ndaj ai nuk mund të vendosë i pavarur nëse do të asistohet nga një avokat.

Për më tepër që **pasja e mbrojtësit gjatë marrjes në pyetje dhe në veprime të tjera procedurale ku i mituri merr pjesë është detyrim ligjor absolut** (neni 48 § 4 i KDPM-së) dhe asnjë subjekt i përfshirë në procedurë nuk mund të heqë dorë nga garantimi me përpikëri i tij. Në të kundërt do të prodhohet një akt procedural i vesuar që do të passjellë papërdorshmëri të tij, sikundër parashikon pika 5 e nenit 48 të KDPM-së.

Marrjen në pyetje pa praninë e mbrojtësit e pretenduan edhe të miturit që gjenden të paraburgosur në Institutin e të Miturve Kavajë. I mituri **F.M.**, i akuzuar nga **Prokuroria e Tiranës** për kryerjen në bashkëpunim të veprës penale të “*Vjedhjes me dhunë*”, mbetur në tentativë, pretendoi se gjatë marrjes në pyetje nga Policia Gjyqësore nuk ishte ndihmuar nga mbrojtësi. Dhënien e deklarimeve në Policinë Gjyqësore jo në praninë e mbrojtësit e pretenduan edhe të miturit **O.Z.** (i akuzuar nga **Prokuroria e Tiranës** për veprën penale “*Vjedhja me dhunë*”, në bashkëpunim) dhe **P.K.** (i akuzuar nga **Prokuroria e Vlorës** për veprën penale të “*Vrasjes me dashje*”, mbetur në tentativë).

Për pasojë, një praktikë e tillë duhet të evitohet, ndaj i bie për detyrë, fillimisht, prokurorëve që, kur iu përcillen nga Policia Gjyqësore deklarime të tilla, t’i deklarojnë të papërdorshme. Më tej dhe kurdoherë edhe gjykatës (gjyqtarit të hetimeve paraprake, gjyqtarit të seancës paraprake dhe gjyqtarit të themelit) për të shpallur këtë papërdorshmëri dhe për t’i përjashtuar ato nga materiali provues (fashikulli i gjykimit) i paraqitur nga prokurori. Ndërkohë, OPGJ-të duhet t’i nënshtrohen trajnimeve vazhduese për njohjen e të drejtave procedurale të personave nën hetim dhe veçanërisht të të drejtave të të miturve në konflikt me ligjin.

136 Shih procedimet penale të Prokurorisë së Shkodrës: **nr. 37/2023**, që i përket të miturit A.G. – deklarimet e këtij të fundit, datë 28.12.2022, f. 51-52 dhe **nr. 44/2023**, që i përket të miturit G.N. – deklarimet e këtij të fundit, datë 27.12.2022, f. 41-42.

137 Procedimi penal **nr. 157/2024** i Prokurorisë së Tiranës, që i përket të miturve E.D., E.Sh. dhe B.D., procesverbali i njohjes së E.D., datë 30.1.2024, f. 164-165.

138 Shih procedimet penale të Prokurorisë së Shkodrës: nr. 192/2023, që i përket të miturit P.M., deklarimet përpara OPGJ-së të P.M, datë 23.2.2023 (f. 25) dhe nr. 140/2023, që i përket të miturit E.B., deklarimet e E.B. përpara OPGJ-së në datë 29.1.2023 (f. 30).

6.6 Marrja në pyetje e të miturit në konflikt me ligjin, të arrestuar në flagrancë apo të ndaluar, nga oficeri i Policisë Gjyqësore në shkellje të normave të Kodit të Procedurës Penale që një veprim të tillë ia ngarkon ekskluzivisht prokurorit

Besojmë se një nga të metat më me impakt në studimin e zhvilluar është **shkelja e nenit 256¹³⁹ të KPP-së, që ngarkon prokurorin për të operuar me pyetjen e personit të dyshuar si autor i kryerjes së një veprë penale, në rast se ai arrestohet në flagrancë apo ndalohet**. Sipas paragrafit të parë të këtij neni, prokurori është autoriteti i vetëm për të marrë në pyetje të arrestuarit ose të ndaluarin, pasi sigurohet që personi i arrestuar/ndaluar ka të pranishëm mbrojtësin e zgjedhur dhe i cakton një të tillë kur kjo zgjedhje nuk është bërë apo mbrojtësi i zgjedhur nuk është paraqitur. Përpara se të fillojë me pyetjen, prokurori e vë në dijeni të arrestuarin/ndaluarin për faktin për të cilin procedohet dhe i tregon arsyet e marrjes në pyetje. Më pas, prokurori i tregon të arrestuarit/ndaluarit të dhënat që janë mbledhur për të deri në këtë fazë të procedimit dhe, nëse prokurori çmon se nuk kompromentohen, edhe burimin e provave.

Pasi kryen këto veprime, prokurori, në vështrim të parashikimeve të pikës së dytë të nenit 256 të KPP-së, e pyet të arrestuarin ose të ndaluarin nëse e ka marrë letrën e të drejtave dhe nëse ky fakt nuk ka ndodhur ia jep letrën e të drejtave përpara marrjes së parë në pyetje dhe i sqaron të drejtat e tij. Paragrafi i tretë tregon sanksionin që pëson kjo provë nëse nuk respektohet procedura e përcaktuar në përmbajtjen e këtij neni – deklarimet e bëra nga i arrestuari ose i ndaluar përpara se të ketë marrë letrën e të drejtave ose përpara takimit me mbrojtësin e tij, nuk mund të përdoren.

Siç rezulton, përmbajtja e normës së **nenit 256 të KPP-së** është mjaft e qartë dhe nuk paraqet nevojë për interpretim. **Ajo ndalon çdo autoritet tjetër, përveç prokurorit të çështjes, që të marrë në pyetje një person të ndaluar apo të arrestuar në flagrancë**. Për rrjedhojë, **çdo marrje në pyetje nga OPGJ-të e bën këtë provë të paligjshme dhe, për pasojë, të papërdorshme**.

Por çfarë ndodh në praktikë? Nga verifikimi i procedimeve penale në kuadër të këtij studimi vërejmë se, ky detyrim i sanksionuar qartë në ligjin procedural nuk zbatohet thuajse asnjëherë. **Në vetëm një prej procedimeve të konsultuara, i mituri në konflikt me ligjin i arrestuar në flagrancë për veprën penale të vrasjes me dashje është marrë në pyetje nga prokurori¹⁴⁰**. Të miturit në të gjitha rastet e tjera të studiuara janë marrë në pyetje nga OPGJ-të të cilët, duke e kuptuar dhe zbatuar gabim ligjin procedural dhe pa e pasur këtë atribut, kanë operuar me pyetjen e të arrestuarve/ndaluarve, duke menduar se po zbatojnë fjalinë e parë të nenit 296 § 1 të KPP-së, që parashikon: *"1. Oficerët e policisë gjyqësore marrin të dhëna nga personi ndaj të cilit zhvillohen hetimet në praninë e detyrueshme të mbrojtësit të tij, me përjashtim të rasteve të personit të arrestuar në flagrancë ose të ndaluar, të cilët merren në pyetje sipas rregullave të nenit 256. ..."*

Sikundër e përcakton vetë përmbajtja e fjalisë së parë të nenit 296 § 1 të KPP-së, **e drejta e OPGJ-ve për të marrë në pyetje personat ndaj të cilëve zhvillohen hetime lind vetëm kur nuk janë rastet e nenit 256 të KPP-së**, pra vetëm atëherë kur personi që do të pyetet nuk është ndërkohë i arrestuar apo i ndaluar. **Ky është i vetmi rast kur marrja në pyetje i është njohur ekskluzivisht prokurorit, e drejtë kjo që nuk është e delegueshme te Policia Gjyqësore**.

139 Neni 256 bën këtë përcaktim:

"1. Prokurori merr në pyetje të arrestuarit ose të ndaluarin në prani të mbrojtësit të zgjedhur ose të caktuar kryesisht. Ai i njofton të arrestuarin ose të ndaluarin faktin për të cilin procedohet dhe arsyet e marrjes në pyetje, duke i treguar të dhënat në ngarkim të tij dhe, kur nuk i shkaktohet dëm hetimeve, edhe burimet.

2. Prokurori fillimisht e pyet të arrestuarin ose të ndaluarin nëse e ka marrë letrën e të drejtave dhe sigurohet që ai i ka kuptuar të drejtat e tij. Kur i arrestuari ose i ndaluar nuk e ka marrë letrën e të drejtave, prokurori ia jep atë përpara marrjes së parë në pyetje dhe i sqaron të drejtat e tij.

3. Deklarimet e bëra nga i arrestuari ose i ndaluar përpara se të ketë marrë letrën e të drejtave ose përpara takimit me mbrojtësin e tij, nuk mund të përdoren."

140 Procedimi penal nr. **903/2020 i Prokurorisë së Vlorës**, në ngarkim të të miturve në konflikt me ligjin, G.T., Q.P., Xh.Z., R.T. dhe A.G., ku i mituri **G.T.** u pyet nga prokurori ditën e arrestimit në flagrancë, më 19.6.2020 (f. 43-45).

Në vijim, **po evidentojmë procedimet penale ku ky detyrim ligjor nuk është mbajtur në konsideratë nga OPGJ-të dhe që, në asnjë rast, nuk janë deklaruar të papërdorshme nga prokurori, por edhe nga gjykata** (për këtë të fundit i referohemi vetëm atyre rasteve ku ka qenë e mundur njohja me vendimin gjyqësor të gjykatës së shkallës së parë).

- (i) procedimi penal **nr. 3374/2019, i Prokurorisë së Tiranës**, në ngarkim të të miturit në konflikt me ligjin, **E.M.**, i akuzuar për kryerjen e krimit të *"Vjedhjes me dhunë"*, në të cilin i mituri u pyet nga OPGJ-ja ditën e arrestimit në flagrancë, më 26.4.2019 (f. 15-16);
- (ii) procedimi penal **nr. 903/2020, i Prokurorisë së Vlorës**, në ngarkim të të miturve në konflikt me ligjin, **G.T., Q.P., Xh.Z., R.T. dhe A.G.**, të akuzuar, G.T dhe A.G. për *"Vrasje me dashje"* në bashkëpunim dhe të tjerët për *"Moskallëzim krimi"*, në të cilin i mituri G.T. u pyet nga OPGJ-ja ditën e arrestimit në flagrancë, më 19.6.2020 (f. 43-44);
- (iii) procedimi penal **nr. 6711/2021, i Prokurorisë së Tiranës**, në ngarkim të të miturit në konflikt me ligjin, **R.V.**, i akuzuar për kryerjen e veprës penale të *"Vrasjes me dashje kundër dy ose më shumë personave"*, mbetur në tentativë, ku rezulton se ai u pyet ditën e arrestimit në flagrancë nga OPGJ, më 23.9.2021, (f. 62);
- (iv) procedimi penal **nr. 501/2022, i Prokurorisë së Durrësit**, në ngarkim të të miturit në konflikt me ligjin, **M.M.**, i akuzuar se ka kryer krimin e *"Plagosjes së rëndë me dashje"*, ku ai u pyet nga OPGJ-ja ditën e arrestimit në flagrancë, më 18.3.2022, (f. 36-37);
- (v) procedimi penal **nr. 338/2023, i Prokurorisë së Shkodrës**, në ngarkim të të miturit në konflikt me ligjin, **A.H.**, i akuzuar se ka kryer veprën penale të *"Plagosjes së rëndë me dashje"*, ku rezulton se, ai u pyet nga OPGJ-ja më 7.4.2023, ndërkohë që ishte i arrestuar në flagrancë më 7.4.2023 (f. 151-152);
- (vi) procedimi penal **nr. 321/2024, i Prokurorisë së Tiranës**, në ngarkim të të miturit në konflikt me ligjin, **S.K.**, i akuzuar se ka kryer në bashkëpunim krimin e *"Trafikimit të lëndëve narkotike"*, ku ai u pyet nga OPGJ-ja ditën e arrestimit në flagrancë, më 13.1.2024, (f. 109);
- (vii) procedimi penal **nr. 157/2024, i Prokurorisë së Tiranës**, në ngarkim të të miturve në konflikt me ligjin, **E.D., E.Sh. dhe B.D.** të akuzuar për kryerjen e veprës penale të *"Vjedhjes me dhunë"*, ku rezulton se ata u pyetën ditën e arrestimit në flagrancë nga OPGJ-ja, më 5.1.2024 (f. 20-12, f. 27-28 dhe f. 35-36);
- (viii) procedimi penal **nr. 14/2024, i Prokurorisë së Vlorës, në ngarkim të të miturve në konflikt me ligjin, A.H., P.K. e K.K.**, të akuzuar për kryerjen e veprës penale të *"Vjedhjes me dhunë"*, në bashkëpunim, ku rezulton se ata u pyetën nga OPGJ-ja, ditën e arrestimit në flagrancë të tyre, më 7.1.2024 (f. 47-48, 49-50 dhe 51-52); dhe
- (ix) procedimi penal **nr. 836/2024, i Prokurorisë së Vlorës**, në ngarkim të të miturit në konflikt me ligjin, **I.H.**, i akuzuar se ka kryer veprën penale të *"Plagosjes së rëndë në kushtet e tronditjes psikike"*, ku rezulton se, ai u pyet nga OPGJ-ja më 28.7.2024, ndërkohë që ishte i arrestuar në flagrancë më 27.7.2024 (f. 154-155);

6.7 Lejimi i deklarimeve të të miturve që tregojnë vetëpërgjegjësi dhe moskryerja e veprimeve të detyrueshme në dispozitat e KPP-së për deklarimin si të papërdorshme të tyre

Kodi ynë i Procedurës Penale, në garantim të së drejtës së individit për të heshtur dhe për të moskontribuar në prodhimin e provave që mund ta fajësojnë (të trajtuar më lart në këtë studim), ka parashikuar në nenin 37¹⁴¹ të tij mbrojtjen e personit që thërret si dëshmitar në gjykim apo si person që deklaron rrethana të dobishme për qëllime të hetimit paraprak, **për të mos iu përdorur të dhënat që ai mund të deponojë përpara organit procedues dhe që, me gjasë, mund t'i shërbejnë akuzës, së bashku me elementë të tjerë, si prova fajësie ndaj tij.**

141 Neni 37 ka këtë përmbajtje: *"Kur para autoritetit procedues një person, që nuk është marrë si i pandehur, bën deklarime, nga të cilat dalin të dhëna për inkriminim në ngarkim të tij, autoriteti procedues ndërpret pyetjen, duke e paralajmëruar se pas këtyre deklarimeve mund të zhvillohen hetime ndaj tij dhe e fton të caktojë një mbrojtës. Deklarimet e mëparshme nuk mund të shfrytëzohen kundër personit që i ka bërë."*

Për këtë qëllim neni 37 ka parashikuar se, nëse dëshmitari apo deklaruesi, gjatë deponimit të tij tregon elementë që mund ta inkriminojnë atë, organi që procedon: së pari: ia ndërpret pyetjen menjëherë dhe jo kur ai ka rrëfyer gjithçka që e implikon atë në një veprimtari kriminale; së dyti: e vë në dijeni se në vijim mund të kryhen hetime ndaj tij dhe i njofton të drejtën që të zgjedhë një mbrojtës. Si rregull, pyetja e tij vijon më pas, në praninë e mbrojtësit, por tashmë me një status të ndryshuar, si person nën hetim. Zgjedhja e mbrojtësit i shërben personit që të ndërtojë linjën e mbrojtjes dhe të çmojë nëse do të deklarojë për sa do të pyetet nga organi procedues apo do të zgjedhë të heshtë dhe, së treti: në garantim të së drejtës së personit të pyetur për të mosofruar prova inkriminuese që mund ta fajësojnë atë, pjesa e fundit e normës së nenit 37 të KPP-së parashikon edhe sanksionin kundër deklarimeve/thënieve të mëparshme vetëfajësuese – ndalimin e përdorimit (papërdorshmërinë) të tyre kundër personit që i ka bërë.

Nga studimi i fashikujve të procedimeve penale ka rezultuar se, në të shumtën e rasteve, Policia Gjyqësore, kryesisht në veprat penale me vendngjarje, si vrasje, plagosje, marrëdhënie seksuale me dhunë, dhunë në familje apo kur arreston persona në kushtet e flagrancës, si mbajtje pa leje të armëve të zjarrit, armëve të ftohta etj., në funksion të dokumentimit dhe mbledhjes së të dhënave për të rindërtuar faktin kriminal dhe autorët e dyshuar, pyet në cilësinë e personave që mund të tregojnë rrethana të dobishme për qëllimet e hetimit, edhe persona për të cilët, ndërkohë, janë mbledhur të dhëna dhe informacione të mjaftueshme që ata mund të jenë autorët e dyshuar.

Në këto kushte, në vend që personat të pyeten në cilësinë e personit ndaj të cilit zhvillohen hetime (neni 296 § 1 i KPP-së), kundrejt garancive që ky status iu njeh (të drejtën për të pasur avokat, të drejtën për të heshtur, të drejtën për të mos iu përgjigjur disa prej pyetjeve të organit procedues etj.) ata pyeten në cilësinë e deklaruesit (pika 1 e nenit 297¹⁴² të KPP-së) pa gëzuar ndihmën e mbrojtësit dhe nën kërcënimin e dënimit në zbatim të neneve 305/a, 305/b dhe 306 të Kodit Penal, (që parashikojnë dënimin e personit që bën deklarime të rreme përkatësit përpara prokurorit, OPGJ-së dhe gjykatës), sipas paralajmërimit që iu bëhet, nëse tregojnë të dhëna të rreme, në referim të nenit 165¹⁴³ i KPP-së.

Kjo praktikë e gabuar e ndjekur në hapat e para të hetimit paraprak, kur Policia Gjyqësore vepron me iniciativë dhe ende nuk është vënë nën drejtimin dhe kontrollin e organit të prokurorisë, **ka sjellë në jo pak raste nga ato të studiuar, që personat të cilët pyeten me cilësinë e deklaruesit - pra jo si autorë të dyshuar - të pohojnë të dhëna në të cilat ata implikojnë veten si autorë të veprave penale.**

Edhe kur personat deklarojnë të dhëna vetëfajësuese, **OPGJ-të shumë rrallë ndërhyjnë për të zbatuar urdhërimet që dikton neni 37 i KPP-së, por edhe kur vendosin të ndërhyjnë, atë e bëjnë në fund të deklarimeve**¹⁴⁴, pasi deklaruesi ka "rrëfyer" në mënyrë shteruese për faktet që e implikojnë atë, por edhe për bashkëpunëtorët eventuale. Kjo mënyrë e zbatimit të kësaj dispozite është e papranueshme, për të mos thënë e paligjshme. Arrijmë në këtë përfundim, në interpretim teleologjik të kësaj norme, ku shprehja "**autoriteti procedues e ndërpret pyetjen**", duhet kuptuar si **ndërhyrje e tij, sapo personi që po deponon fillon të tregojë rrethana që e implikojnë atë në kryerjen e një veprë penale**, të njëjtë apo të ndryshme nga ajo që po hetohet a gjykohet në atë procedim.

Mosndërhyrja në kohë apo me keq "ndërhyrja" në fund të deklarimeve nuk përputhet me kuptimin dhe qëllimin e nenit 37 të KPP-së, që synon të mos i japë avantazhe të pamerituara organit të ndjekjes penale, në dëm të parimeve të procesit të rregullt gjyqësor, të marrë në mbrojtje nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së dhe **sidomos të së drejtës për të mosprodhuar prova që mund ta fajësojnë personin**. Kjo e drejtë merr

142 Neni 297 § 1 i KPP-së përcakton: "*Policia gjyqësore merr të dhëna nga personat që mund të tregojnë rrethana të dobishme për qëllimet e hetimit.*"

143 Neni 165 pikat 1 & 2 i KPP-së bën këtë përcaktim: "*1. Kur gjatë pyetjes dëshmitari bën thënie kontradiktore, jo të plota ose që janë në kundërshtim me provat e marra, gjykata ia vë në dukje duke e paralajmëruar për përgjegjësinë penale për dëshmi të rreme. 2. Të njëjtin paralajmërim gjykata i bën edhe dëshmitarit që refuzon të dëshmojë. Kur dëshmitari ngul këmbë në mospranimin për të dëshmuar, gjykata i kërkon prokurorit që të procedojë sipas ligjit.*"

144 Shih procedimin penal nr. **14/2024 të Prokurorisë së Vlorës**, në ngarkim të të miturve në konflikt me ligjin, **A.H., P.K. e K.K.**- ku, sipas përmbajtje së tre "*Procesverbaleve për marrjen e të dhënave nga personi që ka dijeni për veprën penale*", të datës 7.1.2024, ku deklarues kanë qenë respektivisht: i mituri **P.K.** (f. 47-48), i mituri **K.K.** (f. 49-50) dhe i mituri **A.H.** (f. 51-52), ndërprerja e pyetjeve të tyre është bërë kur ata kishin treguar gjithçka për veprën penale për të cilin ishin ndërkohë të dyshuar.

peshë më të madhe kur personi që i bën këto deklaratime është i mitur, i cili për shkak të mungesës së aftësisë dhe pjekurisë mund të deklarojë edhe rrethana implikuese jo plotësisht të vërteta. Për rrjedhojë, **organet proceduese, prokurori¹⁴⁵ dhe gjykata** duhet të zbatojnë me rigorozitet pikën 3 të nenit 151 të KPP-së, që urdhëron: “3. **Provati e marra në shkelje të ndalimeve të parashikuara nga ligji nuk mund të përdoren. Papërdorshmëria e provave ngrihet edhe kryesisht në çdo gjendje dhe shkallë të procedimit**”, duke i deklaruar në çdo rast si të papërdorshme deklaratimet që merren në kundërshtim me përcaktimet e nenit 37 të KPP-së.

Moskryerja e detyrave si më lart nga organet proceduese, mund ta ekspozojnë deklaruesin vetëfajësues përballë një procesi penal të cenushtëm nga shkelja thelbësore e ligjit procedural penal (nenit 37 të lexuar së bashku me nenin 151 § 3). Duke mos u deklaruar si të papërdorshme këto deklaratime vetëimplikuese të deklaruesve, mbeten jo vetëm në fashikullin e prokurorit, por bëhen edhe pjesë e fashikullit të gjykimit (neni 331/ë të KPP-së), për shkak të pranimit të kërkesës për gjykim të shkurtuar (neni 403 i KPP-së), rit që zbatohet masivisht në praktikën gjyqësore shqiptare. **Deklarime të tilla, duke mbetur pjesë e materialit provues në dispozicion të gjyqtarit natyror, individit rrezikon të deklarohet fajtor mbi të dhëna fajësie të mbledhura në mënyrë të paligjshme**, çka do të sillte edhe shkelje të këtij parimi të rëndësishëm të Kushtetutës sonë, të sanksionuar në paragrafin e dytë të nenit 32¹⁴⁶ të saj.

Përpara se të tregojmë procedimet penale ku neni 37 i KPP-së nuk është zbatuar, e çmojmë të rëndësishme të vëmë në dukje se, për fat të keq, në asnjë rast gjyqësor të hulumtuar dhe që lidhet me procedimet penale ku u konstatuan këto papërdorshmëri të deklaratimeve të dhëna përpara OPGJ-së, gjyqtari i seancës paraprake nuk e konstatoi këtë papërdorshmëri, duke u shmangur nga detyrimi i tyre që buron nga pika 3 e nenit 151 të KPP-së.

Më poshtë po pasqyrojmë shkeljet e vërejtura në **procedimet penale** ku janë konstatuar **procesverbale deklarimesh** të personave që tregojnë rrethana të dobishme për qëllime të hetimit, **të marra në kundërshtim me kërkesat e nenit 37 të KPP-së dhe që nuk janë deklaruar si të papërdorshme nga prokuroritë respektive**, edhe pse shkelja ka qenë e dukshme:

(i) Procedimi penal nr. 903/2020 i Prokurorisë së Vlorës, në ngarkim të të miturve në konflikt me ligjin, G.T., Q.P., Xh.Z., R.T. dhe A.G.

Në *Procesverbalin për deklaratimet nga persona që kanë dijeni për rrethanat e hetimit, të datës 19.6.2020*, të dhëna nga i mituri **R.T.** (f. 64-66), tregohen të dhëna vetëfajësuese prej tij, pasi ai pranoi se, kishte parë që shoku i tij, i mituri **G.T.**, mbante një thikë me vete teksa shkonin për t’u “sqaruar” me të miturin **K.P.**, dhe më pas ishte i pranishëm kur viktimia **A.P.** u vra nga bashkëveprimet e **G.T.** dhe **A.G.**, dhe nuk i kallëzoi këto veprime, sikundër kërkon neni 300 § 1 i Kodit Penal. Organi procedues nuk veprroi në zbatim të nenit 37 të KPP-së për të ndërprerë këto deklaratime dhe për të vijuar hetimin nga **R.T.** për veprën penale të cituar më lart. Jo vetëm kaq, por këto deklaratime nuk u deklaruan të papërdorshme, në zbatim të fjalisë së fundit të nenit të mësipërm.

Në të njëjtën linjë paligjshmërie, Policia Gjyqësore veprroi edhe gjatë marrjes së deklaratimeve të të miturit **A.G.**, dokumentuar nëpërmjet *Procesverbalit për deklaratimet nga persona që kanë dijeni për rrethanat e hetimit, të datës 19.6.2020*, (f. 69-70), ku ky i mitur tregoi të dhëna që e vetimplikonin si bashkëpunëtor me **G.T.** në kryerjen e veprës penale të “Vrasjes me dashje”, të viktimës **A.P.** As në këtë rast OPGJ-ja, nuk zbatoi kërkesat e nenit 37 të KPP-së, sikundër u shprehëm më lart.

¹⁴⁵ Në fashikujt hetimorë të qëmtuar për qëllime të këtij studimi u konstatua vetëm një rast i zbatimit të nenit 151 § 3, në lidhje me nenin 37 të KPP-së, që i përket **Prokurorisë së Elbasanit**, procedimi penal nr. **1227/2023**, në ngarkim të të miturit në konflikt me ligjin, **F.Z.**, ku prokurori, me vendimin e datës 18.10.2023 (f. 122) vendosi të deklarojë të papërdorshëm procesverbalin e deklaratimeve të dhëna nga i mituri në datë 11.10.2023 (f. 121), për shkak të shkeljes së nenit 37 të KPP-së (tregimi i të dhënave që tregojnë vetëpërgjegjësi) dhe konfliktit të interesit ndërmjet të miturit dhe të atit të tij, **L.Z.**, pasi të dy ishin autorë të dyshuar të kryerjes së veprës penale “Dhuna në familje”, të kryer reciprokisht ndaj njëri-tjetrit (neni 74 § 1 (c) i KDPM-së).

¹⁴⁶ Neni 32 § 2 i Kushtetutës lexon: “2. *Askush nuk mund të deklarohet fajtor mbi bazën e të dhënave të mbledhura në mënyrë të paligjshme*”

(ii) Procedimi penal nr. 446/2023, i Prokurorisë së Shkodrës, në ngarkim të të miturit në konflikt me ligjin, A.K.

I mituri A.K. është pyetur për një sasi bimësh narkotike të gjendur në 80 kubikë në afërsi të shtëpisë së tij në lagjen "Gjuraj", të fshatit Koplík i Sipërm, bashkia Malësi e Madhe. Në *Procesverbalin për marrjen e të dhënave nga personi që ka dijeni për veprën penale*, datë 29.4.2023 (f. 167) ky i mitur pranoi se i ka blerë me qëllim kultivimin e tyre, sikundër kishte blerë edhe pajisjet që do t'i shërbenin për këtë synim. Edhe në këtë rast Policia Gjyqësore nuk ka ndërmarrë asnjë prej veprimeve që parashikon dispozita e nenit 37 të KPP-së.

(iii) Procedimi penal nr. 796/2023, i Prokurorisë së Vlorës, në ngarkim të të miturit në konflikt me ligjin, F.K.

Sipas të dhënave që njofton *Procesverbalin për marrjen e të dhënave nga personi që ka dijeni për veprën penale*, i mituri, **F.K.**, datë 31.5.2023 (f. 73-74), vërtetohet se ky i mitur është pyetur si deklarues që ka dijeni për një fakt penal të ndodhur dhe jo si autor i dyshuar i saj, edhe pse Policia Gjyqësore kishte dijeni për faktet penale të atribuara këtij të mituri, pasi ndërkohë i kishte sekuestruar në kushtet e flagrancës (pas kontrollit fizik) një armë të dyshuar si të ftohtë (dorezë metalike) dhe se me të kishte goditur mësuesin e tij të matematikës Ar.O. dhe djalin e tij Al.O. Gjatë pyetjeve direkte të bëra, ku i kërkoheshin shpjegime në lidhje me sherrin e ndodhur dhe mjetin e përdorur, i mituri F.K. tregoi me hollësi përfshirjen e tij në konfliktin e dhunshëm, motivet që e shtynë dhe mjetin që përdori.

(iv) Procedimi penal nr. 2578/2024, i Prokurorisë së Tiranës, në ngarkim të të miturve në konflikt me ligjin A.G., T.Ç., dhe Xh.M.

Në *procesverbalin për marrjen e të dhënave nga personi që ka dijeni për veprën penale*, i mituri **A.G.**, të datës 17.2.2025 (f. 31-32), ai u pyetet nga Policia Gjyqësore për një rast të vjedhjes me dhunë të viktimës G.P., nga tre të rinj, një ditë më parë. OPGJ-ja nuk shpjegoi në procesverbal se, cila ishte arsyeja që ai mendonte se A.G.-ja do të mund të tregonte rrethana të dobishme për qëllime të hetimit të nisur mbi kallëzimin e viktimës. Ai u pyet nga OPGJ-ja se: "*Çfarë mund të na thoni rreth kësaj situatë?*" Pas kësaj pyetje të përgjithshme dhe që nuk synonte të merrte dijeni për sjelljen e të miturit, ky i fundit tregoi të gjithë faktin penal të ndodhur (vjedhjen me dhunë të viktimës), rolin e tij në të (si ndihmës) dhe veprimet e bashkëpunëtorëve të tjerë (komunikimet në Instagram nga Xh.M. dhe kërcënimin me thikë të viktimës nga T.Ç.). Edhe pse i ndodhur përpara deklarimeve vetëfajësuese, OPGJ-ja nuk vendosi të ndërpresë pyetjen e mëtejshme të tij dhe të zbatonte veprimet e tjera që përcakton neni 37 i KPP-së, por vijoi me pyetje për të thelluar marrjen e dijenisë për faktin kriminal, duke e pyetur të miturin A.G. për personit që i kishte marrë lekët që i vodhën me dhunë viktimës dhe për personin që administronte faqen e Instagramit nga e cila ata kishin mashtruar viktimën për të ardhur në vendin ku ndodhi vjedhja e tij me dhunë.

Në të njëjtën mënyrë veproi Policia Gjyqësore edhe gjatë marrjes së *deklarimeve të personit që tregon rrethana për hetimin*, të miturit **Xh.M.**, në datë 17.2.2024 (f. 35-36). Sërisht atij iu bë me dije ngjarja e ndodhur më 16.2.2024 dhe u pyet se çfarë kishte për të thënë për të. Edhe i mituri Xh.M., pranoi përfshirjen në ngjarje, tregoi për veprimet dhe rolin e tij, si dhe të bashkëpunëtorëve, që përdorën një thikë dhe një zinxhir që të detyronin viktimën të jepte paratë që kishte me vete (4,000 lekë). As në këtë rast OPGJ-ja nuk veproi me ndërprerjen e pyetjeve, edhe pse deklaratimet vetimplikuese të tij ishin evidente, por vijoi me pyetjet, duke i kërkuar të dijë se cili prej bashkëpunëtorëve e administronte faqen në Instagram, me të cilin kishin mashtruar viktimën (sikur po shkonte të kryente kundrejt pagesës marrëdhënie seksuale me një vajzë me të cilën kishte komunikuar në këtë rrjet social) të paraqitej në vendin e caktuar prej tyre.

(v) Procedimi penal nr. 2578/2024, i Prokurorisë së Fierit, në ngarkim të të miturve në konflikt me ligjin E.P. dhe R.R. –

Në *Procesverbalin për intervistimin e të miturit në konflikt me ligjin*, të datës 24.1.2024, ora 15:16, të dhëna nga të miturit në konflikt me ligjin, **E.P.** (f. 39-40), ky i fundit, edhe pse i pyetur si deklarues dhe jo si personi që i atribuohet vepra penale, fakt i njohur nga deklaratimet e viktimës M.M. dhe kallëzimi i nënës së tij, E.M., tregoi se ia kishte

marrë celularin bashkëmoshatarit të tij, M.M., dhe se bashku më të miturin tjetër, R.R., e kishin shitur te një person i paidentifikuar për shumën prej 750 euro, duke përfutur shumën takuese prej 350 euro. Ashtu siç ndodhi edhe në rastet e tjera, OPGJ-ja, jo vetëm nuk e ndërpreu pyetjen e E.P., por vijoi ta pyeste të miturin për rrethanat e kryerjes së faktit penal, motivet e tij, personat e tjerë të përfshirë, shumën e përfutur nga shitja e sendit të vjedhur dhe personin konkret që ishte blerësi i celularit.

Të njëjtat shkelje janë vërejtur edhe gjatë marrjes së *deklarimeve të të miturit R.R.*, në datë 24.1.2024, ora 14:50 (f. 31-32), ku gjatë pyetjes si deklarues, i mituri tregoi të dhëna vetëfajësuese, duke pranuar që i kishte marrë celularin viktimës M.M. dhe nuk ia kishte kthyer më, pasi ia kishte dhënë bashkëpunëtorit të tij R.P., i cili e kishte shitur te një person i paidentifikuar dhe vlerën e kishin ndarë me njëri-tjetrin.

6.8 Mospjesëmarrja apo mosdokumentimi në procesverbalin përkatës të pranisë së prindit apo psikologut gjatë kryerjes së veprimeve procedurale me te miturin në konflikt me ligji

Pjesë e drejtësisë miqësore për të miturit në konflikt me ligjin është edhe sigurimi nga organi procedues i pranisë së prindit apo personit të besuar, kurdoherë që i mituri e kërkon këtë gjë. Sikundër e kemi trajtuar këtë aspekt edhe në pjesën e analizës së të drejtave procedurale të të miturit, prania e prindit apo personit të besuar nuk është e detyrueshme, nëse i mituri nuk kërkon që ai të jetë i pranishëm gjatë marrjes në pyetje. E thënë me fjalë të tjera, **të miturit i bëhet me dije nga organi procedues për të drejtën që ka për të pasur të pranishëm prindin/personin e besuar, por nëse i mituri, pasi pyetet shprehimisht për këtë të drejtë, refuzon të asistohet gjatë pyetjes nga përfaqësuesi ligjor/personi i besuar, këta të fundit nuk marrin pjesë.** Këtu nuk duhet të ngatërrojmë të drejtën e të miturit për të pasur të pranishëm gjatë përbaljes me organin procedues të prindit/personit të besuar, me detyrimin që ka ky organ për t'i lajmëruar ata në çdo rast për t'u paraqitur përpara kryerjes së veprimeve procedurale ku merr pjesë i mituri.

Nga shqyrtimi i procedimeve penale në funksion të këtij studimi, rezultoi se, **respektimi i kësaj të drejte të të miturit në konflikt me ligjin, e sanksionuar nga fjalia e fundit e pikës 5 të nenit 76 të KDPM-së, për fat të keq, nuk është zbatuar, fakt që rezulton nga këqyrja e të gjithë procesverbaleve të deklarimeve të tyre.** Gjithsesi, duke mos qenë përpara rasteve të refuzimit të shprehur të të miturit për të pasur të pranishëm prindin/personin e besuar është prezumuar fakti që ata kanë dëshiruar praninë e tyre.

Kujtojmë këtu se, **prania e prindit/personit të besuar synon të sigurojë që i mituri të mos përballet i vetëm me autoritetet proceduese, të ketë mbështetje emocionale dhe morale gjatë gjithë procedurës, për të shmangur pasigurinë dhe frikën.** Nëpërmjet pranisë së tyre garantohet që i mituri: (i) nuk i nënshtrohet presioneve apo shtrëngimeve për të pohuar fajësinë, (ii) pyetet në një gjuhë të kuptueshme dhe me një ton të qetë, (iii) e kupton natyrën e pyetjeve që i bëhen, përfshi të drejtën për të mos u vetëinkriminuar, si dhe (iv) i ka të qarta pasojat e veprimeve procedurale.

Gjithashtu, duhet rievidentuar se, **prania e psikologut gjatë gjithë procedurës që zhvillohet kundër të miturit në konflikt me ligjin është e domosdoshme,** sepse ky i fundit nuk ka kapacitetet e duhura për të kuptuar procesin dhe pasojat që ai sjell, për shkak të moshës, pjekurisë mendore dhe emocionale. Pjesëmarrja e psikologut në pyetjen e të miturit bëhet edhe më e domosdoshme, sikundër e ka parashikuar legjislatori në pikën 4 të nenit 76 të KDPM-së, ku prania e tij e ndihmon organin procedues të konsultojë *"paraprakisht me psikologun përmbajtjen e pyetjeve që do t'i drejtohen të miturit"*, me synim që të miturit t'i sigurohet *"pyetja në mënyrën e duhur, lehtësimi i dhënies së dëshmisë, eliminimi i frikësimit ose ndrojtjes nga procesi"*.

Për pasojë, edhe nën dritën e asaj që u argumentua më lart, **psikologu kontribuon që organet proceduese: (i) të përdorin një gjuhë sa më miqësore me të miturin, (ii) të shmangin ashpërsinë, vrazhdësinë dhe tonin e lartë në**

pyetje, (iii) të mos bëjnë pyetje të vështira për t'u kuptuar, si dhe (iv) në tërësi, të garantojnë që veprimet procedurale ku i mituri merr pjesë të kryhen në një mjedis mirëqenie emocionale dhe psikologjike për të.

Në këtë pikë duhet vënë në dukje sërish se, **mosgarantimi i ndihmës psikologjike dhe asaj ligjore** gjatë procedimit penal, krahas pjesëmarrjes së përfaqësuesit ligjor (prind/kujdestar) apo person i besuar, kur pjesëmarrja e këtij të fundit kërkohet nga i mituri, **shkakton paligjshmëri të provës së marrë në mungesë të psikologut/avokatit/përfaqësuesit ligjor**, duke sjellë për pasojë, **papërdorshmëri të provës**, në kuptim të nenit 49 të KDPM-së të titulluar **"Prania e detyrueshme në veprimet procedurale me të miturit"**, ku në fjalinë e parë të pikës së parë të tij sanksionohet se: **"1. Çdo veprim procedural i kryer në lidhje me të miturin bëhet në prani të mbrojtësit, përfaqësuesit ligjor dhe psikologut."**

Nga këqyrja e fashikujve të procedimeve penale, si dhe nga intervistimi i të miturve në Institutin e të Miturve Kavajë, ka rezultuar se, në përgjithësi, është kuptuar roli dhe rëndësia e pranisë së prindit dhe psikologut gjatë marrjes në pyetje të të miturit në konflikt me ligjin, si dhe në veprime të tjera hetimore ku ata marrin pjesë. Megjithatë, **janë vërejtur edhe raste ku veprime procedurale janë realizuar nga organet proceduese pa praninë e prindit apo psikologut, si dhe kur prania e tyre gjatë kryerjes së këtyre veprimeve ka mbetur e dyshimtë**, për shkak të mos përmendjes së tyre në procesverbalet që kanë dokumentuar këtë veprimtari, edhe pse ata nënshkruajnë në procesverbal.

- **Në procedimet e mëposhtme është konstatuar mosmarrja pjesë e prindit dhe/apo psikologut:**

- a) në procedimin penal **nr. 3374/2019, të Prokurorisë së Tiranës**, në ngarkim të të miturit në konflikt me ligjin, **E.M.**, deklarimet e tij të datës 16.7.2019 janë marrë **në mungesë të psikologut**, ndërkohë që ka dyshime edhe për pjesëmarrësit e tjerë që nuk përmenden në procesverbal, edhe pse nënshkruajnë në fund të tij - prindi dhe avokati (f. 64);
- b) në procedimin penal **nr. 903/2020, të Prokurorisë së Vlorës**, në ngarkim të të miturve në konflikt me ligjin, **G.T., Q.P., Xh.Z., R.T. dhe A.G.**, u vërejt se: në vendimin për njoftimin e akuzës për **G.T.**, datë 15.4.2021, **nuk ka qenë i pranishëm prindi** (f. 29); në vendimin për plotësimin e akuzës për **A.G.** **nuk kanë qenë të pranishëm prindi dhe psikologu** (f. 42); në procesverbalin e pyetjes së **A.G.**, datë 19.6.2020, **ka munguar prindi i tij** (f. 69); në procesverbalet për pyetjen si të pandehur, datë 19.3.2021, të të miturve **A.G., Xh.Z. dhe R.T.**, **mungonte sërish prindi i tyre**.
- c) në procedimin penal **nr. 6711/2021, të Prokurorisë së Tiranës**, në ngarkim të të miturit në konflikt me ligjin, **R.V.**, u konstatua se, deklarimet e të miturit **R.V.** përpara Policisë Gjyqësore në datë 23.9.2021, u bënë **pa praninë e prindit**, pa u pyetur nëse dëshironte që ai të ishte i pranishëm. (f. 62);
- d) në procedimin penal **nr. 446/2023, të Prokurorisë së Shkodrës**, në ngarkim të të miturit në konflikt me ligjin, **A.K.**, u vërejt se, në procesverbalin e pyetjes së tij nga OPGJ-ja, në datë 22.5.2023, **nuk ka marrë pjesë psikologu** (f. 179);
- e) në procedimin penal **nr. 10/2023, të Prokurorisë së Shkodrës**, në ngarkim të të miturit në konflikt me ligjin, **J.B.**, në aktin e njoftimit të akuzës ndaj tij të datës 3.5.2023, **nuk ka qenë i pranishëm psikologu** (f. 94-98); dhe
- f) në procedimin penal **nr. 903/2020, të Prokurorisë së Vlorës**, në ngarkim të të miturve në konflikt me ligjin, **G.T., Q.P., Xh.Z., R.T. dhe A.G.** u konstatua se, nga përmbajtja e procesverbalit të pyetjes së personit që tregon të dhëna për veprën penale, **A.G.**, datë 25.6.2020, **prindi nuk ka qenë i pranishëm** (f. 37-38).

Dhënien e deklarimeve përpara OPGJ-së pa praninë e njëkohshme të psikologut dhe prindit e pretenduan të miturit në konflikt me ligjin **F.M.** (Prokuroria e Tiranës), **O.Z.** (Prokuroria Tiranës). Ndërsa të miturit **S.M., E.K., O.Ç. dhe Xh.Çe. (Prokuroria e Elbasanit)** pretenduan se nuk iu ishte mundësuar takimi me prindit dhe pjesëmarrja e tyre gjatë dhënies së deklarimeve përpara prokurorit të çështjes. Të njëjtin pretendim paraqiti edhe i mituri në konflikt me ligjin **P.K.** (Prokuroria e Vlorës), sipas të cilit deklarimet e tij në Policinë Gjyqësore janë dhënë pa praninë e prindit të tij. Ndërkaq, i mituri në konflikt me ligjin **O.Z.** (Prokuroria e Tiranës) pretendoi se, e ëma e tij nuk kishte marrë

pjesë gjatë pyetjes së tij, pasi kishte ardhur në përfundim të saj, por gjithsesi e kishte nënshkruar procesverbalin. Një pretendim serioz ngriti i mituri S.M. (Prokuroria e Elbasanit), sipas të cilit psikologu i kishte bërë presion që të fliste, organi procedues do të fajësonte vetëm atë për kryerjen e veprës penale të "Vrasjes në rrethana cilësuese".

- **Ndërkohë, në procedimet penale që citohen në vijim ka dyshime mbi pjesëmarrjen e prindit dhe/ apo psikologut në kryerjen e akteve procedurale të të miturve në konflikt me ligjin, për shkak të mospasqyrimin të pranisë së tyre në përmbajtjen e procesverbaleve që kanë dokumentuar kryerjen e këtyre veprimeve:**
 - i) në procedimin penal **nr. 204/2019, të Prokurorisë së Durrësit**, në ngarkim të të miturve në konflikt me ligjin **L.L., L.M., F.M., E.M., K.M., K.K., E.H. dhe E.K.**, në procesverbalin e deklarimeve të **L.L.**, në datë 30.1.2019, **është e dyshimtë prania e të atit** (f. 195-196);
 - ii) në procedimin penal **nr. 501/2022, të Prokurorisë së Durrësit**, në ngarkim të të miturit në konflikt me ligjin, **M.M.**, në procesverbalin e deklarimeve të tij në datë 18.3.2022, **mbetet e dyshimtë prania e të ëmës dhe psikologut** (f. 36-37);
 - iii) në procedimin penal **nr. 446/2023, të Prokurorisë së Shkodrës**, në ngarkim të të miturit në konflikt me ligjin, **A.K.**, në procesverbalin e pyetjes së tij në datë 12.6.2023 **mbetet e dyshimtë pjesëmarrja e prindit dhe psikologut**, pasi edhe pse nënshkruajnë në fund të procesverbalit, nuk përmenden në përmbajtjen e tij (f. 179); ndërkohë, në përmbajtjen e procesverbalit të pyetjes së të miturit A.K. të datës 18.1.2024 **nuk citohet prania e të atit**, ndërkohë që ai ka nënshkruar në fund të tij (f. 220);
 - iv) në procedimin penal **nr. 192/2023, të Prokurorisë së Shkodrës**, në ngarkim të të miturit në konflikt me ligjin, **P.M.**, në procesverbalin e deklarimeve të tij në datë 23.2.2023, **është e dyshimtë prania e të atit dhe psikologut** (f. 25);
 - v) në procedimin penal **nr. 44/2023, të Prokurorisë së Shkodrës**, në ngarkim të të miturit në konflikt me ligjin, **G.N.**, në procesverbalin e deklarimeve të tij të datës 27.12.2022, **mbetet e dyshimtë prania e të atit dhe psikologut** (f. 41-42);
 - vi) në procedimin penal **nr. 10/2023, të Prokurorisë së Shkodrës**, në ngarkim të të miturit në konflikt me ligjin, **J.B.**, në procesverbalin e deklarimeve të tij në datë 22.3.2023, është e dyshimtë **prania e të atit dhe psikologut** (f. 90). **E njëjta mangësi** vërehet edhe në procesverbalin e pyetjes së tij, datë 12.5.2023 (f. 98/1);
 - vii) në procedimin penal **nr. 627/2023, të Prokurorisë së Shkodrës**, në ngarkim të të miturit në konflikt me ligjin, **K.B.**, në procesverbalin e pyetjes si i pandehur në datë 27.7.2023, është e dyshimtë **prania e të atit dhe psikologut** (f.42); dhe
 - viii) në procedimin penal **nr. 1123/2023, të Prokurorisë së Fierit**, në ngarkim të të miturit në konflikt me ligjin, **K.Ç.**, në procesverbalin e deklarimeve të tij në datë 25.8.2023, **mbetet e dyshimtë prania e të atit dhe psikologut** (f. 25-26).

6.9 Mospërfundimi i hetimeve paraprake brenda një afati të arsyeshëm, pa shkaqe objektive që mund të justifikonin vonesën

Mbi rëndësinë e hetimit dhe e gjykimit të shpejtë dhe brenda një afati të arsyeshëm të çështjeve penale që përfshijnë të mitur në konflikt me ligjin folëm më lart në këtë studim, teksa arsyetua mbi parimin e gjykimit me përparësi dhe pa vonesa (neni 17 i KDPM-së). Në esencë, **kërkohet të evitohet zgjatja e procesit tej caqeve të sanksionuara me ligj, në mënyrë që ai të mos përbëjë në vetvete një formë ndëshkimi**. Zgjatja e procedimit mund t'i shkaktojë të miturit pasoja serioze edukative, sociale dhe psikologjike. Rrjedhimisht, kërkohet që drejtësia për fëmijët të mos jetë vetëm e drejtë, por edhe e shpejtë, pasi **vonesat cenojnë qëllimin edukativ dhe rehabilitues të fëmijës**.

Vonesat në procesin penal ndaj një të mituri mund të krijojnë situata të ankthit, pasigurisë dhe izolimit të zgjatur për fëmijën. Sikundër e kemi theksuar, në periudhën e zhvillimit të personalitetit të të miturve të grupmoshës 14-18 vjeç, **pritja e gjatë për një vendim gjyqësor përjetohet si ndëshkim dhe ndikon në krijimin e ndjenjës së pasigurisë, uljes së vetëvlerësimit dhe rritjes së vështirësisë për integrimin social të fëmijës**.

Në përputhje me parimin e sanksionuar nën nenin 17, KDPM-ja, në disa dispozita të saj, ka përcaktuar, se:

- (i) **hetimet paraprake ndaj të miturve duhet të përfundojnë brenda tre muajve nga regjistrimi i emrit të tij në Regjistrin e Njoftimeve të Veprave Penale** (neni 88 § 2), përveç rasteve kur i mituri kryen edhe vepër tjetër penale ose vepra penale që po hetohet është në kompetencë të Gjykatës së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, ku kohëzgjatja e hetimeve është e njëjlojtë me të pandehurit e rritur;
- (ii) **gjykimi në shkallë të parë duhet të përfundojë brenda 6 muajsh** (neni 88 § 3), ndërsa **në gjykatën e apelit brenda 2 muajsh** (neni 88 § 4);
- (iii) **kohëzgjatja e paraburgimit të të miturit në konflikt me ligjin nuk duhet të kalojë ½ e kohëzgjatjes së parashikuar në KPP** për të rriturit (neni 87 § 4) dhe
- (iv) masa e sigurimit personal me karakter shtrëngues "Arrestit në burg" duhet të verifikohet çdo muaj (neni 87 § 1).

Për efekte të këtij studimi **do të verifikohet vetëm respektimi i afatit të hetimeve paraprake nga prokuroritë në procedimet penale të konsultuara**. *Po, sa respektohet ky afat?* Duhet pohuar se, **në pjesën më të madhe të procedimeve penale këto afate respektohen**, duke u bërë përpjekje që hetimi i çështjes të mos kalojë afatin tremujor nga dita e shënimit të emrit të të miturit në konflikt me ligjin në regjistër. Ky është tregues i përkushtimit dhe dilijencës që tregojnë prokurorët në ushtrimin e detyrës, duke mos lejuar shkelje formale të ligjit dhe duke kontribuar në garantimin gjithnjë e më të madh të të drejtave të të miturve në konflikt me ligjin.

Megjithatë, **edhe këtu vërehen raste të mosrespektimit të afatit të përfundimit të hetimeve**, duke i shtrirë ato përtej afatit maksimal të caktuar nga ligjvënësi prej tre muajsh. Më poshtë po pasqyrojmë disa nga rastet kur ky afat nuk është respektuar.

Në rastin e **të miturit P.C. të Prokurorisë së Elbasanit (procedimi penal nr. 809/2024)** u provua që urdhri për regjistrimin e veprës penale dhe emrit të të miturit u mor në datë 2.7.2024, ndërkohë që procedimi penal u mbyll (hetimet paraprake përfunduan) më 24.10.2024, kur u disponua me vendimin për pushimin e çështjes për të miturin P.C., të akuzuar për veprën penale të "Vjedhjes" (neni 134 § 1 i Kodit Penal) për shkak të zbatimit të masës së shmangies. Sikundër konstatohet, **hetimet kanë zgjatur mbi tre muaj** (kishin përfunduar në datë 2.10.2024), në kundërshtim me pikën 2 të nenit 88 të KDPM-së. Ndërkohë, edhe pse **në vlerësimin tonë KDPM-ja nuk e njeh zgjatjen e afateve të hetimeve paraprake** për këtë vepër penale, gjithsesi prokuroria nuk ka operuar me zgjatjen e afateve të hetimeve, sikundër e kemi hasur në shumicën e procedimeve penale të tjera që nuk kanë përfunduar brenda afatit tremujor. **Në këtë rast nuk kishte asnjë arsye për të mos u mbyllur hetimet brenda afatit ligjor**, pasi të gjitha provat e nevojshme, përfshi Raportin e Vlerësimit Individual (RVI) për P.C. ishin grumbulluar që në datë 5.8.2024. Në procedimin në shqyrtim nuk kemi qenë përpara ndonjë veprë penale që kërkonte hetime komplekse, ndaj, edhe pse prokuroria përballet me volum të lartë pune dhe mungesa në numrin e prokurorëve, kjo çështje mund të mbyllet brenda datës 2.10.2024.

Në **procedimin penal nr. 166/1/2024 të Prokurorisë së Elbasanit**, që i përket të miturit në konflikt me ligjin, **M.C.**, të akuzuar për veprën penale "Dhuna në familje", parashikuar nga neni 130/a (1) i Kodit Penal, rezultoi se emri i tij është shënuar në regjistër më 15.2.2024 dhe hetimet duhej të mbylleshin brenda datës 15.5.2024. Ndërkohë, prokurori ka vendosur të zgjasë afatet e hetimeve që donin edhe 22 ditë të përfundonin, më 23.4.2024(!). Edhe pse për këtë vepër penale nuk lejohet zgjatja e afateve të hetimit, vlerësohet se vendimi për zgjatjen e hetimeve, përveç handicapit që përmendëm, nuk ka asnjë arsye të vlefshme për të shtyrë edhe me tre muaj afatin e hetimeve për komunikimin e akuzës dhe mbylljen e hetimeve, sikundër "argumentohet" në vendimin e datës 23.4.2024. Këto veprime të invokuara nga prokurori për të kërkuar zgjatjen e hetimeve mund të realizoheshin brenda datës 15.5.2024, duke respektuar afatin ligjor. **Çështja penale është mbyllur përfundimisht në datë 8.7.2024, thujse 5 muaj nga regjistrimi i emrit**, duke u pushuar, si pasojë e zbatimit të shmangies për të miturin M.C.

Rasti tjetër lidhet me **të miturin K.Ç. të Prokurorisë së Fierit (procedimi penal nr. 11239/2023)**, të hetuar për kryerjen e veprës penale "Drejtimi i mjetit në mënyrë të parregullt", parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal, ku u provua që urdhri për regjistrimin e veprës penale dhe emrit të të miturit u mor në datë 7.9.2023, ndërkohë që hetimet paraprake

përfunduan më 12.12.2023, kur u disponua me vendimin për pushimin e çështjes, për shkak të zbatimit të masës së shmangies. Sikundër konstatohet, **hetimet kanë zgjatur mbi tre muaj** (kishin përfunduar në datë 9.12.2024), në kundërshtim me nenin 88 § 2 të KDPM-së. Ndërkohë, edhe pse KDPM-ja nuk e njeh zgjatjen e afateve të hetimeve paraprake për këtë veprë penale, gjithsesi prokuroria nuk ka operuar me zgjatjen e afateve të hetimeve. **Në këtë rast, gjykojmë se nuk kishte asnjë arsye për të mos u mbyllur hetimet brenda afatit ligjor**, pasi të gjitha provat e nevojshme, përfshi Raportin e Vlerësimit Individual (RVI) për K.Ç. ishin grumbulluar që në datë 14.11.2023. Vetëm fakti që të gjithë veprimet dhe aktet e tjera procedurale prokurori i kreu brenda një dite (12.12.2023) është tregues kuptimplotë i mundësisë për ta respektuar afatin e përfundimit të hetimeve. Në rastin në shqyrtim nuk kemi qenë përpara ndonjë veprë penale që kërkonte hetime komplekse, ndaj, edhe pse prokuroria përballlet me volum të lartë pune dhe mungesa në numrin e prokurorëve, kjo çështje mund të mbyllet brenda datës 7.12.2023.

Në **procedimin penal nr. 338/2023 të Prokurorisë së Shkodrës**, që i përket të miturit në konflikt me ligjin, **A.H.**, i akuzuar për veprën penale "*Plagosje e rëndë me dashje*", parashikuar nga neni 88 § 1 i Kodit Penal, rezultoi se emri i tij është shënuar në regjistër më 8.4.2023 dhe hetimet duhej të mbylleshin brenda datës 8.7.2023. Ndërkohë, prokurori ka vendosur të zgjasë afatet e hetimeve më 7.7.2023 për një afat njëmuajor, me arsyetimin që janë arritur të administrohen të gjithë aktet e ekspertimit të urdhëruara për t'u kryer, nuk janë pyetur të gjithë dëshmitarët dhe personat e dyshuar, si dhe veprimet e tjera hetimore. Edhe për këtë veprë penale nuk lejohet zgjatja e afateve të hetimit. Në këtë rast prokurori duhet të merrte masat e nevojshme për t'i kryer veprimet e cituara më lart brenda afatit ligjor. **Çështja penale është dërguar në gjyq në datë 31.7.2023, 24 ditë mbi afatin 3 muajor.**

Rasti i fundit i referohet procedimit penal **nr. 903/2020 të Prokurorisë së Vlorës**, në ngarkim të të miturve në konflikt me ligjin, **G.T., Q.P., Xh.Z., R.T. dhe A.G.**, të akuzuar, G.T dhe A.G. për "*Vrasje me dashje*" në bashkëpunim dhe të tjerët për "*Moskallëzim krimi*". Rezultoi se emri i G.T. është shënuar në regjistër më 19.6.2020 dhe hetimet duhej të mbylleshin brenda datës 19.9.2020. Ndërkohë, **edhe pse KDPM-ja nuk parashikon zgjatje të afatit hetimor për këtë veprë penale, prokurori ka vendosur të zgjasë afatet e hetimeve më 18.9.2020 për një afat tremujor**, deri në datë 19.12.2020, me arsyetimin se, nuk është administruar akti i ekspertimit mjeko-ligjor të viktimës A.P. Në dosje gjendet i administruar akti i ekspertimit nr. 19/A, i cili mban datën 19.6.2020, i mjekut ligjor A.Z, që e ushtron profesionin pranë Spitalit Rajonal të Vlorës. Është e habitshme sesi ky akt ekspertimi është administruar në Prokurori vetëm në datë 17.12.2020, kur ai ishte hartuar 6 muaj më parë dhe pse organi procedues nuk kishte kërkuar në kohë dërgimin e tij. Ndërkohë, **prokurori ka vendosur në datë 18.12.2020 zgjatjen edhe me tre muaj të tjerë të afatit hetimor**, deri më 19.3.2021, për t'u njoftuar personave nën hetim akuzën, njohja e tyre me përfundimin e hetimeve, si dhe pyetja e tyre me cilësinë e të pandehurit. Marrja e tre muajve kohë për veprimet e cituara është krejtësisht në kundërshtim me frymën që përcjell KDPM-së për mbylljen sa më shpejt dhe shqyrtimin me përparësi të çështjeve që i përkasin të miturve në konflikt me ligjin. Përfundimisht, **procedimi penal është dërguar në gjyq më 3.2.2021 - 7 muaj e 14 ditë më vonë**. Ky rast është tregues i mungesës së theksuar të dilijencës nga prokurori, duke e shtyrë përfundimin e hetimeve shumë muaj pas afatit ligjor, për shkaqe tërësisht të tejkalueshme, nëse do të tregohej një impenjimi minimal.

6.10 Mungesa e hartimit të raportit të vlerësimit individual

Gjetja e fundit e rëndësishme nga analizimi i fashikujve të procedimeve penale të prokurorëve që u përzgjedhën për studimin i referohet mungesës së hartimit të raportit të vlerësimit individual (RVI) në disa prej procedimeve penale. Kur folëm më herët për rëndësinë e RVI-së theksuam se, për të miturin në konflikt me ligjin ky raport siguron që çdo masë e marrë ndaj tij të jetë e personalizuar, proporcionale e rehabilituese dhe jo ndëshkuese. Neni 22 i KDPM-së sanksionon se, gjykata dhe prokurori janë të detyruar që, përpara çdo vendimmarrjeje, të marrin në konsideratë rrethanat individuale të të mituri, si: moshja, niveli i zhvillimit, kushtet e jetesës, edukimi, gjendja familjare e shëndetësore, si dhe të kërkojnë ndihmën e ekspertëve të fushave të ndryshme, në mënyrë që të kuptojnë personalitetin, përgjegjshmërinë dhe shkallën e përgjegjësisë penale të tij. Nga përmbajtja e kësaj dispozite rezultoi se, **RVI-ja është një akt i domosdoshëm, pasi vetëm duke u njohur paraprakisht me rezultatet e tij,**

organi procedues mund të marrë një vendim në përputhje me interesin më të lartë të të miturit, në respekt të mbrojtjes së mirëqenies fizike dhe psikologjike të tij dhe me qëllim mbajtjen larg traumave.

Nenit 47 i KDPM-së rregullon në detaje se çfarë përmban një RVI dhe kushtet kur kërkohet të hartohet ajo. Në paragrafin e parë të nenit 47 tregohet se, ku duhet të mbështetet prokurori/gjykata në procesin e vlerësimit të të miturit, duke përcaktuar: *"nivele e zhvillimit, mënyrën e jetesës, edukimin dhe kushtet e zhvillimit, arsimimin, gjendjen shëndetësore, mjedisin familjar dhe kushtet e tjera të të miturit, të cilat e lejojnë për të vlerësuar karakteristikat e personalitetit të të miturit, të sjelljes dhe të nevojave të tij, përfshirë edhe nevojat e veçanta."*

Raporti i vlerësimit individual i të miturit në konflikt me ligjin përshkruan nevojat e veçanta të tij, rrezikun e kryerjes në të ardhmen të një veprë penale, si dhe elemente të tjera në varësi të rastit dhe rekomandon masat e duhura për të nxitur zhvillimin dhe integrimin e tij në shoqëri. Paragrafi i katërt i nenit 47 përcakton **rastet kur RVI-ja është e detyrueshme**, duke përcaktuar si të tilla, për sa i intereson objektit të këtij studimi, rastet kur nga prokurori apo gjykata çmohet të zbatohen **masat alternative të shmangies** apo kur gjykata do të përzgjedhë **llojin e dënimit** që do të caktojë. Madje, në doktrinë është mbajtur qëndrimi se, nuk mund të ketë një proces penal të plotë me një mitur në konflikt me ligjin/viktimitë pa u administruar paraprakisht një RVI.¹⁴⁷

Nga studimi i fashikujve të procedimeve penale rezulton se, **në pjesën më të madhe të rasteve RVI-të hartohen gjatë hetimit paraprak**, kryesisht nga Shërbimi territorial i Provës, në të cilin sugjerohet lloji i vendimmarrjes, shmangie apo mbikëqyrje. E megjithatë, nga hulumtimi i fashikujve ka rezultuar se, **në disa prej tyre nuk është urdhëruar kryerja e RVI-së**, duke bërë që prokuroria dhe gjykata të kenë marrë vendime për të miturit në konflikt me ligjin, pa pasur një tablo psiko-sociale të tij dhe duke vepruar në kundërshtim me sa parashikon KDPM-ja në nenet 22 dhe 47 të tij.

Më poshtë **po përmendim procedimet penale ku RVI-ja nuk është çmuar të merret nga organi procedues, në shkelje të dispozitave të KDPM-së** që e kërkojnë në mënyrë të detyrueshme atë, për shkak të caktimit të llojit të dënimit (pezullimi i dënimit me burgim dhe vënia e të dënuarit të mitur në provë, në kushtet e nenit 104 të KDPM-së, në lidhje me nenin 59 të Kodit Penal):

- (i) **procedimi penal nr. 331/2024 i Prokurorisë së Tiranës**, që i përket **të miturit S.K.**, i akuzuar se në bashkëpunim me të rriturin G.K. kanë kryer krimin e *"Trafikimit të lëndëve narkotike"*, të parashikuar nga neni 283/a(2) i Kodit Penal, në formën e importimit nga SHBA-të. I mituri S.K. u dënua me kusht nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë;¹⁴⁸
- (ii) **procedimi penal nr. 2578/2024 i Prokurorisë së Tiranës**, në ngarkim të të miturve në konflikt me ligjin, **A.G., T.Ç. dhe Xh.M.**, të akuzuar për kryerjen e veprës penale *"Shtrëngimi me anë të kanosjes apo dhunës për dhënien e pasurisë"*, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 109/b-1 i Kodit Penal;
- (iii) **procedimi penal nr. 3374/2019 i Prokurorisë së Tiranës**, në ngarkim të të miturit në konflikt me ligjin, **E.M.**, i akuzuar për veprën penale *"Vjedhja me dhunë"*, parashikuar nga neni 139 i Kodit Penal;
- (iv) procedimi penal nr. **14/2024 i Prokurorisë së Vlorës, në ngarkim të të miturve në konflikt me ligjin, A.H., P.K. e K.K.**, të akuzuar për kryerjen e veprës penale të *"Vjedhjes me dhunë"*, në bashkëpunim, parashikuar nga neni 139 dhe 50(gj) të Kodit Penal; dhe
- (v) procedimi penal nr. **903/2020 i Prokurorisë së Vlorës**, në ngarkim të të miturve në konflikt me ligjin, **G.T., Q.P., Xh.Z., R.T. dhe A.G.**, të akuzuar, G.T dhe A.G. për *"Vrasje me dashje"* në bashkëpunim dhe të tjerët për *"Moskallëzim krimi"*, për të miturit **Q.P., Xh.Z. dhe R.T.** që u dënuan me kusht nga Gjykata e Vlorës.¹⁴⁹

147 Shih: Merkaj, Tereza, *Komentari i Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur i interpretuar me praktikë gjyqësore*, i sipërcituar, f. 112.

148 Vendimi nr. 2657/486 Akti, datë 24.7.2025, i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë.

149 Vendimi nr. 130, datë 6.3.2024, i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Vlorë.

Përfundime të përgjithshme

Në përfundim, studimi konkludon se, ndonëse Shqipëria disponon një kuadër ligjor përgjithësisht të harmonizuar me standardet ndërkombëtare për drejtësinë penale për të miturit, zbatimi i tij në praktikë vijon të shfaqë boshllëqe të dukshme ligjore dhe institucionale. Analiza e fashikujve të hetimit paraprak dhe e praktikës procedurale tregon se Policia Gjyqësore dhe Prokuroria, në shumicën e rasteve, kanë arritur një standard të pranueshëm në respektimin formal të të drejtave procedurale të të miturve, duke demonstruar njohje të kuadrit ligjor dhe një nivel të caktuar profesionalizmi, veçanërisht në garantimin e mbrojtjes ligjore dhe ndjekjen e procedurave bazë.

Megjithatë, ky vlerësim pozitiv bashkëjeton me problematika të përsëritura, të cilat dëshmojnë se respektimi i garancive procedurale nuk është ende i njëtrajtshëm, substancial dhe i qëndrueshëm, por shpesh mbetet formal dhe i varur nga praktikat individuale të aktorëve të përfshirë. Studimi evidenton gjithashtu mangësi të theksuara në koordinimin ndërinstytucional ndërmjet Policisë Gjyqësore, Prokurorisë, psikologëve dhe strukturave të mbrojtjes së fëmijëve, të reflektuara në mospërfshirjen sistematike të profesionistëve mbështetës, dokumentimin e paplotë të veprimeve procedurale dhe mungesën e vlerësimeve individuale psiko-sociale, të domosdoshme për vendimmarrje në përputhje me interesin më të lartë të fëmijës.

Një sfidë e rëndësishme mbetet edhe zgjatja e procedurave dhe mospërfundimi i hetimeve brenda afateve të arsyeshme, e cila cenon karakterin edukativ dhe rehabilitues të drejtësisë për të miturit dhe e shndërron procesin penal në një përvojë presioni të zgjatur.

Në këtë kontekst, studimi nënvizon nevojën për rritjen e specializimit profesional të aktorëve të drejtësisë, forcimin e mekanizmave të monitorimit dhe përgjegjshmërisë institucionale dhe përmirësimin e koordinimit ndërinstytucional, duke theksuar se sfidat kryesore nuk burojnë nga mungesa e normave ligjore, por nga hendeku midis legjislacionit dhe praktikës, si dhe mungesa e infrastrukturës së nevojshme, të cilat pengojnë funksionimin e plotë të një sistemi drejtësie efektiv, gjithëpërfshirës dhe realisht miqësor ndaj fëmijëve në konflikt me ligjin.

7. REKOMANDIMET E STUDIMIT

Sikundër jemi shprehur disa herë në këtë studim, nga analiza e fashikujve të procedimeve penale është vënë re një zbatim i kënaqshëm i normave ligjore nga Policia Gjyqësore dhe Prokuroria. Ky fakt ka kontribuar në arritjen e një standardi të pranueshëm në drejtim të respektimit të të drejtave procedurale të të miturve në konflikt me ligjin gjatë hetimeve paraprake. Megjithatë, studimi i realizuar vërejtë edhe raste të moszbatimit apo të zbatimit të gabuar të ligjit procedural penal (normave të KDPM-së dhe KPP-së) nga të cilat u listuan edhe dhjetë gjetjet kryesore.

Siç konstatohet lehtë, shumica e gjetjeve të evidentuara në këtë studim i referohen Policisë Gjyqësore, sidomos OPGJ-ve, pjesë e shërbimeve të Policisë së Shtetit, por pa përjashtuar edhe OPGJ-të, pjesë e seksioneve përkatës të prokurorive të shkallëve të para. Rrjedhimisht, edhe rekomandimet më të rëndësishme në drejtim të përmirësimit të zbatimit të ligjit procedural penal dhe KDPM-së do të bëhen për Policinë Gjyqësore.

A. Rekomandime për Policinë Gjyqësore:

Rekomandimi i parë për Policinë Gjyqësore është zbatimi me rigorozitet i nenit 296 § 1 të KPP-së, lidhje me nenin 256 § 1 të të njëjtit kod, në rastet kur i mituri në konflikt me ligjin arrestohet në flagrancë apo ndalohej prej saj. Sikundër e kemi trajtuar te pjesa e gjetjeve, në këtë rast pyetja e të miturit të arrestuar apo të ndaluar duhet të bëhet ekskluzivisht nga prokurori i çështjes, në zbatim të urdhërimeve të nenit 256 § 1 të KPP-së. Për pasojë, OPGJ-ja përkatës duhet, jo vetëm që të njoftojë prokurorin, për kryerjen e veprës penale dhe autorin e dyshuar të saj, por edhe ta vendosë të arrestuarin/ndaluarin në dispozicion të prokurorit për ta marrë në pyetje, nëse ky i fundit e çmon si të domosdoshme kryerjen e këtij veprimi hetimor. Në asnjë rast PGJ-ja nuk duhet ta marrë në pyetje vetë të miturin të arrestuar/ndaluar, pasi një veprim i tillë do të vinte në kundërshtim me pikën 1 të nenit 256 të KPP-së, duke e bërë këtë provë të paligjshme dhe, për konsekuencë të papërdorshme.

Rekomandimi i dytë dhe ndoshta kryesori për Policinë Gjyqësore lidhet me **zbatim e drejtë dhe korrekt të nenit 37 të KPP-së, që ndalon përdorimin si provë të deklarimeve vetëfajësuese**. Sipas gjetjeve të konstatuara, OPGJ-të, vetëm në raste të rralla, ndalojnë deklaratimet e personave që pyeten jo si të dyshuar, por si persona që tregojnë rrethana të dobishme për qëllimet e dënimit dhe citojnë të dhëna vetinkriminuese. **Zbatimi i saktë dhe sipas interpretimit qëllimor (teleologjik) i normës së nenit 37 kërkon që deklaratime të tilla vetëfajësuese të ndërpriten menjëherë dhe jo në përfundim të tyre**, kur personi ka deklaruar gjithçka di për faktin penal dhe veprimet/mosveprimet e tij në drejtim të kryerjes së tij. Në të tilla raste, **OPGJ-të** duhet jo vetëm të ndalojnë pyetjen e mëtejshme, t'i bëjnë me dije deklaruesit se ndaj tij mund të zhvillohen hetime dhe ta orientojë atë për të gjetur një mbrojtës, por edhe **t'i kërkojnë prokurorit që thëniet e mëparshme të deklarohen të papërdorshme, në zbatim të përcaktimeve imperative të pikës 3 të nenit 151 të KPP-së**.

Rekomandimi i tretë për Policinë Gjyqësore lidhet me **zbatimin e dispozitave të KDPM-së për sigurimin e pranisë së detyrueshme të mbrojtësit dhe psikologut në çdo veprim procedural ku i mituri merr pjesë**. Gjetjet e këtij punimi treguan se, në disa prej veprimeve procedurale ndaj të miturve në konflikt me ligjin, një apo disa prej këtyre subjekteve nuk kanë marrë pjesë apo prania e tyre ka mbetur e dyshimtë. Në këtë aspekt duhet të ritheksojmë se, në asnjë rrethanë nuk mund të hiqet dorë nga prania e mbrojtësit dhe psikologut, pasi ky është imperativ ligjor. Veprime të tilla, përbëjnë shkelje të rëndë të ligjit procedural - në vështrim të neneve 18 e 19 §§ 1 & 3 (a) të KDPM-së të lexuar së bashku me nenet 35 dhe 49 § 1 (a) të KPP-së - me pasojë pavlefshmërinë absolute apo relative të akteve procedurale (nenet 128 § 3 & 129 të KPP-së) apo papërdorshmërinë e provave (neni 151 § 3 i KPP-së).

Për të shmangur këtë paligjshmëri nevojitet që **PGJ-ja të dokumentojë qartë në përmbajtjen e procesverbalit përkatës praninë e mbrojtësit dhe psikologut, duke mos u mjaftuar vetëm me nënshkrimin prej tyre të procesverbalit.** Do të ishte e këshillueshme që PGJ-ja të tregonte në një akt të veçantë caktimin e psikologut, sikundër vepron prokurori. Ndërsa **në lidhje me veprimet që kryhen PGJ-ja për caktimin e mbrojtësit, marrjen dijani të të miturit për mbrojtësin e caktuar dhe dhënien e pëlqimit prej tij apo përfaqësuesit të tij ligjor, është e detyrueshme mbajtja e një procesverbali të veçantë, në bazë të nenit 48 § 3 të KDPM-së.**

Rekomandimi i katërt për Policinë Gjyqësore lidhet me **dokumentimin e veprimeve që kryhen prej saj për njoftimin e prindit/personit të besuar për të qenë i pranishëm në çdo veprim procedural ku i mituri merr pjesë, në përmbushje të kërkesave të nenit 19 § 3 (ç) të KDPM-së.** Këtu duhet të rivëmë në dukje se, ndërsa prania e mbrojtësit dhe psikologut është e detyrueshme ajo e prindit/personit të besuar varet nga vullneti i të miturit në konflikt me ligjin. Megjithatë, nëse i mituri e kërkon praninë e prindit/personit të besuar, kjo pjesëmarrje është e domosdoshme. Edhe **ky vullnet i miturit duhet dokumentuar në një akt të veçantë apo në procesverbalin që pasqyron kryerjen e veprimeve procedurale.**

Rekomandimi i pestë për PGJ-lidhet me **respektimin e momentit kohor të vënies në dispozicion të të miturit në konflikt me ligjin të letrës së të drejtave dhe ofrimit të mundësive që ato të kuptohen prej tij nëpërmjet pjesëmarrjes dhe shpjegimeve të dhëna nga OPGJ-ja, mbrojtësi, psikologu dhe prindi/personi i besuar.** Sikundër e bëmë me dije gjatë analizës së gjetjeve, letra e të drejtave nuk përmbante në të shumtën e rasteve datën e dhënies së saj dhe rrallë provohej, nëpërmjet dokumentimit në procesverbal, që i mituri ishte njohur paraprakisht me to dhe i kishte kuptuar. Për më tepër, kishte raste të shumta që kjo letër i ishte vënë në dispozicion të miturit pa pasur ndihmën për t'i kuptuar, sipas rasteve të referuara, të prindit/personit të besuar, mbrojtësit apo psikologut.

Pa dashur të përsërisim rëndësinë që ka njohja e të drejtave të të miturit përpara se ai të vihet në dispozicion të organit procedues për ta pyetur apo kryer veprime të tjera procedurale, **i bie barra Policisë Gjyqësore që të provojë marrjen dijani të të miturit për të drejtat e tij, jo vetëm nëpërmjet marrjes së nënshkrimit të tij, por edhe shpjegimit të këtyre të drejtave,** krahas ndihmës që jep në këtë drejtim mbrojtësi i të miturit, psikologu dhe eventualisht edhe prindi/personi i besuar. Policisë Gjyqësore i bie detyrimi të mos procedojë me kryerjen e veprimeve të kërkuara derisa të bindet që i mituri i kupton të drejtat e tij, por edhe hetimin që po zhvillohet dhe faktet që i atribuohen. Vetëm kur të drejtat procedurale të parashikuara në nenet 34/a dhe 34/b të KPP-së të kuptohen prej të miturit atij i sigurohet mbrojtje efektive.

B. Rekomandime në lidhje me prokurorinë:

Sikundër e pohuam edhe në studim, në pjesën më të madhe të veprimeve procedurale të kryera nga prokurori vërehet respektim i ligjit procedural penal, tregues ky i nivelit të kënaqshëm profesional që magjistratët prokurorë kanë. Megjithatë, edhe në veprimet e udhëhequra nga prokuroria janë vërejtur problematika, të cilat janë cituar dhe analizuar te gjetjet e konstatuara. Nga analiza e legjislacionit të zbatueshëm dhe gjetjeve të evidentuara lind e nevojshme të bëhen disa rekomandime edhe për organin e prokurorisë, me qëllim forcimin e zbatimit të ligjit dhe mbrojtjes sa më efikase të të drejtave procedurale të të miturve në konflikt me ligjin.

Rekomandimi i parë për prokurorinë i referohet **zbatimit korrekt të nenit 287 të KPP-së, në lidhje me regjistrimin sa më të shpejtë në Regjistrin e Njoftimit të Veprave Penale të njoftimit të ardhur për kryerjen e dyshuar të një veprë penale dhe autorit të saj.** Edhe pse një afat kohor prej disa ditësh mund të justifikohet për shkak të mbingarkesës në punë, regjistrimi i veprës penale i bërë përtej afatit 15 ditor është jo i arsyeshëm dhe bie ndesh me frymën e shpejtësisë së procesit që garantohet në KPP. Po kështu, mosregjistrimi i emrit të autorit kur identifikimi i tij është i dukshëm apo kur është arrestuar në flagrancë, përbën moszbatim të ligjit pa arsye të justifikueshme.

Rekomandimi i dytë për prokurorinë lidhet me **marrjen e masave për të kërkuar pranë gjyqtarit të hetimeve paraprake që të vleftësojë të ligjshëm arrestimin në flagrancë apo ndalimin e të miturit në konflikt me ligjin nga ana e Policisë Gjyqësore** (neni 258 të KPP-së). Ky veprim është i domosdoshëm dhe lidhet me rëndësinë themelore që ka për individin e drejta për liri e siguri e marrë në mbrojtje nga neni 5 i KEDNJ-së dhe Kushtetuta shqiptare (nenet 27 dhe 28). Për pasojë, çdo kufizim i lirisë nëpërmjet arrestimit në flagrancë apo ndalimit të të miturit, nëse prokurori çmon se ai është kryer në përputhje me normat e KPP-së, duhet të vleftësohet i ligjshëm në gjykata, si i vetmi autoritetet që ka atribut të dhënë nga kushtetuta për të gjykuar mbi ligjshmërinë e paramasës së sigurimit të vendosur nga PGJ-ja apo prokurori.

Rekomandimi i tretë i referohet **zbatimit rigoroz të nenit 256 të KPP-së** që ia ngarkon vetëm prokurorit të drejtën dhe përgjegjësinë për të marrë në pyetje personin e arrestuar në flagrancë apo të ndaluar. Për këtë qëllim prokurori duhet që të urdhërojë Policinë Gjyqësore që t'i vërë në dispozicion të miturit në konflikt me ligjin për ta pyetur, në rast se ai e çmon të nevojshëm kryerjen e këtij veprimi në këtë fazë fillestare të hetimit paraprak. Në çdo rast, **prokurori është i detyruar që të deklarojë të papërdorshme deklaratimet e dhëna nga i mituri në konflikt me ligjin i arrestuar apo ndaluar, kur ato janë dhënë përpara OPGJ-së.**

Rekomandimi i katërt për prokurorinë lidhet me **aplikimin korrekt të nenit 37 të KPP-së**, duke vlerësuar në çdo rast nëse në deklaratimet e dhëna përpara OPGJ-së nga personat e pyetur me cilësinë e atyre që mund të ndihmojnë hetimin, ka të dhëna vetimplikuese. Ky verifikim mund të bëhet kryesisht, por edhe me kërkesën e palëve, **duke i shpallur ato të papërdorshme, nëse konstatohen shkelje të kushteve që vendos kjo dispozitë.**

Rekomandimi i pestë për organin e prokurorisë lidhet me **organizimin e punës së tyre hetimore në mënyrë të tillë që hetimin e çështjes të përfundojë brenda 3 muajve**, nga data e regjistrimit të emrit të të miturit në konflikt me ligjin në Regjistrin e Njoftimit të Veprave Penale. Në këtë pikë duhet të kujtojmë se, KDPM-ja nuk e njeh në asnjë rast zgjatjen e afateve të hetimit paraprak, rrjedhimisht, në përputhje me parimin e shpejtësisë dhe përparësisë, këto çështje duhet të hetohen brenda këtij afati ligjor.

Rekomandimi i gjashtë për prokurorinë lidhet me **hartimin e raporteve të vlerësimit individual për të miturit në konflikt me ligjin në çdo rast që KDPM-ja e kërkon**. Kryerja e këtij raporti **përbën kërkesë të detyrueshme të ligjit**, ku prokurorit nuk i lejohet të ketë diskrecion. Ky vlerësim personal i të miturit duhet kryer në çdo rast që prokuroria duhet të aplikojë shmangien, si dhe kur kërkon që të bëhet zgjedhje ndërmjet llojeve të dënimeve që mund të caktohen për një vepër ku i mituri është gjetur fajtor.

Së fundi, duke u nisur nga fakti se Policia Gjyqësore dhe Prokuroria kanë arritur, në përgjithësi, një standard të pranueshëm në zbatimin e normave ligjore dhe respektimin e të drejtave procedurale të të miturve në konflikt me ligjin gjatë hetimeve paraprake, rekomandohet forcimi dhe konsolidimi i këtyre praktikave pozitive përmes standardizimit të tyre dhe zbatimit të një qasjeje të njëtrajtshme në të gjitha rastet. Në veçanti, kërkohet rritja e cilësisë së zbatimit praktik të garancive procedurale, përmes udhëzimeve të qarta institucionale, formimit të vazhdueshëm profesional dhe mekanizmave efektivë të monitorimit dhe vlerësimit. Kjo do të kontribuojë në sigurimin e një respektimi të qëndrueshëm, jo vetëm formal por edhe substancial, të të drejtave procedurale të fëmijëve, duke forcuar më tej karakterin edukativ, mbrojtës dhe rehabilitues të drejtësisë penale për të miturit.

Këto ishin disa rekomandime që ne menduam se do të ishin të dobishme të ndiqeshin nga organet proceduese gjatë kryerjes së veprimeve procedurale përgjatë hetimeve paraprake. Gjykojmë se, përmbushja sa më korrekte e rekomandimeve të mësipërme do të kontribuojë për të pasur një drejtësi penale për të mitur sa më të drejtë, ku respektimi i të drejtave procedurale të tyre, përbën zemrën e këtij procesi. Vetëm kështu, do të arrihen të zbatohen parimet themelore të drejtësisë miqësore për të miturit dhe interesit më të lartë të tyre.

Tiranë, tetor 2025.

BIBLIOGRAFIA E STUDIMIT:

A. Doktrinë:

1. Pierre Béliveau dhe Jean Pradel, *La justice pénale dans les droits canadien et français*, Cujas (1986).
2. Joanna Bunker Rohrbaugh, *A Comprehensive Guide to Child Custody Evaluations: Mental Health and Legal Perspectives*, Springer (2007).
3. Arta Mandro, *E drejta familjare*, familja, fëmijët, martesë, bashkëshortët, Emal (2009)
4. Tereza Merkaj, *Komentari i Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur i interpretuar me praktikë gjyqësore*, Morava (2020).
5. J. Trépanier, Les transformations du régime canadien relatif aux mineurs délinquants : un regard sur le droit et les pratiques, RSC, vol. 4, nr. 4, 2012.
6. Udhërrëfyes për jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese 1998-2023 lidhur me ankimin kushtetues individual.

B. Ligje kombëtare dhe ndërkombëtare:

1. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë
2. Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
3. Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, me rezolutën e saj 217 A (III), në datë 10 dhjetor 1948.
4. Konventa për të Drejtat e Fëmijëve, miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, 20 nëntor 1989.
5. Konventa kundër torturës dhe trajtimeve ose dënimeve të tjera mizore, çnjerëzore ose poshtëruese, miratuar nga Asambleja e Përgjithshme me Rezolutën 39/46, 10 dhjetor 1984.
6. Directive (EU) 2016/343 of the European Parliament and of the Council, 9 mars 2016, on the strengthening of certain aspects of the presumption of innocence and of the right to be present at the trial in criminal proceedings, OJ L 65/1, 11 mars 2016.
7. Directive (EU) 2016/800 of the European Parliament and of the Council, 11 maj 2016, on procedural safeguards for children who are suspects or accused persons in criminal proceedings, OJ L 132/1, 21 maj 2016.
8. Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar.
9. Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar.
10. Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur i Republikës së Shqipërisë.
11. Kodi i Drejtësisë për të Mitur i Kosovës nr. 06/L-006, 14.9.2018.
12. Ligji nr. 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës".

C. Udhëzime, rekomandime dhe komente të organizatave ndërkombëtare:

1. Handbook on European law relating to the rights of the child
2. ROL Platform (2020), *Fëmijët dhe Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut - Vështrim mbi jurisprudencën*, projekt i mbështetur nga AIRE Center dhe Civil Rights Defenders, Tiranë (2019).
3. Rregullat Minimale të Pekinit për Administrimin e Drejtësisë Penale për të Mitur, të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara nëpërmjet Rezolutës Nr. 40/33, datë 29 nëntor 1985.
7. Rregullat Evropiane për Sanksionet dhe Masat për të Miturit (CM/Rec (2008) 11)
8. Udhëzimet e Këshillit të Evropës për Drejtësinë Miqësore ndaj Fëmijëve (2010)
9. General Comment nr. 10 (2007): Children's rights in juvenile justice, UN Doc. CRC/C/GC/10 (26 prill 2007).
10. General Comment nr. 12 (2009): The right of the child to be heard, UN Doc. CRC/C/GC/12 (20 korrik 2009).
11. General Comment nr. 24 (2019): Children's rights in the child justice system, UN Doc. CRC/C/GC/24 (18 shtator 2019)

12. United Nations Economic and Social Council (ECOSOC), Guidelines on Justice in Matters involving Child Victims and Witnesses of Crime, ECOSOC Resolution 2005/20, 22 korrik 2005, para. 22.
13. United Nations Rules for the Protection of Juveniles Deprived of their Liberty ("Havana Rules"), miratuara nga Asambleja e Përgjithshme me Rezolutën 45/113, 14 dhjetor 1990.
14. Recommendation No. R (2003)20 on New ways of dealing with juvenile delinquency and the role of juvenile justice, miratuar më 24 shtator 2003.
15. Recommendation CM/Rec(2008)11 of the Committee of Ministers to member states on The European Rules for Juvenile Offenders subject to Sanctions or Measures, miratuar më 5 nëntor 2008.
16. Directive of the EU on procedural safeguards for children who are suspects or accused in criminal proceedings – Implementation Manual, botim i Fair Trials International (nën kujdesin e Komisionit Evropian).

D. Vendime të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut:

1. *Wemhoff kundër Gjermanisë*, kërkesa nr. 2122/64, 27 qershor 1968.
2. *Pakelli kundër Gjermanisë*, kërkesa nr. 8398/78, 12 korrik 1982 (Raporti i Komisionit Evropian të të Drejtave të Njeriut).
3. *Barberà, Messegué dhe Jabardo kundër Spanjës*, kërkesa nr. 10590/83, 6 dhjetor 1988.
4. *Boddaert kundër Belgjikës*, kërkesa nr. 12919/87, 12 tetor 1992.
5. *Funke kundër Francës*, kërkesa nr. 10828/84, 25 shkurt 1993.
6. *Dobbertin kundër Francës*, kërkesa nr. 13089/87, 25 shkurt 1993.
7. *Poitrimol kundër Francës*, kërkesa nr. 14032/88, 23 nëntor 1993.
8. *John Murray kundër Mbretërisë së Bashkuar*, kërkesa nr. 18731/91, 8 shkurt 1996.
9. *Foucher kundër Francës*, kërkesa nr. 22209/93, 18 mars 1997.
10. *Zana kundër Turqisë* [DhM], kërkesa nr. 18954/91, 25 nëntor 1997.
11. *T. kundër Mbretërisë së Bashkuar* [DhM], kërkesa nr. 24724/94, 16 dhjetor 1999.
12. *V. kundër Mbretërisë së Bashkuar* [DhM], kërkesa nr. 24888/94, 16 dhjetor 1999.
13. *Condron kundër Mbretërisë së Bashkuar*, kërkesa nr. 35718/97, 2 maj 2000.
14. *Averill kundër Mbretërisë së Bashkuar*, kërkesa nr. 36408/97, 6 qershor 2000.
15. *Heaney dhe McGuinness kundër Irlandës*, kërkesa nr. 34720/97, 21 dhjetor 2000.
16. *Z. dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar* [DhM], kërkesa nr. 29392/95, 10 maj 2001.
17. *Correia de Matos kundër Portugalisë* (vendim mbi pranueshmërinë), kërkesa nr. 48188/99, 15 nëntor 2001.
18. *S.N. kundër Suedisë*, kërkesa nr. 34209/96, 2 korrik 2002.
19. *Lagerblom kundër Suedisë*, kërkesa nr. 26891/95, 14 janar 2003.
20. *Sahin kundër Gjermanisë* [DhM], kërkesa nr. 30943/96, 8 korrik 2003.
21. *S.C. kundër Mbretërisë së Bashkuar*, kërkesa nr. 60958/00, 15 qershor 2004.
22. *Sejdovic kundër Italisë* [DhM], kërkesa nr. 56581/00, 1 mars 2006.
23. *Jalloh kundër Gjermanisë* [DhM], kërkesa nr. 54810/00, 11 korrik 2006.
24. *Hermi kundër Italisë* [DhM], kërkesa nr. 18114/02, 18 tetor 2006.
25. *Galstyan kundër Armenisë*, kërkesa nr. 26986/03, 15 nëntor 2007.
26. *Salduz kundër Turqisë* [DhM], kërkesa nr. 36391/02, 27 nëntor 2008.
27. *Panovits kundër Qipros*, kërkesa nr. 4268/04, 11 dhjetor 2008.
28. *Güveç kundër Turqisë*, kërkesa nr. 70337/01, 20 janar 2009.
29. *Dayanan kundër Turqisë*, kërkesa nr. 7377/03, 13 tetor 2009.
30. *Kart kundër Turqisë* [DhM], kërkesa nr. 8917/05, 3 dhjetor 2009.
31. *Adamkiewicz kundër Polonisë*, kërkesa nr. 54729/00, 2 mars 2010.
32. *Neulinger dhe Shuruk kundër Zvicrës*, kërkesa nr. 41615/07, 6 korrik 2010.
33. *Martin kundër Estonisë*, kërkesa nr. 35985/09, 30 maj 2013.
34. *Blokhin kundër Rusisë* [DhM], kërkesa nr. 47152/06, 23 mars 2016.

E. Vendime të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë:

1. Vendimi nr. 95, datë 27.07.2001
2. Vendimi nr. 25, datë 30.07.2003
3. Vendimi nr. 7, datë 27.04.2005
4. Vendimi nr. 11, datë 18.05.2005
5. Vendimi nr. 12, datë 06.06.2005
6. Vendimi nr. 23, datë 13.10.2005
7. Vendimi nr. 5, datë 04.03.2008
8. Vendimin nr. 23, datë 23.07.2009
9. Vendimi nr. 7, datë 12.03.2010
10. Vendimi nr. 14, datë 03.05.2011
11. Vendimi nr. 42, datë 29.09.2011
12. Vendimi nr. 45, datë 10.10.2011
13. Vendimi nr. 4, datë 10.02.2012
14. Vendimi nr. 12, datë 05.03.2012
15. Vendimi nr. 24, datë 30.04.2012
16. Vendimi nr. 6, datë 26.02.2013
17. Vendimi nr. 22, datë 20.03.2017
18. Vendimi nr. 67, datë 10.11.2017
19. Vendimi nr. 84, datë 26.12.2017
20. Vendimi nr. 33, datë 01.11.2021
21. Vendimi nr. 14, datë 21.06.2022

F. Vendime të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë:

1. Vendimi nr. 00-2023-422, datë 10.3.2023, *Prokuroria Korçë kundër të miturit në konflikt me ligjin K.S.*
2. Vendimi nr. 00-2023-995, datë 15.6.2023, *Prokuroria Krujë kundër të miturit në konflikt me ligjin A.C.*
3. Vendimi nr. 00-2023-922, datë 1.6.2023, *Prokuroria Pogradec kundër të miturit në konflikt me ligjin M.K.*
4. Vendimi nr. 00-2024-947, datë 23.5.2024, *Prokuroria Shkodër kundër të miturit në konflikt me ligjin E.M.*
5. Vendimi nr. 00-2022-1595, datë 6.12.2022, *Prokuroria Fier kundër të miturit në konflikt me ligjin F.G.*
6. Vendimi nr. 00-2023-928 (169), datë 1.6.2023, *Prokuroria Kurbin kundër të miturit në konflikt me ligjin A.Xh.*
7. Vendimi nr. 00-2025-858, datë 22.5.2025, *Prokuroria Kukës kundër të miturit në konflikt me ligjin I.Ç.*
8. Vendimi nr. 00-2024-1583, datë 1.10.2024, *Prokuroria Tiranë kundër të miturit në konflikt me ligjin A.Th.*
9. Vendimi njësesues nr. 00-2024-2161 (167), datë 4.7.2024, *Prokuroria Shkodër kundër të miturit në konflikt me ligjin R.M.*
10. Vendimi nr. 00-2025-374 (59), datë 27.2.2025, *Prokuroria për Krime të Rënda kundër (inter alia) të miturve në konflikt me ligjin A.A. dhe E.K.*

1.1 LISTA E PROCEDIMEVE PENALE TË ANALIZUARA NË FUNKSION TË KRYERJES SË STUDIMIT:

A. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë:

1. Procedimi penal nr. 321/2024, *Prokuroria kundër të miturit në konflikt me ligjin, S.K.*;
2. Procedimi penal nr. 157/2024, *Prokuroria kundër të miturve në konflikt me ligjin, E.D., E.Sh. dhe B.D.*;
3. Procedimi penal nr. 2578/2024, *Prokuroria kundër të miturve në konflikt me ligjin, A.G., T.Ç dhe Xh.M.*;
4. Procedimi penal nr. 6711/2021, *Prokuroria kundër të miturit në konflikt me ligjin, R.V.*;
5. Procedimi penal nr. 3374/2019, *Prokuroria kundër të miturit në konflikt me ligjin, E.M.*

B. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Shkodër:

1. Procedimi penal nr. 446/2023, *Prokuroria kundër të miturit në konflikt me ligjin, A.K.*;
2. Procedimi penal nr. 192/2023, *Prokuroria kundër të miturit në konflikt me ligjin, P.M.*;
3. Procedimi penal nr. 140/2023, *Prokuroria kundër të miturit në konflikt me ligjin, E.B.*;
4. Procedimi penal nr. 44/2023, *Prokuroria kundër të miturit në konflikt me ligjin, G.N.*;
5. Procedimi penal nr. 1/2023, *Prokuroria kundër të miturit në konflikt me ligjin, J.B.*;
6. Procedimi penal nr. 627/2023, *Prokuroria kundër të miturit në konflikt me ligjin, K.B.*;
7. Procedimi penal nr. 37/2023, *Prokuroria kundër të miturit në konflikt me ligjin, A.G.*
8. Procedimi penal nr. 338/2023, *Prokuroria kundër të miturit në konflikt me ligjin, A.H.*

C. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Vlorë:

1. Procedimi penal nr. 796/2023, *Prokuroria kundër të miturit në konflikt me ligjin, F.K.*;
2. Procedimi penal nr. 14/2024, *Prokuroria kundër të miturve në konflikt me ligjin, A.H., P.K. dhe K.K.*;
3. Procedimi penal nr. 836/2024, *Prokuroria kundër të miturit në konflikt me ligjin, I.H.*;
4. Procedimi penal nr. 321/2024, *Prokuroria kundër të miturve në konflikt me ligjin, G.T., Q.P., Xh.Z., R.T. dhe A.G. dhe të rinjve në konflikt me ligjin A.H. dhe A.O.*

D. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Fier:

1. Procedimi penal nr. 146/2025, *Prokuroria kundër të miturit në konflikt me ligjin, J.D.*;
2. Procedimi penal nr. 1123/2023, *Prokuroria kundër të miturit në konflikt me ligjin, K.Ç.*;
3. Procedimi penal nr. 328/2024, *Prokuroria kundër të miturve në konflikt me ligjin, E.P. dhe R.R.*

E. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Elbasan:

1. Procedimi penal nr. 1227/2023, *Prokuroria kundër të miturit në konflikt me ligjin, F.Z.*;
2. Procedimi penal nr. 809/2024, *Prokuroria kundër të miturit në konflikt me ligjin, P.C.*;
3. Procedimi penal nr. 166/1-2024, *Prokuroria kundër të miturit në konflikt me ligjin, M.C.*

F. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Durrës:

1. Procedimi penal nr. 501/2022, *Prokuroria kundër të miturit në konflikt me ligjin, M.M.*;
2. Procedimi penal nr. 204/2019, *Prokuroria kundër të miturve në konflikt me ligjin, L.L., L.M., F.M., E.M., K.M., K.K., E.H. dhe E.A.*

I. VENDIMET GJYQËSORE TË ANALIZUARA PËR EFEKT TË STUDIMIT:

A. Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë:

1. Vendimi i themelit nr. 460, datë 20.2.2020, *Prokuroria kundër të miturit në konflikt me ligjin G.B.*;
2. Vendimi i themelit nr. 6081 Akti, datë 19.4.2021, *Prokuroria kundër të miturit në konflikt me ligjin M.K.*;
3. Vendimi i themelit nr. 2549, datë 1.11.2023, *Prokuroria kundër të miturit në konflikt me ligjin, R.B. dhe të rinjve në konflikt me ligjin H.D. dhe M.U.* (të tre të mitur në kohën e kryerjes së veprës penale).

B. Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm, Shkodër:

1. Vendimi i themelit nr. 10 (1147), datë 5.3.2024, *Prokuroria kundër të miturit në konflikt me ligjin A.K.*;
2. Vendimi i themelit nr. 50 (3170), datë 5.7.2023, *Prokuroria kundër të miturit në konflikt me ligjin J.B.*;
3. Vendimi i themelit nr. 60 (4088), datë 2.10.2023, *Prokuroria kundër të miturit në konflikt me ligjin K.B.*;
4. Vendimi i themelit nr. 51-2023-4353, datë 16.10.2023, *Prokuroria kundër të miturit në konflikt me ligjin A.H.*
5. Vendimi për vleftësimin e ndalimit dhe caktimin e masës së sigurimit nr. 182 (1678), datë 10.4.2023, *Prokuroria kundër të miturit në konflikt me ligjin, A.H.*

C. Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm, Vlorë:

1. Vendimi i themelit nr. 61-2025-67 (6), datë 15.1.2025, *Prokuroria kundër të miturit në konflikt me ligjin, F.K.*;
2. Vendimi i themelit nr. 61-2024-4058 (550), datë 5.12.2024, *Prokuroria kundër të miturve në konflikt me ligjin A.H, P.K. dhe K.K.*;
3. Vendimi i themelit nr. 130, datë 6.3.2024, *Prokuroria kundër të miturve në konflikt me ligjin, G.T., Q.P., Xh.Z., R.T. dhe A.G. dhe të rinjve në konflikt me ligjin A.H. dhe A.O.*;
4. Vendimi mbi shqyrtimin e kërkesës për ndryshimin e masës së sigurimit nr.61-2024-2978 (366), datë 13.9.2024, *Prokuroria kundër të miturit në konflikt me ligjin, A.H.*;
5. Vendimi për vleftësimin e arrestit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit nr. 7, datë 10.1.2024, *Prokuroria kundër të miturve në konflikt me ligjin, A.H., P.K. dhe K.K.*;
6. Vendimi për vleftësimin e arrestit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit nr. 283, datë 30.7.2024, *Prokuroria kundër të miturit në konflikt me ligjin, I.H.*;
7. Vendimi për vleftësimin e ndalimit dhe caktimin e masës së sigurimit nr. 130, datë 21.6.2020, *Prokuroria kundër të miturve në konflikt me ligjin, G.T., Q.P., Xh.Z., R.T. dhe A.G. dhe të rinjve në konflikt me ligjin A.H. dhe A.O.*

D. Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm, Fier:

1. Vendimi i themelit nr. 62-2024-6267 (886), datë 2.12.2024, *Prokuroria kundër të miturve në konflikt me ligjin E.P. dhe R.R.*

E. Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm, Durrës:

1. Vendimi i themelit nr. 11-2022-5019 (630), datë 19.10.2022, *Prokuroria kundër të miturit në konflikt me ligjin, M.M.*;
2. Vendimi i themelit nr. 11-2020-530 (39), datë 29.1.2020, *Prokuroria kundër të miturve në konflikt me ligjin, L.M., F.M., E.M., K.M., K.K., E.H. dhe E.A.*;
3. Vendimi i themelit nr. 11-2020-934 (95), datë 13.2.2020, *Prokuroria kundër të miturit në konflikt me ligjin, L.L.*
4. Vendimi për vleftësimin e arrestit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit nr. 11-2022-1391 (195), datë 21.3.2022, *Prokuroria kundër të miturit në konflikt me ligjin, M.M.*;
5. Vendimi për caktimin e masës së sigurimit nr. 11-2022-1391 (195/1), datë 19.4.2022, *Prokuroria kundër të miturit në konflikt me ligjin, M.M.*;
6. Vendimi për caktimin e masës së sigurimit nr. 26/1, datë 1.2.2019, *Prokuroria kundër të miturve në konflikt me ligjin, L.L., L.M., F.M., E.M., K.M., K.K., E.H. dhe E.A.*

1.2 LISTA E PYETJEVE PËR TË MITURIT QË JANË PARABURGOSUR GJATË HETIMIT DHE GJYKIMIT:

1. Në momentin e arrestimit në flagrancë/ndalimit apo ekzekutimit të masës së sigurimit "Arrest në burg" të caktuar në mungesë (kufizimit të lirisë personale) nga Policia Gjyqësore (PGJ) a jeni pyetur për moshën tuaj, krahas marrjes së gjeneraliteteve të tjera (emri, mbiemri, atësia, mëmësia, datëlindja, vendlindja, vendbanimi etj.)?
2. Nëse mosha juaj nuk dihej më përpara nga PGJ, pas marrjes së këtij informacioni, a u njoftuan menjëherë prindërit apo përfaqësuesi juaj ligjor (kujdestari) nga PGJ me iniciativë apo pas kërkesës tuaj?
3. Sa kohë pas momentit të kufizimit të lirisë tuaj u bë i mundur ardhja e prindërit tuaj?
4. A ju lejua takimi me prindin menjëherë dhe nëse jo, pas sa kohësh?
5. A qëndruat vetëm me prindërit tuaj për të biseduar në një ambient të përshtatshëm?
6. Në momentin e shoqërimit tuaj në ambientet e PGJ-së a ju janë bërë të ditura të drejtat e tuaja procedurale, në kuptim të nenit 34/a të Kodit të Procedurës Penale?
7. Nëse jua bënë të ditura të drejtat tuaja procedurale, a ishte i pranishëm prindi juaj gjatë njohjes me to?
8. A i kuptuat të drejta tuaja procedurale dhe nëse jo a ia bëtë të ditur këtë fakt oficerit të PGJ-së dhe/apo prindit?
9. A nënshkruat ndonjë dokument që provonte marrjen dijoni për të drejtat tuaja procedurale?
10. Sa kohë pas kufizimit të lirisë ju mundësua takimi me mbrojtësin e zgjedhur nga familja?
11. Nëse familja juaj nuk kishte mjete financiare për të zgjedhur një mbrojtës, sa kohë pas kufizimit të lirisë morët takim me mbrojtësin e caktuar kryesisht nga organi procedues?
12. Pas kufizimit të lirisë a ju mundësua këshillimi juaj me psikolog/punonjës social dhe, nëse po, afërsisht pas sa kohësh?
13. A u morët në pyetje nga PGJ menjëherë pas shoqërimit, qoftë edhe pa mbajtur procesverbal për rrethanat e faktit penal të atribuar, bashkëpunëtorët e mundshëm, motivet dhe qëllimet e kryerjes së kësaj vepre dhe të dhëna të tjera?
14. Nëse u morët në pyetje nga PGJ, a ishte i pranishëm prindi juaj, psikologu, mbrojtësi apo ndonjë prej tyre?
15. A u morët në pyetje nga prokurori i çështjes për faktin penal që iu ishte atribuar? Nëse po, a mbani mend kohën e saj (para daljes përpara gjykatës për caktimin e masës së sigurimit apo më vonë)? A morën pjesë gjatë pyetjes persona të tjerë, përveç jush?
16. A mbani mend nëse në seancën e caktimit të masës së sigurimit morën pjesë persona të tjerë, veç gjyqtarit, prokurorit dhe mbrojtësit tuaj?
17. A ju kërkua nga gjyqtari i hetimeve paraprake të flisnit në seancën gjyqësore të caktimit të masës së sigurimit?
18. Cilët persona morën pjesë në aktet procedurale të hartuara gjatë hetimit paraprak të çështjes, ku edhe ju ishit i pranishëm?
19. A u njohët me aktet procedurale të grumbulluara në përfundim të hetimeve? Nëse po, a patët vështirësi në kuptimin e akteve procedurale që konsultuat?
20. Gjatë seancës paraprake dhe gjatë gjyqimit të çështjes suaj në themel a u ndihmuat nga ndonjë person tjetër, veç mbrojtësit tuaj?
21. A ju kërkua mendimi për veprimet procedurale të kryera nga gjykata?
22. Si ishte gjuha dhe intonacioni që gjykata dhe prokurori përdorën ndërkohë që ju drejtoheshin gjatë gjyqimit të çështjes?
23. A ju krijua mundësia gjatë gjyqimit të shprehnit opinionin tuaj për faktet që ju u akuzuat?
24. Nëse gjykimi juaj u zhvillua nën ritin e gjyqimit të shkurtuar, a ju shpjegua nga gjyqtari të drejtat që përfitonit dhe të drejtat për të cilat duhej të hiqnit dorë?
25. A e lexuat vendimin përfundimtar të çështjes dhe a kishit vështirësi për ta kuptuar atë? A ju duk e vështirë gjuha e përdorur në këtë vendim?